



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS, E MBAJTUR MË 5 DHE 12 DHJETOR 2013**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 5. I 12. DECEMBRA 2013. GODINE**

**DHJETOR - DECEMBAR
2013**

Rendi i ditës

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme,
4. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e marrëveshjes për hua për financimin e vazhdimit të ndërtimit të rrugës magjistrale Milloshevë-Mitrovicë, Rruga M2, e lidhur ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Fondit OPEC për Zhvillim Ndërkombëtar (OFID),
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për prokurimin publik në Republikën e Kosovës,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin numër 03/L-102,
7. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për lojërat e fatit,
8. Shqyrtimi i raportit të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2012 dhe
9. Emërimi i kryetarit dhe i anëtarëve të Organit Shqyrtues të Prokurimit.

Dnevni red

1. Vreme za deklarisanje van dnevnog reda,
2. Vreme za parlamentarna pitanja,
3. Usvajanje zapisnika sa prethodne sednice,
4. Razmatranje Nacrta zakona o ratifikaciji sporazuma za zajam za finansiranje nastavka izgradnje magistralnog puta Milošev-Mitrovica - Put M2, sklopljen između Vlade Republike Kosova i Fonda OPEC za međunarodni razvoj,
5. Prvo razmatranje Nacrta zakona o izmeni i dopuni Zakona o javnoj nabavci u Republici Kosova,
6. Prvo razmatranje Nacrta zakona o izmeni i dopuni Zakona o poreskoj administraciji i procedurama, izmenjen i dopunjen Zakonom br. 03/L-102,
7. Razmatranje Izveštaja Komisije za budžet i finansije u vezi nadgledanja sprovođenja Zakona o igrama na sreću,
8. Razmatranje Izveštaja Institucije narodnog advokata za 2012,
9. Imenovanje predsednika i članova Tela za razmatranje nabavki.

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

I hap punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, sipas rendit të ditës të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës:

Koha për deklarime jashtë rendit të ditës është e kufizuar në 30 minuta. Në emër të Grupit, 5 minuta, në emër të deputetit, 3 minuta.

Fjalën e ka deputeti Arsim Bajrami.

ARSIM BAJRAMI: I nderuar kryetar i Kuvendit,

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Fillimisht dëshiroj të përshëndes mbajtjen e zgjedhjeve të mira lokale. Mendoj që kemi arritur një standard të munguar. Fakti që rezultatet e zgjedhjeve janë pranuar tregon një kulturë zgjedhore, një emancipim politik. Ndërkaq, rrotacioni politik që ka ndodhur në shumë komuna tregon zhvillimin e demokracisë, tregon që demokracia te ne është funksionale.

Gjithashtu, përshëndes mbajtjen e zgjedhjeve në komunat veriore. Ky është një hap drejt integritetit dhe angazhohem që të përshpejtohet procesi i reformës zgjedhore dhe sa më shpejt ky proces të vijë në duar të Kuvendit, në mënyrë që të procedojmë me debatin parlamentar për rishikimin e Ligjit zgjedhor.

Mirëpo, të nderuar deputetë, arsyeja e daljes sime në këtë foltore janë pikërisht provokimet që bëhen tani nga kryetarët e zgjedhur të komunave veriore, pra jo nga përfaqësuesit joligjorë, por nga kryetarët e zgjedhur të komunave, se nuk do të pranojnë juridiksionin e Kosovës, përkatësisht se nuk do të futen në skemat e pushtetit lokal të përcaktuar në Kosovë.

Mendoj se kjo është një sfidë tani për Kosovën dhe unë angazhohem që të gjitha institucionet e Kosovës, në radhë të parë Qeveria e Kosovës, Ministria e Pushtetit Lokal, të marrë të gjitha masat e nevojshme të parapara me Kushtetutë dhe me ligj, që të monitorojë ligjshmërinë e punës së kryetarëve të komunave serbe dhe të asambleve komunale dhe të parandalojë çfarëdo veprimi jokushtetues apo veprimi joligjor eventual nga këto komuna.

Gjithashtu, angazhohem që sa më shpejt të definohet statuti i Asociacionit të komunave dhe të shmanget çfarëdo krijimi i entitetit ekzekutiv të këtij institucioni, në mënyrë që ky institucion të përfshihet në skemën adekuate të funksionimit të pushtetit lokal.

Gjithashtu, u bëj ftesë prokurorit publik, Prokurorisë Publike, që të monitorojë implementimin e Kodit Penal të Republikës së Kosovës dhe sipas detyrës zyrtare të fillojë procedurat për çfarëdo aktiviteti, me të cilin cenohet rendi kushtetues, për shkak se Kodi i ri Penal, që ne e kemi miratuar parasheh masat adekuate për të gjitha veprimet që cenojnë drejtpërdrejt rendin kushtetues.

I bëj ftesë edhe Bashkimit Evropian, që të tregohet korrekt ndaj institucioneve të Kosovës dhe të mos japë statusin e kandidatit të Serbisë derisa nuk ka prova të sigurta se komunat e reja serbe, autoritetet e dala nga zgjedhjet lokale të këtyre komunave nuk integrohen brenda skemës së pushtetit lokal, në mënyrë që të jenë të sigjerta karshi politikës së matur dhe politikës pro aktive, që ka zhvilluar Kosova në drejtim të normalizimit të raporteve me Serbinë. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Hykmete Bajrami, në emër të Grupit.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Indeksi i perceptimit të korrupsionit për vitin 2013 i lancuar këto ditë nga Transparency International, konfirmon se në vendin tonë abuzimi me pushtetin, me resurset e vendit, me taksat e qytetarëve, buxhetin në përgjithësi, marrëveshjet e fshehta dhe ryshfeti po vazhdojnë ta rrënojnë ardhmërinë e vendit tonë.

Sipas Transparency International, në këtë indeks Kosova notohet si një ndër vendet me nivel më të lartë të korrupsionit, duke u renditur kështu në vendin e 111-të, në të njëjtin nivel me vendet si Tanzania, Etiopia dhe Sierra Leone. Një rangim i tillë tregon se kemi një nivel alarmant të korrupsionit. Ne nuk po kërkojmë të krahasohemi me Zelandën e Re apo Danimarkën, ku korrupsioni është pothuajse zero, po kërkojmë që së paku t'u afrohemi vendeve të rajonit, siç është për shembull Kroacia e cila gjendet 54 vende më larg nesh, për korrupsion të ulët.

Ajo çka është shqetësuese është se konfirmimi i kësaj gjendje nga një organizatë shumë kredibile, siç është Transparency International po mbahet e heshtur nga ana e Qeverisë. Sa e sa herë nga foltorja e këtij Kuvendi, nga përfaqësues të Qeverisë është përmendur avancimi i Kosovës në raportin e Bankës Botërore për të bërë biznes. Dhe, të gjithë ne e kemi aplauduar këtë sukses, edhe pse kjo ka rastisur se kjo Qeveri t'i korrë frutat e një pune që dikush tjetër e ka bërë para saj.

Por, avancimi kinse me procedura, si regjistrimi i një biznesi dhe dështimi total i institucioneve për luftimin e korrupsionit kanë dhënë efekte çfarë të gjithë ne i dimë, efekte zero dhe negative. Ka qenë shumë normale që kryeministri ose ndonjëri nga ministrat e tij të shumtë, menjëherë pas lansimit të këtij raporti, të dalin publikisht dhe të

shprehin shqetësimin kinse të Qeverisë për këtë dukuri kaq negative; të kërkojnë nga institucionet që janë të thirrura për ta luftuar këtë dukuri; të kërkojnë bashkëpunim dhe mbrojtje për qytetarët që raportojnë korrupsionin, por kjo nuk ka ndodhur asnjëherë, sepse kësaj qeverie nuk i pengon korrupsioni, por përkundrazi po e ndihmon që të jetë aty ku është.

Është më se evidente se nuk ka vullnet politik për luftë kundër korrupsionit. Institucione të shumta de jure të thirrura për ta luftuar këtë dukuri, po bëjnë vetë korrupsion duke lejuar atë që të ndodhë para syve të tyre dhe brenda vetë këtyre institucioneve.

Lidhja Demokratike e Kosovës është shumë e shqetësuar për dëmin që kjo Qeveri po i bën vendit. Keqpërdorimet e taksave të qytetarëve, nepotizmi e krimi ekonomik, kontrabanda në masë të madhe kanë kontribuar në gjendjen në të cilën janë katandisur sot qytetarët e Kosovës, ku gjysma prej tyre jetojnë në kufij të varfërisë.

Mungesa e rendit dhe ligjit, përdorimi i standardeve të dyfishta nga ana e institucioneve për qytetarët e Kosovës e ka zbehur shumë imazhin e Kosovës dhe është reflektuar në tkurrjen e investimeve të huaja direkte, aq shumë të nevojshme për zhvillimin e vendit tonë dhe në tkurrjen e aktivitetit ekonomik, në përgjithësi.

Sa ka korrupsion në Kosovë, askush nuk e vë në dyshim këtë. Ai ndodh çdo ditë para syve tanë, lejohet të ndodhë nga institucionet dhe organizohet nga vetë ato. Në shumë raste, korrupsioni dhe nepotizmi kryhet nga institucionet që janë të thirrura për ta luftuar.

Sipas Transparency International, renditja e vendit tonë në një pozitë kaq të ulët, tregon më së mirë për mungesën e angazhimit dhe pavarësinë e institucioneve të vendit, për të luftuar korrupsionin. Kjo tregon se vendi ynë përpos përgatitjes së ligjeve nuk ka bërë asnjë hap më shumë në luftë kundër korrupsionit. Krahësuar me vitin e kaluar, Kosova ka pësuar rënie prej 6 vendeve. Domethënë, vitin e kaluar renditej e 105-ta, këtë vit bie në pozitën e 111-të.

Ky raport tregon performancën e munguar të institucioneve për luftimin e këtij fenomeni. Në korrupsionin sot e kemi në sistem. Si proces, ai fillon nga roja e recepcionit dhe përfundon tek kreu i organizatës ose anasjelltas, por kjo dukuri sot ndodhë haptas. Është pjesë e përditshmërisë së biznesit dhe aktiviteteve të shoqërisë në përgjithësi.

Të nderuar,

Indeksi i Transparency International është indeks që mat me të vërtetë perceptcionin për korrupsionin. Për ata që e kuptojnë se çfarë domethënë fjala perceptcion, e dinë se perceptcioni është përafrim i realitetit dhe ai krijohet nga ajo çfarë qytetarët shohin dhe përjetojnë për çdo ditë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Visar Ymeri.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës!
Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Më 18 tetor të vitit 2012, seanca e Kuvendit, siç ju kujtohet besoj, u ndërpre për më se një orë që në fillim të saj, sepse ndërtesa e Kuvendit atëbotë ishte e rrethuar me polici. Atë ditë ky Kuvend pritej ta miratonte Rezolutën për nisjen e negociatave me Serbinë, e Bajram Rexhepi si ministër i kishte marrë masat, që të sigurohej miratimi i kësaj rezolute, masa këto gjithsesi policore.

Ne e quajtmë këtë Rezolutë të nënshtrimit të Kosovës ndaj Serbisë përmes një panoje që e mbanim te foltorja përderisa kryetari i Grupit të PDK-së, Adem Grabovci e lexonte tekstin e Rezolutës.

Çdo gjë që ka ndodhur me këtë proces negociator në muajt pasrendës të 18 tetorit e ka dëshmuar pikë për pikë e fjalë për fjalë vërtetësinë e këtij emërtimi. Pra, e ka dëshmuar njëkohësisht edhe automatikisht mashtrimin që rridhte nga teksti i Rezolutës.

Më 21 prill të vitit 2013 Qeveria kërkonte një Rezolutë të re, atë për ta marrë pëlqimin për nënshkrimin e Marrëveshjes. Ne patëm protestuar mu në këtë sallë, duke kërkuar nga deputetët që t'i thërrasin ndërgjegjes dhe të mos e votojnë Rezolutën. Ua patëm përkujtuar Enver Zymberin e Selver Haradinajn, por shumica prapëseprapë e votoi.

Më 27 qershor, Qeveria kërkonte ratifikimin e Marrëveshjes së 19 prillit. Ne patëm protestuar jashtë ndërtesës së Kuvendit dhe brenda sallës së tij. Ne deshëm ta bllokojmë hyrjen e deputetëve në sallë dhe deshëm ta bllokojmë ratifikimin e Marrëveshjes. Policia e urdhëruar nga Bajram Rexhepi i rrahu e arrestoi qytetarët, ndërkohë që siguri i Kuvendit i nxori deputetët jashtë, për ta mundur kështu ratifikimin e marrëveshjes.

Më 11 korrik në tentimin e dytë, ky Kuvend e miratoi Ligjin për amnisti në të dy leximet në të njëjtën ditë. Për shumë ditë rresht qytetarët e bashkuar me aktivistë të Shoqërisë Civile protestuan para Kuvendit duke kaluar ditën dhe natën në tenda, për të kërkuar mosmiratimin e ligjit. Megjithatë, ky Kuvend vendosi që ta dëgjojë Qeverinë e Kosovës dhe atë të Serbisë e jo qytetarët.

Tash e kemi Serbinë në Kosovë, të forcuar politikisht, me pushtet të legalizuar e me polici e gjyqësi të ndarë. Kemi kryetarë komunash që deklarojnë se nuk e njohin shtetin e Kosovës dhe se do të punojnë drejtpërsëdrejti për Serbinë në Kosovë, kryetarë këta, të cilët po përgatiten ta themelojnë Republikën e tyre serbe, të quajtur Asociacion i Komunave, për ta pasur kështu një entitet brenda Kosovës që nuk e pranon Kosovën.

Ky është pra rezultati i këtyre negociatave, të sponsorizuara dhe udhëhequra nga Hashim Thaçi, e të miratuara nga PDK-ja, LDK-ja, AAK-ja, AKR-ja. Këta kryetarë nuk duhen lejuar t'i marrin postet e tyre publike. Asnjë person nuk ka të drejtë të marrë post publik në Kosovë e të mos pranojë Republikën e Kosovës. Asociacioni nuk bën të krijohet, është e papranueshme, që ta kemi një entitet të ndarë brenda Kosovës, i cili as nuk e njeh shtetin e Kosovës dhe i cili zotohet se do të punojë për çdo ditë kundër këtij shteti. Ju faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Donika Kadaj-Bujupi.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Në vijën e shqetësimeve rreth Asociacionit, po dua ta ritheksoj edhe njëherë pozicionin e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, që çdo përpjekje për ndryshim ose negociim të Asociacionit të Komunave për t'i ndryshuar kompetencat e saj të bazuara në Marrëveshjen e 19 prillit, e cila është komplet e bazuar në Kushtetutën dhe ligjet e Kosovës, do të ketë pasoja afatgjata dhe do të ndikojë në funksionalitetin e Republikës së Kosovës.

Këto përpjekje janë vërejtur edhe në punën në Komision, ku anëtarja jonë ka refuzuar fuqishëm dhe do të vazhdojmë të refuzojmë çfarëdo plotësimi ndryshimi rreth këtij Asociacioni, i cili edhe në këtë fazë, edhe si i tillë, realisht po paraqet problem.

E dyta, pasi që sot kryeministri Thaçi së bashku me grupin negociator po vazhdon negociatat dhe dialogun, dëshirojmë t'ia rikujtojmë që më 19 shtator është dashur të shuhet të gjitha strukturat paralele në Republikën e Kosovës, gjë e cila nga reagimet po shihet që nuk ka ndodhur.

Dhe e treta, nëntë kryetarëve të porsazgjedhur dëshirojmë t'ua përkujtojmë edhe njëherë, që janë zgjedhur sipas ligjeve të Kosovës, kanë aplikuar në KQZ dhe së shpejti duhet të japin betimin, sipas Kushtetutës dhe sipas ligjeve të Republikës së Kosovës. Çfarëdo dështimi për të dhënë këtë betim, dihet se do të prodhojë aspekte të tjera dhe do të ketë ose do të duhet të shkohet në zgjedhje të reja.

Të gjitha këto i thashë me qëllimin e vetëm për të kërkuar edhe njëherë fuqishëm, në emër të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, që t'i përmbahemi asaj se çfarë është votuar në këtë Parlament, bazuar në Kushtetutën dhe ligjet e Republikës së Kosovës. Përndryshe do të kërkojmë ripozicionim dhe do të kemi ripozicionim sa i përket edhe vetë dialogut. Ju faleminderit!

KRYETARI: Pasi që po e keni temë këtë çështje, unë po ua përkujtoj se më shumë se 80 deputetë e kanë miratuar në Kuvendin e Kosovës Marrëveshjen e 19 prillit.

Vazhdojmë. Me kohë është dashur me i pas parasysh disa gjëra. Fjalën e ka deputetja Blerta Deliu-Kodra.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Zgjedhjet e fundit lokale përveç se u organizuan mirë prej institucioneve tona dhe kaluan pa asnjë problem, që do të vente në pikëpyetje edhe rregullsinë edhe besueshmërinë e që në fakt është edhe përmbushje e një standardi demokratik, nxorën edhe një vlerë tjetër të shtuar, afirmuan rolin e gruas në proceset politike, duke u mundësuar kështu që ato të jenë të pranishme në proceset vendimmarrëse edhe në nivelin lokal.

Për herë të parë pas përfundimit të luftës në Kosovë, nëntë gra ishin kandidatë për kryetarë të komunave, prej të cilave zonja Mimoza Kusari – Lila u zgjodh kryetare e Gjakovës, për çka edhe i uroj singërisht, meqë do të jetë inkurajuese për gratë tjera që deri më tani kanë hezituuar të përballen me këtë sfidë.

Të nderuar deputetë,

Meqë zgjedhjet kanë përfunduar do të tërheq vëmendjen për një dukuri që skajshmërisht e zbeh, e marginalizon dhe në shumë raste e pamundëson pjesëmarrjen aktive të gruas në proceset vendimmarrëse në nivelin lokal, e këtua e kam fjalën për drejtoritë komunale, ku gruaja nëse është krejtësisht e përjashtuar, atëherë asaj i sigurohet vetëm prania simbolike e ku ka dominim të plotë të burrave.

Po e përmend këtu rastin e drejtorive komunale në zgjedhjet e kaluara, ku kemi pasur prej 320 drejtorive, do të thotë vetëm 20 janë udhëhequr nga gratë. Mendoj se emancipimi politik e shoqëror i gruas në Kosovë nuk mund të përmbushet nëse përfaqësimi i tyre në këto drejtori nuk kalon në numrin tre.

Prandaj, kërkoj nga ju kolegë deputetë, që të na përkrahni, që në kuvendet komunale, që do të formohen menjëherë pas certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve, numri i grave që do të jenë në krye të këtyre drejtorive të rritet në përputhje me kualifikimet e tyre profesionale. Ndryshe, nëse kjo do të vazhdojë në këtë mënyrë, atëherë ne veç do të kemi vazhdimësi të diskriminimit gjinor e në kundërshtim me ligjet të cilat i kemi në fuqi.

Gruaja ka kontribuar në të gjitha kohërat e zhvillimit, prandaj nuk duhet të trajtohet si dekor dhe si përqindje e kuotave apo si mëshirë e partive politike, por si vlerë e domosdoshme dhe e dëshmuar, e cila është në shërbim dhe do të vazhdojë të jetë në shërbim të qytetarëve të Republikës së Kosovës, pavarësisht përkatësisë etnike, asaj politike, fetare e në rastin konkret edhe të përfaqësisë gjinore. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Teuta Sahatqija.

TEUTA SAHATQIJA: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Së pari dëshiroj të shpreh këtë pajtimin plotësisht me zonjën Blertën dhe urimin që e kemi një kryetare grua, me sa di unë janë dy dhe që në drejtori të ketë përfaqësim të duhur të grave.

Por, në anën tjetër, unë dëshiroj të ngre edhe një çështje tjetër, është çështja e Bordit të AKP-së. Ky bord është i paplotësuar, pasi që një përfaqësues ndërkombëtar dhe dy vendorë kanë dhënë dorëheqje. Si pasojë e mosekzistimit komplet të këtij bordi kanë mbetur një numër i madh i punëtorëve pa e marrë 20%-shin nga privatizimi.

Në pyetje janë 158 ndërmarrje dhe një numër jashtëzakonisht i madh i punëtorëve, të cilët presin.

Ne në Komisionin për Zhvillim Ekonomik kemi kërkuar nga Qeveria, pasi që Qeveria është ajo e cila bën propozimin në Kuvendin e Kosovës, të anëtarëve, që të kryejë detyrën e saj. Qeveria deri më tani nuk e ka parë të arsyeshme që të merret me punëtorët, me Bordin e AKP-së dhe me zgjidhjen e çështjeve të cilat janë kompetencë e këtij bordi dhe duke u marrë me çështje shumë më të rëndësishme, se sa qytetarët e Kosovës, është duke e lënë anash këtë çështje.

Nuk kanë mjaftuar kërkesat edhe nga Komisioni edhe dje përsëri edhe njëherë në Komision është ngritur kjo çështje, është ngritur shumë herë edhe në Parlament, por Qeveria si duket ka punë shumë më të mençme se sa të merret me punëtorët.

Dëshiroj të shfrytëzoj edhe këtë rast që të kërkoj urgjentisht nga Qeveria, që ta kryejë detyrën e vet, të nominojë njerëzit për plotësimin e Bordit të AKP-së dhe t'i sjellë në Kuvend, në mënyrë që punëtorët të mos mbesin pa e marrë atë që u takon me ligj.

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Glauk Konjufca.

GLAUK KONJUFCA: I nderuar kryetar,
Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,
Para pak ditësh opinionin publik dhe shoqëria jonë u trondit nga një video-incizim, protagonistin kryesor i të cilit ishte djali i të parit të opozitës në Kosovë, Isa Mustafa.

Në këtë video shihet qartë djali i kryetarit të deridjeshëm të Prishtinës në përpjekje për ta korruptuar një aktivist të “Vetëvendosje”-s, si dhe familjen e tij. Kjo video shpërfaqë mënyrën e vërtetë të qeverisjes së kryeqytetit nëpërmjet klientelizmit. Kjo tregon se në Kosovë strukturat partiake dhe komunale janë simbolike dhe formale, përderisa grupe të caktuara nepotiste e kriminale të interesit janë ata që vendosin në të vërtetë.

Në njërin anë na paraqiten me petkun e Akademisë e të diturisë, e në anën tjetër qeverisin përmes nëntokës. Kështu u qeveris deri sot komuna, e kështu po pretendohet të qeveriset nesër edhe Kosova. Akademiku Mustafa, dje në rrjetet sociale e pranoi se djali i tij u përfshi në një skandal korruptiv, por merreni me mend, tha: “mos u merrni me familjen time” thuaj se kjo është një çështje personale.

Isa Mustafa po mundohet të thotë që ajo që bëri djali i tij dhe ajo që bën komuna janë dy gjëra krejtësisht të ndryshme, por me siguri ai e din frazeologjinë popullore, e cila thotë se “Çka ka shtëpia e qet fëmija”, dhe se “Të vegjlit i hanë mollët, por të rriturve u mpihen dhembët”.

Shyqyr që doli kjo video dhe e morëm vesh se sa të njëjta janë dy partitë kryesore politike në Kosovë dhe sa i kotë është debati kur ato grinden duke na shitur moralitetin hipokrit. Por, ajo që vërtet më trishton është fakti që të gjithë deputetët që ndodhen në Kuvend nga kjo parti e dinë të vërtetën, por nuk dëgjova asnjë reagim publik nga asnjëri, thuajse ata pajtohen me këtë realitet dhe jetojnë me të.

E kush e çan kokën për dinjitetin njerëzor? Mos qofsha në lëkurën e tyre!

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Aurora Bakalli.

AURORA BAKALLI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Dy ditë më parë ishte Dita ndërkombëtare e personave me aftësi të kufizuara. Me këtë rast HENDIKOS organizoi një marsh nga sheshi “Zahir Pajaziti” deri te Teatri Kombëtar, për ta prezantuar hartën e barrierave për këtë kategori të shoqërisë.

Pa asnjë dyshim, që Kosova posaçërisht në aspektin infrastrukturor nuk paraqet një ambient të përshtatshëm dhe miqësor për personat me aftësi të kufizuara, por fatkeqësisht, shumë shpesh ekzistojnë edhe paragjytime për këtë kategori të shoqërisë. Ndërkaq, një ndër hapat e rëndësishëm për eliminimin e paragjykimeve në shoqëri, karshi personave me aftësi të kufizuara, është bashkëjetesa jonë me ta, pra integrimi në shoqëri i kësaj kategorie, duke i njohur më shumë do t’i kuptojmë më mirë, por edhe do t’i vlerësojmë më drejt.

Dhe, ky integrim për të qenë i suksesshëm duhet filluar qysh në fëmijëri, në mënyrë që nga moshat e reja të largohen paragjykimet.

Sot do të flas për shqetësimet e nënave, që kanë fëmijë me nevoja të veçanta, me të cilat kam pasur rastin të bashkëbisedoj. Ato kanë shumë shqetësime e një ndër to është se fëmijët e tyre nuk pranohen dhe nuk integrohen në shoqëri si pasojë e ndarjeve të instaluar qysh nga shkollimi fillor. Edhe pse, Ligji për arsimin parauniversitar parasheh që parimi i arsimit gjithëpërfshirës të zbatohet në Republikën e Kosovës, në përputhje me normat ndërkombëtare, siç parashihet në Konventën e UNESCO-s për të Drejtat e Fëmijëve, në Deklaratën e SALAMANC-as, Konventën e OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara. Por, edhe përkundër akteve normative në fuqi, pengesat e këtyre prindërve shfaqen që në fillim, për shkak të mungesës së ekipit profesional vlerësues për nevojat e posaçme arsimore të përbërë nga specialistë të arsimit, punës sociale, psikologjisë dhe rehabilitimit.

Ky ekip, apo komision vlerësues që themelohet nga komuna, ndër të tjera ka për detyrë të japë rekomandime mbi metodat e mësimdhënies, mjetet e mësimdhënies dhe mbi përshtatjet e tjera të nevojshme për mësimnxënie dhe mirëqenien e fëmijës, por edhe për të dhënë rekomandime për regjistrimin e nxënësit.

Në mungesë të këtyre komisioneve prindërit ankohen se hasin në përplasje me drejtorët dhe psikologët e shkollave se a mund të vijnë fëmijët shkollimin në shkollën përkatëse apo jo. Vetë praninë e klasave të bashkëngjitura, nënat e fëmijëve me aftësi të kufizuara e shohin si problematike për shkak të ndarjes së fëmijëve, gjegjësisht mos mundësisë së integritetit dhe shoqërimit me fëmijët e tjerë. Për më tepër, shkollat nuk janë të ndërtuara me standarde që plotësojnë nevojat e fëmijëve me aftësi të kufizuara, duke përfshirë këtu edhe tualetet.

Prandaj, në emrin tim personal dhe të Lëvizjes...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Sasha Gjokiq.

SAŠA ĐOKIĆ: Govorim u ime socijaldemokratije, čiji sam predsednik, govorim i kao poslanik i zamenik “Zajedničke Budućnosti”.

S obzirom da sam ja u zadnjih mesec dana, dva puta privođen od strane policijske stanice Gračanica, gde sam juče i prekjuče doživeo takvu torturu, da ja to mogu da nazovem od strane policijske stanice Gračanice “teroristički akt”. S obzirom da ja sam poslanik već i moja stranka učestvuje 9 godina u Parlamentu Republike Kosova, zahtevam od vas i kolege poslanike, s obzirom da ovde imam poslovnik šta znači poslanik Skupštine Republike Kosova, i Ustav Republike Kosova, ne da su mi povređena građanska i ljudska prava, nego i kao poslanika Republike Kosovo.

Nisam ja jedini koji je doživeo torturu od strane policijske stanice Gračanica na čelu sa komandirom policijske stanice, već sam prekjuče čak i fizički prebijen, vezan i deportovan u pritvorskoj jedinici u Prištini, gde meni nisu pročitana nikakva prava. Ako ne znate ovde u Skupštini, ja ću da pročitam, ali mislim da nema potrebe, jer ima poslovnik, šta znači poslanik Republike Kosova. I u poslovniku, i u Ustavu Republike Kosova. Želim da naglasim da socijaldemokratija više neće tolerisati ovako ponašanje policijske stanice Gračanica, a videli smo i sami u drugom krugu lokalnih izbora šta se dešavalo u pojedinim opštinama.

Tražim kao poslanik i kao zamenik “Zajedničke Budućnosti” da gospodin ministar, na čelu sa svojim ministarstvom, ispita rad policijske stanice Gračanica, a ja kao poslanik i kao građanin naglašavam da ću podneti krivične prijave protiv osoba, odnosno policajca KPS Policije u Gračanicu, koji su me tukli i pretukli. Za sve ovo imam lekarske dokaze. To nije prvi put, tako da samo želim da naglasim da posle ovoga idem da podnesem prijave i u Sudu, i u Javnom Tužilaštvu.

Ja zahtevam od Vas, gospodine predsedniče Skupštine i ovog doma, ne samo mene, nego da is...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Nait Hasani.

NAIT HASANI: Faleminderit, kryetar!

Unë e kam çështjen e një kërkesë që ka ardhur nga banorët e fshatrave të Rugovës për çështjen e parkut dhe në Kuvendin e Kosovës është proceduar në Komisionin për Peticione, Parashtresa dhe Ankesa.

Ky peticion i ka diku rreth 5 528 nënshkrime, i cili nuk i plotëson kushtet për procedim të mëtejshëm për shkak se duhet të jenë 10 mijë nënshkrime, por tjetra e gjithë kësaj është që ky peticion është i nënshkruar nga një njeri, ose dy njerëz, ose një grup i vogël

njerëzve, të cilët i kanë dëshmitë dhe janë shkrimet e njëjta në secilën faqe, që e dëshmon këtë.

Prandaj, t'i thuhet dikujt që kemi bërë një nënshkrim të petitionit nga gjithë 15 fshatrat e Rugovës, është një mashtrim që ia ka sjellë Kuvendit parashtruesi i kërkesës. Ndërsa, në anën tjetër, ministria ka bërë zonimin dhe ky zonim tregon fshatrat që nuk preken në zonën e Rugovës. 15 fshatrat askund nuk kanë zonë të parë mbrojtje, për çka ata ankohen. Këta që e kanë bërë këtë petition kanë bërë edhe një kërkesë në Gjykatën Kushtetuese, dhe ajo ua ka hedhur poshtë me vendimin e vet më 7 qershor. Edhe thuhet 'të hidhet poshtë kërkesa si e papranueshme'.

Ndërsa, këta po ashtu kanë bërë kërkesë edhe te Ombudspersoni për mbrojtjen e kërkesës së tyre, ndërsa ai po ashtu ka kërkuar sqarime nga komisioni dhe komisioni u është përgjigjur, duke thënë: "Gjatë diskutimeve që janë bërë në Pejë, Rugovë, Istog, Deçan, Gjakovë, Junik, në vitin 2012, pjesa dërrmuese dhe gjithë kryetarët e komunave përkatëse kanë dhënë mbështetje për shpalljen park kombëtar".

Por, çështja ka ardhur dhe si rrjedhojë kërkesat nga debatet në lidhje me frikën e banorëve nëpërmjet ligjit që do të përfundojë çdo shpresë e tyre për kthimin e pronave. Ne në Ligjin për parkun e kemi futur amendamentin pas kërkesave të banorëve të fshatrave të Rugovës. Të drejtat pronësore dhe denacionalizimi nuk rregullohen me Ligjin për parkun. Ato rregullohen me ligje tjera për çështje të pronësisë dhe tjetra e gjithë kësaj është që kurrkush nuk e di sa është prona private e tyre atje.

Ata vetëm thirren në çështjen e e pronës dhe pronësisë, ndërsa pronën e tyre kurrkush nuk e ka kontestuar, as nuk e ka marrë pronën e tyre, as nuk do t'ua marrë pronën e tyre, por parku do ta bëjë mbrojtjen e atyre vlerave natyrore, peizazheve, pasqyrës, ndërsa në gjithë këtë e kemi edhe vlerësimin e Rrjetit Ballkanik të Paqes për parkun kombëtar, të cilin ai e vlerëson dhe thotë: "Është një nga veprat më të mira të Kuvendit të Kosovës që e ka miratuar Ligjin për parkun", sepse thotë lidhet Mali i Zi, Shqipëria dhe Kosova dhe është një projekt ballkanik i zhvillimit të kësaj natyre.

Prandaj, banorët që e kanë bërë këtë kërkesë, ajo është e paarsyeshme, është jo e drejtë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! E kemi përfunduar pikën e parë, vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputetja Ganimete Musliu, pyetje për ministrin Ferid Agani. Ministri nuk është këtu. Deputete, mund ta parashtrosh pyetjen.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, kryetar!
Të nderuar deputetë,

Meqë ministri nuk është këtu, kurse pyetja që unë e kam paraparë që t'ia bëj ministrit nuk e humb aktualitetin, kisha propozuar që të bartet në seancën e radhës. Faleminderit!

KRYETARI: Deputetja Teuta Haxhiu, pyetje për ministrin Fehmi Mujota.

TEUTË HAXHIU: Faleminderit, kryetar! Duke e ditur rëndësinë e pyetjes, edhe unë, edhe banorët e Lugut të Baranit, kanë nevojë për ta marrë një përgjigje, edhe unë e bart pyetjen për në seancën e ardhshme, kur të vijë ministri.

KRYETARI: Pyetja e fundit, deputeti Visar Ymeri, pyetje për ministrin dhe zëvendëskryeministrin Hajredin Kuçi. Doni ta bëni pyetjen, deputet?

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Po, unë po e parashtroj pyetjen. I drejtohet ministrit të Drejtësisë, zotit Hajredin Kuçi.

Gjykata Komunale në Besianë e ka marrë një vendim në favor të Adem Jasharit si kreditor, i cili ishte bërë i plotfuqishëm, pas ankesës së debitorëve Sahit, Rexhep dhe Fatbardh Demiri në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë.

Vendimi është marrë më 7 nëntor të vitit 2008, i cili thotë se është aprovuar padia e Adem Jasharit, ndërsa debitorët Demiri detyrohen që t'i lirojnë nga posedimi dhe shfrytëzimi i mëtejshëm ngastrat kadastrale numër 643, 644 dhe 645, me sipërfaqe të përgjithshme prej 1,44 hektar. Por, ky vendim nuk është respektuar nga debitorët Demiri dhe për këtë arsye kreditori Adem Jashari, më 12 maj 2009, e kishte iniciuar propozimin për përmbarim në Gjykatën Komunale në Besianë, kure i njëjti institucion që nga koha kur është licencuar procedura e rregullt në gjykatë nuk ka marrë një vendim për lejimin e përmbarimit.

Pyetja ime për ministrin: A është në dijeni për arsyen pse Gjykata Komunale e atëhershme, tash Gjykata Themelore në Besianë në vepron në nguti në këtë çështje, gjë që është e detyruar me ligj, kur dihet që legjislacioni në fuqi e detyron pra një veprim të tillë.

KRYETARI: Edhe kjo pikë e rendit të ditës ka përfunduar. Pika e radhës:

3. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme

Por, para se të kalojmë në votim, regjia t'i bjerë ziles, pasi për pikën e radhës duhet të jenë së paku 80 deputetët. Deputetët, le të kthehen në sallë.

Në sallë momentalisht i kemi 63 deputetë me prani fizike, 87 me prani elektronike.

A keni vërejtje në procesverbalin e seancë plenare, të mbajtur më 21 nëntor 2013?

Nëse nuk ka, konstatoj se Kuvendi e miratoi procesverbalin e seancës plenare, të mbajtur më 21 nëntor 2013.

Fjalën e ka deputeti Ismet Beqiri për një njoftim.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, kryetar!

Unë po e shfrytëzoj rastin të them për atë që u tha më herët, absolutisht nuk qëndron, dhe organet e hetuesisë duhet ta thonë fjalën e tyre.

E di, kryetar, por vërtet është shqetësuese që në këtë vendin tonë demokratik ka njerëz që manipulojnë me djem të rinj edhe i shtinë të xhirojnë, të incizojnë, e me këtë duhet të merren organet e drejtësisë dhe nuk qëndron kurrfarë afere korruptive. Nuk është djali i përfshirë.

Unë nuk e mbroj as djalin e kryetarit, e as djalin tim nëse ka gjëra të tilla, por organet e drejtësisë duhet të thonë. Le ta shikojnë mirë atë videoincizim dhe sigurisht duhet të tregohet se si është e mundur që një djalë i ri të shkojë të xhirojë edhe të hyjë nëpër zyra, ose nëpër kafene. Pra, le ta thonë fjalën e tyre organet e drejtësisë. Këto nuk janë metoda demokratike të përgjohen njerëzit, të incizohen njerëzit e të publikohen, por sidoqoftë organet e drejtësisë le ta thonë fjalën e tyre. Këto janë metoda të cilat i takojnë një sistemi të kaluar.

Unë, zoti kryetar, po ju informoj sesa i përket një ndryshimi në Komisionin për Buxhet dhe Financa, grupi ynë parlamentar propozon që në vend të zotit Sali Allsanaj, i cili tashmë është kryetar i Suharekës, të jetë profesor Muhamet Mustafa. Ky është ndryshim që ne e bëjmë si Grup Parlamentar, prandaj ju informoj ju dhe deputetët e nderuar. Faleminderit!

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Ju e dëgjuat njoftimin e Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike. Na duhet një votim formal. Kush është për? Faleminderit! Me shumicë absolute bëhet ndërrimi i deputetit Sali Asllanaj me deputetin Muhamet Mustafa.

Të pranishëm janë 73 deputetë, prandaj ende s'e kemi numrin e nevojshëm për të vazhduar me pikën 4 të rendit të ditës. Është mirë që kryetarët e grupeve parlamentare të angazhohen kësaj radhe siç, po angazhohen nganjëherë ta bëjnë numrin e caktuar.

Me prani elektronike janë 93 deputetë. Kërkoj nga regjia dhe deputetët që me votim ta tregojnë praninë elektronike. Votojmë tash!

Me elektronikë 79, por me prani fizike janë 87 deputetë. Pesë pa kartelë, atëherë kemi 83, megjithatë prania elektronike është 94 deputetë.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e marrëveshjes për hua për financimin e vazhdimit të ndërtimit të rrugës magjistrale Milloshevë-Mitrovicë, Rruga M2, e lidhur ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Fondit OPEC për Zhvillim Ndërkombëtar (OFID)

Qeveria nuk është këtu për ta prezantuar këtë, shkojmë menjëherë në votim. Kryetarja e Komisionit për Buxhet dhe Financa, deputetja Safete Hadërgjonaj e ka fjalën.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, kryetar!

Qeveria e Republikës së Kosovës e ka nënshkruar marrëveshjen për hua për Fondin OPEC për zhvillim ndërkombëtar për financimin e vazhdimit të ndërtimit të rrugës Milloshevë-Mitrovicë, Rruga M2.

Qëllimi kryesor i projektligjit është përmirësimi i rrugës ekzistuese Milloshevë-Mitrovicë, duke kontribuar kështu në zhvillimin ekonomik dhe gjenerimin e punësimit në pjesën e Mitrovicës dhe Prishtinës. Përmirësimi i lidhjeve rrugore dhe ngritja e kapaciteteve do ta lehtësojnë lëvizjen e njerëzve dhe mallrave, duke reduktuar shpenzimet operative të automjeteve, kohën e udhëtimit dhe ngarkimin e trafikut.

Sa i përket kostos financiare, në bazë të marrëveshjes, Qeveria e Kosovës si huamarrës merr hua një shumë prej 20 milionë dollarë me interes të normës prej 2,75% në vit mbi shumën e kryegjësë së huas. Po ashtu, do të paguajë një tarifë servisimi me normën 1% në vit mbi shumën e kryegjësë së huas. E gjithë marrëveshja do të kalojë nëpërmjet periudhës gri dhe kthimi i huas do të bëhet në 30 keste gjashtëmujore, në shuma dhe data të cekura, nga 15 gushti i vitit 2018 deri më 15 shkurt 2033, me kësht 6 660 dollarë për gjashtëmujor.

Komisioni për Buxhet dhe Financa, në mbledhjen e mbajtur më 20 nëntor 2013, pasi e ka shqyrtuar projektligjin e ka vlerësuar rëndësinë e marrëveshjes që është në interes për zhvillimin ekonomik dhe vlerësoi se kostoja buxhetore do të jetë e përballueshme për Buxhetin e Republikës së Kosovës. Duke pasur parasysh periudhën gri të kthimit të kredisë dhe kushtet e marrëveshjes, njëzëri i ka rekomanduar Kuvendit ta miratojë Projektligjin për ratifikimin e marrëveshjes për hua për financimin e vazhdimit të ndërtimit të rrugës Milloshevë-Mitrovicë, Rruga M2, e lidhur me Fondin OPEC për zhvillimin ndërkombëtar.

I rekomandojmë deputetët që ta miratojnë këtë marrëveshje.

KRYETARI: Mirë, faleminderit! Nëse jeni dakord, shkojmë menjëherë në procedurën e votimit. Të pranishëm janë 92 deputetë.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Me 83 vota për, asnjë kundër, një abstenim, Kuvendi e miratoi Ligjin nr. 04/ L-234 për ratifikimin e marrëveshjes për hua për financimin e vazhdimit të ndërtimit të rrugës

magjistrale Milloshevë-Mitrovicë, Rruga M2, e lidhur ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Fondit OPEC për zhvillim ndërkombëtar.

Vazhdojmë me pikën e pestë të rendit të ditës:

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për prokurimin publik në Republikën e Kosovës

Komisioni FunkSIONAL, në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij në parim.

E ftoj zëvendëskryeministrin Bujar Bukoshi që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI BUJAR BUKOSHI: I nderuar zoti kryetar!

Të nderuara deputete,

Të nderuar deputetë,

Zonja dhe zotërinj,

Më lejoni që para jush ta paraqes Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për prokurim publik në Republikën e Kosovës nr. 04/L- 042. Ky projektligj është miratuar nga Qeveria, më 25 tetor të këtij viti.

Projektligji ka për qëllim ndryshimin dhe plotësimin e dispozitave të caktuara, duke i favorizuar kompanitë vendore dhe ofrimin e shërbimeve në prokurimin publik me qëllim të përmirësimit të ambientit afarist dhe biznesor në Kosovë.

Meqenëse gjatë zbatimit të ligjit ekzistues janë vënë në pah disa mangësi të tij, me ç'rast nuk përcaktohen dispozita konkrete mbi favorizimin e ambientit afarist në Kosovë, lindin nevoja për eliminimin e mangësive dhe zbatimin sa më të mirë të Ligjit për prokurimin publik.

Duke marrë parasysh fazat transitore të zbatimit të 'acquis communautaire' të Bashkimit Evropian, kapacitetet aktuale administrative në Kosovë, si dhe faktin që ky ligj nuk përcakton dispozita konkrete mbi favorizimin e ambientit biznesor në Kosovë, Qeveria ka marrë përsipër ndryshimin dhe plotësimin e këtij ligji me ato dispozita që do të gjejnë zbatim në praktikë.

Element i parë që projektligjin e trajton është se gjatë aplikimit të kriterit të ofertës më të favorshme ekonomike dhe në situatat me oferta të dorëzuara nga ofertuesit vendorë dhe të huaj, që ofrojnë shërbime ose kryejnë punë, autoriteti kontraktues e përzgjedh ofertën e ofruesit më të favorshëm vendor, me kusht që dallimi ndërmjet ofertës më të favorshme të ofertuesit të huaj dhe atij vendor nuk është më i lartë se 10 pikë, në krahasim me ofertën e ofertuesit të huaj.

Po ashtu, gjatë aplikimit të kriterit të çmimit më të ulët të ofruar dhe në situatat me oferta të ofertuesve vendorë dhe të huaj për ofrimin e shërbimeve, ose kryerje të punëve, autoriteti kontraktues e përzgjedh ofertën e ofertuesit vendor, me kusht që çmimi i tij të

mos jetë më i lartë se 15%, në krahasim me çmimin më të ulët të ofruar nga ofertuesi i huaj.

Ky projektligj është bërë në bashkëpunim të ngushtë me Këshillin Kombëtar për Zhvillim Ekonomik, me Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, me të gjitha autoritetet përkatëse të prokurimit publik, përfshirë edhe Autoritetin e Mbrojtjes së Konkurrencës dhe është në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me standardet e Bashkimit Evropian.

Para dhe gjatë hartimit të këtij projektligji janë bërë hulumtime dhe konsultime të gjera nga natyra e kësaj fushe.

Të nderuara deputete,

Të nderuar deputetë,

Ky ishte një informim në pika të shkurtra për përmbajtjen e këtij projektligji dhe ju propozoj që ta miratoni. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka kryetarja e Komisionit për Buxhet dhe Financa, deputetja Safete Hadërgjonaj.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-042 për prokurimin publik në Republikën e Kosovës dhe ka rekomanduar që të miratohet në lexim të parë në Kuvend.

Qëllimi kryesor i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për prokurimin publik në Republikën e Kosovës është përmirësimi i ambientit afarist-biznesor në Kosovë, kështu që duke i favorizuar kompanitë vendore, respektivisht në ofrimin e shërbimeve dhe kryerjen e punëve në procesin e prokurimit publik.

Projektligji ka për synim përmirësimin e mjedisit biznesor, duke i stimuluar kompanitë vendore dhe të kontribuojë në ngritjen e zhvillimit ekonomik. Favorizimi i ofertuesve vendorë do të vijë në shprehje gjatë aplikimit të ofertës më të favorshme ekonomike dhe gjatë aplikimit të kriterit të çmimit më të ulët të ofruar.

Projektligji si i tillë përmban memorandum shpjegues për objektivat dhe synimet që ka për t'i realizuar ligji. Po ashtu, projektligji përmban edhe deklaratën dhe ndikimet buxhetore që vlerësohen pa kosto shtesë për Buxhetin e Kosovës.

Projektligji e përmban edhe deklaratën për përafrim dhe harmonizim me legjislacionin e Bashkimit Evropian, sipas së cilës konkludohet se projektligji është pjesërisht në përputhje me këtë legjislacion.

Duke pasur parasysh faktin se Kosova nuk ka marrëdhënie formale kontraktuale me Bashkimin Evropian dhe gjendet në fazën e hershme të fillimi të negocimit të

Marrëveshjes për Stabilizim-Asociim, dhe duke marrë parasysh eksperiencën e vendeve, të cilat tashmë janë anëtare të BE-së, dhe disa vendeve rajonale që janë në rrugë për t'u bërë anëtare të Bashkimit Evropian, u është njohur e drejta për një zgjidhje të tillë, respektivisht preferenca për produktet dhe kompanitë vendore në Ligjin e prokurimit publik, madje edhe pas nënshkrimit të Marrëveshjes për Stabilizim-Asociim.

Komisioni për Buxhet dhe Financa po ashtu i ka marrë të gjitha arsyetimet e nevojshme nga ministri i Financave, i cili ka qenë i pranishëm, nga përfaqësuesit e Qeverisë, respektivisht nga Zyra e Kryeministrit, si sponsorizuese e këtij projektligji dhe ka ardhur në përfundim që projektligji duhet të votohet në lexim të parë.

Komisioni për Buxhet e ka votuar me shumicë votash, sepse dy anëtarë kanë qenë kundër këtij projektligji. Mirëpo, ne si komision, me shumicë votash rekomandojmë që të miratohet projektligji në lexim të parë, sepse është në interes të zhvillimit ekonomik dhe fuqizimit të kompanive vendore.

Duke i marrë parasysh rrethanat në të cilat jemi ne dhe duke marrë parasysh se një përvojë e tillë ka ekzistuar dhe nuk bie ndesh me direktivat e Bashkësisë Evropiane, meqenëse ende nuk jemi në fazën finale të anëtarësimit në Bashkimin Evropian dhe është praktikë e vendeve të regjionit dhe vendeve, të cilat janë në situata të tilla, ne si Komision për Buxhet dhe Financa kemi rekomanduar që të miratohet në lexim të parë.

KRYETARI: Në emër të grupi të Partisë Demokratike të Kosovës, fjalën e ka deputetja Hasime Krasniqi.

HASIME KRASNIQI: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka shqyrtuar dhe analizuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për prokurimin publik në Republikën e Kosovës dhe në parim do ta mbështetim kur kemi parasysh se ka qenë kërkesë jona dhe ndoshta e të gjitha partive politike që të ketë një favorizim për kompanitë vendore.

Prandaj, ne si Grup Parlamentar ne do ta mbështetim dhe gjithë kontributin tonë do ta japim në Komisionin FunkSIONAL. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Lidhjes Demokratike, deputeti Naser Osmani.

NASER OSMANI: Faleminderit, kryetar!

Është një çështje që duhet të kemi shumë kujdes se si ta trajtojmë këtë draft, që ka ardhur para nesh në lexim të parë.

Çështjet nuk janë mu ashtu siç u dëgjuan këtu, për arsye se Kushtetuta e Republikës së Kosovës e garanton tregun e lirë dhe konkurrencën e barabartë.

Në anën tjetër, institucionet e Kosovës që nga paslufta janë të përqendruara në integritet dhe janë të përqendruara në zhvillimin ekonomik, duke e llogaritur edhe kapitalin e huaj investiv.

Ndërsa me këtë që po na afrohet këtu nuk po krijojmë një balancë, apo një ofertë institucionale për konkurruesit në punë në Kosovë.

Këtu është, dëgjuam edhe nga zëvendëskryeministri, edhe nga të tjerët, por kjo që është ofruar sot nuk është në përputhje me ‘acquis communautaire’.

Edhe deklarata e cila vjen nga Qeveria, them që është pjesërisht në përputhje me legjislacionin e BE-së, ndërsa kërkesa jonë është që të jemi në përputhje të vazhdueshme me ‘acquis communautaire’.

Në anën tjetër, ka shumë keqinterpretime dhe nga pak kamuflime të gjithë kësaj, për arsye se s’kemi të bëjmë me produkte vendore, por kemi të bëjmë me ofrimin e punës dhe të shërbimeve. Ndërsa puna dhe shërbimet nuk garantojnë që do ta kenë edhe ofertën e prodhimeve vendore.

Prandaj, një diskrepancë në favorizimin e dikujt kam frikë që është një përgatitje e ndryshimit të ligjit që bëhet për dikë të caktuar, e nuk haset në regjion, sidomos te shtetet që duan të kenë stabilitet institucional dhe duan të tregojnë seriozitet në këto çështje, që nëpërmjet ligjit dikujt t’i ofrohet një privilegj në krahasim me të tjerët. Para konkursit, para ofertës, të gjithë duhet të jenë të barabartë, absolutisht, pa përjashtime.

Ndërsa benificionet dhe format e tjera të stimulimit të produkteve vendore rregullohen në forma të tjera, por jo me ofertën dhe me kërkesën.

Prandaj, unë si deputet, edhe si i përkushtuar për këto procese integruuese dhe për respektimin e Kushtetutës nuk mund t’ia lejoj vetes që ta përkrah një draft, i cili ka ardhur thjesht për interes të dikujt që të kalojë sot në Parlament. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të “Vetëvendosjes”, fjalën e ka Albana Fetoshi.

ALBANA FETOSHI: Faleminderit, kryetar!

Sa i përket Ligjit të prokurimit publik, ne si Grup Parlamentar mendojmë që ky plotësim-ndryshim është një hap përpara në përmirësimin e këtij ligji.

Por, mund të themi se ka shumë sfida të tjera, mirëpo sfida më e madhe e këtij ligji është moszbatimi, apo më mirë të themi shkeljet e shumta që e përcjellin këtë ligj në praktikë.

Është i mirëpritur fakti që i jepet përparësi në prokurim ofertuesit vendor dhe ne si Grup Parlamentar e mbështetim një gjë të tillë, por mendojmë se këto nene kanë nevojë të plotësohen edhe me një nen, me të cilin u jepet përparësi së pari shërbimeve, prodhimeve vendore.

Gjithashtu, e konsiderojmë të rëndësishme që ato që mund të prokurohen nga ndërmarrjet e vogla dhe të mesme të mos prokurohen nga ndërmarrjet e mëdha, qofshin ato vendore apo të jashtme, sepse në këtë mënyrë krijojmë potencialitet të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

Pra, konsiderojmë që është një hap përpara, por ka nevojë që të plotësohet dhe të ndryshohet edhe më tutje dhe sigurisht që në Komisionin për Buxhet dhe Financa do ta japim kontributin tonë, që të futet edhe një nen, me të cilin do t'u jepet përparësi prodhimeve vendore.

Gjithashtu, e konsiderojmë të rëndësishme që ato që mund të prokurohen nga ndërmarrjet e vogla dhe të mesme të mos prokurohen nga ndërmarrje të mëdha qofshin ato vendore apo të jashtme sepse në këtë mënyrë krijojmë potencialitet të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

Pra, konsiderojmë që është një hapë përpara, ka nevojë që të plotësohet dhe të ndryshohet edhe më tutje dhe sigurisht që në Komisionin për Buxhet dhe Financa do të japim kontributin tonë që të futet edhe një nen ku të jepet përparësi prodhimeve vendore.

Sigurisht që klima këtu nuk është e përshtatshme dhe mund të favorizohen disa ndërmarrje të caktuara, gjithmonë ekziston rreziku. Mirëpo, mendojmë që në parim kjo është në rregull dhe duhet përkrahet.

Sigurisht që kontributin tonë për përmirësimin e këtij ligji do ta japim në komision. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Aleancës, deputeti Xhevdet Neziraj.

XHEVDET NEZIRAJ: Faleminderit, i nderuar zoti kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Ministra,

Unë personalisht në Komisionin për Buxhet, edhe zoti Osmani, kemi qenë kundër, jo që kemi qenë kundër t'i favorizojmë kompanitë vendore, por kemi hezitur për shkak se mos po afrohet dhe po favorizohet ndonjë kompani pa të drejtë, sepse nuk jemi që të lirohen produktet vendore, por në ligj është një shkrim që duhet të ofrohet shërbimi, e kompanitë vendore mund të ofrojnë shërbime me produkte të huaja, me produkte qoftë të Serbisë ose të Maqedonisë, dhe ajo të jetë përfituese. Kjo është nën një.

Nën dy, ne me Kushtetutë jemi vend dhe ekonomi e hapur dhe e lirë e tregut dhe biem në kundërshtim edhe me këtë parim.

Prandaj, janë këto dy vërejtje që unë kam hezitur që të votoj pro këtyre ndryshimeve dhe në Ligjin e prokurimit shpresoj që duhet të ndryshojmë diçka tjetër, e ajo është që prokurimi sa më shpejt të bëhet prokurim elektronik dhe i centralizuar, ku mund t'i mbyllim disa vrima, disa të meta të këtij ligji, sesa plotësim-ndryshime kozmetike, që gjoja në favor të produkteve vendore të fshihet ndoshta diçka tjetër.

Grupi i Aleancës e shih të nevojshme që të favorizohen produktet vendore, por produktet vendore mund të favorizohen me subvencione, mund të favorizohen në forma të tjera, e jo kompanitë vendore të kryejnë shërbime me produkte të huaja vendore. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Koalicionit Kosova e Re, kryetarja Myzejene Selmani e ka fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

Përshëndetje për zëvendëskryeministrat dhe ministrat dhe për të gjithë deputetët, Duke marrë parasysh se është dashur ndoshta të jetë një plotësim-ndryshim i Projektligjit për prokurimin publik, mund të themi se kemi pritur, por jo në këtë mënyrë çfarë ka ardhur sot.

Në këtë mënyrë çfarë ka ardhur sot, Projektligji për plotësim-ndryshim për prokurimin publik është shumë i mangët, për arsye se këtu thuhet, siç u tha edhe nga zëvendëskryeministri, që ka dispozita të cilat e mundësojnë ofrimin e shërbimeve publike vendore, mirëpo në këtë rast të gjithë jemi që kompanitë vendore të kenë përparësi.

Sa jemi në viza-vijë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës do të mbetet të shihet, kur Kosova është për ekonomi të lirë të tregut dhe në ekonominë e lirë të tregut të gjithë janë të barabartë.

Mirëpo, siç po shihet, ky projektligj me këto plotësim-ndryshime, që ka ardhur nga Qeveria e Republikës së Kosovës, është vendosur që në këtë projekt ndryshim të vijnë disa plotësime, të cilat kanë ardhur nga Këshilli Kombëtar për Zhvillim Ekonomik, i cili ka për qëllim plotësim-ndryshimin, apo më mirë të themi ndryshimin e ambientit biznesor në Kosovë.

Mirëpo, në rast se e shohim anën tjetër, nisma e ndërmarrë nga Qeveria për këtë plotësim-ndryshim të këtij ligji e ka edhe anën e kundërt, kur thotë që bie në kundërshtim me parimet e traktatit për funksionimin e Bashkimit Evropian, si dhe me aktet sekondare të aplikueshme në fushë, të cilat parashikojnë konkurrencë të lirë dhe treg fer.

Mirëpo, është edhe një mundësi tjetër, meqë disa vende të cilat nuk janë pjesë e BE-së, në fazat e hershme të negociimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit i kanë këto kushte dhe Kosovës ndoshta i nevojitet për momentin, mirëpo jo të favorizohet vetëm një kompani, por të gjitha kompanitë të jenë të barabarta.

U tha edhe nga deputeti i Partisë Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës që ne ndoshta e kemi pritur edhe një ligj të prokurimit pak më ndryshe, kur ndoshta është koha që në të ardhmen të mendojë edhe ministri i Financave, edhe vetë Qeveria, që ta kemi një ligj të prokurimit elektronik, se e dimë mjaft mirë të gjithë deputetët ku ndodhin këto dobësi në prokurim.

Mirëpo, ne mund t'i japim përkrahje, por prapëseprapë dilemat do të jenë të mëdha se a është viza-vijë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, Jelena Bontiq e ka fjalën.

JELENA BONTIĆ: Hvala predsedavajući!

Poštovani koleginice i kolege,

Uvaženi članovi Vlade,

Poslanička Grupa samostalne liberalne stranke analizirala je Nacrt zakona o javnim nabavkama i podržaćemo ovaj Zakon u načelu, s obzirom da ima za cilj poboljšanje poslovnog okruženja i razvoj domaćih kompanija. Ono što je najbitnije u ovom vremenu, ovim Zakonom poboljšava se ekonomski razvoj Kosova.

Za dodatnu poboljšanje ovog Nacrta zakona daćemo svoj doprinos kroz Komisije. Hvala!

KRYETARI: Në emër të Grupit “6+”, deputeti Fikrim Damka.

FIKRIM DAMKA: Teşekkür ederim sayın başkan.

Kamu alımları Yasa Taslağının değişikliği konusunu grup olarak inceledik. İlk olarak desteklediğimizi ifade etmek isterim. Fakat Hükümetin bu Kamu Alımlar Yasa Değişikliği konusunda belki biraz daha adım atması gerekirdi. Özellikle kamu alımlarında bir veya iki yıl beklemeler oluyor, bu da gerçekten kamu işlerindeki düzensizliği ortaya koyuyor.

Belki bu değişiklikler de, bu yasada öngörülmesi gerekirdi. Bu Yasa Değişikliği tabi ki yerli üretimi, yerli yatırımı desteklemeye yönelik ve inanıyoruz ki bu adımlarla, yerli üreticiler daha rekabete açık, yabancı şirketlerle daha rekabet etme olasılığını ortaya koyacaktır. Tabi ki burda ön plana yine kalitenin çıkması gerekecektir. Çünkü yerli üretim, bu kaliteye de dikkat etmesi gerekir. Ama bu Yasa, inanıyoruz ki bu rekabet ortamında bunu geliştirecektir ve bu Yasa Taslağını, değişikliğini desteklemekteyiz.

KRYETARI: Në emër të Grupit “Zajednička Budućnost”, kryetari Goran Marinković e ka fjalën.

GORAN MARINKOVIĆ: Hvala poštovani predsedniče!

Poslanici, zamenici premijera,

Poštovani ministri,

Poštovane kolege poslanici,

Poslanička grupa “Zajednička Budućnost” pažljivo je razmatrala Nacrt zakona o javnom nabavci i primetila da je po uobičajeno postoje niz jezičkih grešaka i ne ispravnosti verzija na srpskom jeziku.

U Nacrtu zakona primetili smo da je termin ‘domaći ponuđač’ u članu 60a, stav 4. dosta nejasan, gde trebamo sa predlagačem Zakona pojasniti taj termin.

Poslanička Grupa “Zajednička Budućnost” predložiće amandmane na sve neispravnosti oko Nacrta zakona i radom u komisijama daće svoj doprinos.

Danas ćemo podržati usvajanje Nacrta zakona. Hvala!

KRYETARI: Grupet i kryen fjalët e tyre. Fjalën e ka deputetja Hykmete Bajrami.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Në fakt, të dilet sot në Kuvend dhe të flitet kundër kompanive vendore është një gjë të cilën asnjë qytetar i Kosovës nuk e besoj që do ta bënte, aq më pak asnjë deputet i Parlamentit të Kosovës.

Mirëpo, një gjë duhet ta kemi të qartë. Këtu nuk flitet për produkte vendore, nuk flitet ekskluzivisht për kompani vendore - flitet për ofertues vendorë rezidentë.

Do të thotë, nëse një kompani e huaj dëshiron të marrë pjesë në tender, ajo mund të vijë dhe brenda 24 orëve e regjistron biznesin e saj në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë dhe mandej institucioni detyrohet që t'ia japë tenderin, edhe në qoftë se e ka me çmim deri në 15% më të shtrenjtë.

Unë besoj se Qeveria duhet të reflektojë. Qeveria duhet të reflektojë dhe të ulët dhe të shohë se cili është infuzioni dhe stimulimi më i madh që mund t'u bëhet bizneseve vendore.

Unë personalisht mendoj se zbatimi i Ligjit të prokurimit do të ishte ndihma ma e mirë që u bëhet bizneseve vendore. Sot nuk ka kompani vendore në Kosovë me të cilën ju flisni edhe nuk u thotë që ju jep 10 deri 20% për ta fitua një tender. Ky është problemi kryesor. Nuk e kanë ata problemin se po dalin me çmime të larta dhe po u jepet dikujt çmimi më i ulët.

Besoni që kompanitë dalin të katërtat me çmim më të lartë, e dërgojnë ankesën në Organin Shqyrtues të Prokurimit, të tjerave u largohen dokumentet nga dosja e tenderit dhe i katërti me çmim më të lartë e fiton tenderin. Raste të tilla keni plot. Do të thotë, kreu i korrupsionit janë autoritetet kontraktuese, Organi Shqyrtues i Prokurimit, është moszbatimi i këtij ligji.

Mandej, ne si Komision për Buxhet dhe Financa sapo e kemi përfunduar mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit me metoda jo shumë të avancuara. Krejt çfarë kemi mundur të bëjmë është që faktikisht t'i intervistojmë disa prej operatorëve ekonomikë dhe autoritetet kontraktuese dhe kemi parë se ky ligj ka nevojë edhe për plotësim-ndryshime tjera, të cilat nuk na vijnë neve për këtë. Qeveria nuk ka mundur të presë që t'i marrë parasysh rekomandimet e Komisionit për Buxhet dhe Financa.

Për shembull është mungesa e çmimeve referente, është çmimi jo normalisht i ulët, janë gabimet aritmetikore, janë të gjitha këto që edhe autoriteteve kontraktuese, edhe operatorëve ekonomikë, u lejojnë hapësira për ta shkelur ligjin dhe të kalojë kështu, ta vazhdojnë biznesin. Shkelen shumë ligje.

Unë kisha dëshiruar nga zoti zëvendëskryeministër që të tregojë, nëse ka mundësi të përgjigjet, pasi tha, 'pasi e kemi analizuar gjendjen në terren edhe duke e analizuar

përvojën e Ligjit të prokurimit gjatë këtyre viteve', pse ndodh që kompanitë vendore të ofertojnë dhe të dalin më të shtrenjta për 15%, kur e dimë që produktet e huaja e paguajnë 10% doganën në kufij?

Atëherë ky është ambienti i biznesit, këtu duhet të shohim pse kushton një produkt vendor më shtrenjtë 25% se një produkt, i cili prodhohet në Maqedoni, në Shqipëri, në Bullgari, në Turqi, ose diku tjetër? Ky është përmirësimi i ambientit të biznesit.

Ne duhet ta ulim koston dhe kjo nuk bëhet me Ligj të prokurimit. Nuk bëhet duke vënë masa diskriminuese, sepse ne e deformojmë ekonominë e tregut të lirë dhe kemi mundësi që t'u japim hapësirë institucioneve, që ato edhe më tutje të korruptohen. Tregojnë se ky nuk ka qenë i mirë, por ligji e thotë që 15% po të jetë më i shtrenjtë, ai duhet të përfitojë.

Dhe, prapë nëse doni ta stimulojmë prodhimin vendor, ceken 'për produktet vendore'. Dhe, ka masa tjera, ka subvencione, ka investim në sistemin e ujitjes, në infrastrukturë, në zhvillimin rural, por kjo nuk bëhet në këtë formë.

Këto janë lojëra politike që po i bën kjo Qeveri dhe kjo është e patolerueshme. Nuk jemi kundër firmave vendore, por kjo nuk është për t'i favorizuar firmat vendore. E thashë edhe më herët, po e them prapë, për 24 orë një biznes regjistrohet në Ministrinë e Tregtisë dhe të Industrisë dhe thotë 'ja unë jam i regjistruar, e kam degën në Kosovë' dhe çfarë bëni ju? 15% më i shtrenjtë - u bë, e thotë Ligji - po ia japim tenderin.

Ju lutem shumë, keni mendjen kur të votoni. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Zenun Pajaziti.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Anëtarë të Qeverisë,

U dhanë shumë informacione sa i përket mënyrës se si ka ardhur ky projektligj që të amendamentohet përsëri në Kuvend, edhe nga zëvendëskryeministri, edhe nga Komisioni, edhe nga deputetë.

Dëshiroj të ritheksoj ose ta theksoj faktin që ideja themelore për amendamentimin e këtij ligji ka ardhur pikërisht nga një mbledhje e radhës e Këshillit Kombëtar për Zhvillim Ekonomik. Edhe ideja ka ardhur nga kërkesat e shumta të bizneseve vendore dhe konkretisht kjo kërkesë është profilizuar nëpërmjet Odës Ekonomike, nëpërmjet përfaqësuesve të bizneseve vendore që marrin pjesë në takimet, ose në mbledhjet e Këshillit Kombëtar për Zhvillim Ekonomik.

Është mirë që Qeveria e ka marrë këtë propozim, e ka procesuar dhe ka ardhur deri në këtë fazë në Kuvend.

Unë do të kisha thënë që nuk është vetëm kjo çështje që do të duhej të trajtuar. Është mirë të merren parasysh edhe çështjet tjera që kanë të bëjnë me Ligjin për prokurimin publik.

Por, është në kontributin e grupeve parlamentare, të deputetëve, që ta dizajnojnë edhe mënyrën, ta formulojnë ose t'i riformulojnë këto kërkesa që kanë ardhur drejtpërdrejt nga bizneset vendore.

Vetëm fakti që këto biznese vendore kanë kërkuar që të paktën institucionet që shpenzojnë t'i shfrytëzojnë kapacitetet e tyre dhe t'u japin përparësi bizneseve vendore, është një fakt i bollshëm.

Unë mendoj që ne këtu të gjithë jemi që ta shfrytëzojmë foltoren edhe për politikë, edhe për çështje tjera, por është mirë që të mos ekzagjerojmë, ose të mos përdoren të gjitha këto edhe për momente tjera politike, ose elektorale. Është në dorën tonë që ta dizajnojmë sa më mirë këtë projektligj, është mirë që po ashtu ta kemi parasysh edhe faktin, besoj se Qeveria duhet ta ketë faktin që vlerësimet që bëhen për korrupsionin, një numër i madh i çështjeve adresohen pikërisht në institucione dhe në çështje të prokurimit dhe në institucionet e prokurimit.

Është mirë që të kihet parasysh që në këtë fazë, pse jo, të shqyrtohen edhe mundësitë tjera, të amendamentohen. E kemi në dorë, është mirë që edhe Qeveria të jetë aktive sa është projektligji në Kuvend, edhe për çështjet tjera, siç janë ato të prokurimit elektronik.

Ju e dini se ka përvoja të disa vendeve përreth nesh që kanë arritur për një kohë të shkurtër të bëjnë përmirësime cilësore sa i përket sidomos luftimit të korrupsionit me ridizajnimin e këtij projektligji dhe në fokusimin e kapaciteteve për ta organizuar sa më mirë prokurimin, segment i cili në masën më të madhe konsiderohet si burimi më i madh i korrupsionit.

Mendoj që nuk duhet të ndalemi vetëm në çështjet për të cilat është sjellë këtu ky projektligj për t'u amendamentuar, që ka të bëjë vetëm me favorizimin e institucioneve tregtare vendore sa i përket furnizimit të institucioneve, ose punën që e bëjnë institucionet vendore, qendrore dhe lokale, por të shikohet mundësia, meqenëse e kemi këtë projektligj dhe nuk bëhet për çdo ditë, që të shikohet mundësia të avancohet dhe të përmirësohet edhe në segmente tjera, për çka ka vërejtje dhe ka mundësi të bëhen këto. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Unë si shkurt po them: nëse është fjala për ofertues vendorë dhe për biznes vendor, nuk domethënë asgjë, dhe ky ligj nuk është dashur të vijë kështu. Nëse domethënë 'prodhim vendor', atëherë është i arsyeshëm.

Fjalën e ka deputeti Burim Ramadani.

BURIM RAMADANI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputet,

Të nderuara deputete,

Logjika e këtij projektligji që ka ardhur është definitivisht e papranueshme për shumë arsye, por mbi të gjitha i ka dy arsye kryesore.

E para, pjesa për të cilën po flasim për projektligjin ose plotësim-ndryshimin e këtij ligji nuk është pjesë e masave antikorupsion. Dhe, mos harroni se Ligji për prokurim publik në çdo vend tranzicion është një prej masave kryesore antikorupsion.

Dhe, kjo çfarë kemi para nesh është një mundësi më e madhe për rritjen e korrupsionit. Nëse jo, zëvendëskryeministri Bukoshi duhet të na tregojë se në çfarë elementi, në çfarë fushe mund ta parandalojë korrupsionin ky plotësim-ndryshim. Duhet të na tregua patjetër. Si e ndalon? Si e zbret, ose e redukton korrupsionin? Sepse tashmë e kemi edhe në Transparency International, se është një prej fushave më të korruptuara pikërisht te prokurimi publik. Prandaj, kjo është pjesa e parë.

Pra, ky projektligj ose plotësim-ndryshimi, ose sa herë preket Ligji i prokurimit publik, duhet të jetë nën logjikën e masave antikorupsion, dhe po ashtu duhet të na tregojë se a ka shkuar te Këshilli Kombëtar Kundër Korrupsionit, sepse ne e kemi një këshill të tillë që e udhëheq Presidentja. Ne e kemi një agjenci kundër korrupsionit që i jep këto elemente dhe të gjitha këto. Ta shohim nëse është futur në kuadër të krejt kësaj pakoje të masave kundër korrupsionit, i cili vërtet ka rënë në nivel të tmerrshëm.

E dyta, nuk e ndërlidh në asnjë element mbrojtjen e prodhimit vendor, ose dhënies përparësi prodhimit vendor. Përkundrazi, në shumë raste mund ta dëmtojë prodhimin vendor. Në shumë raste mund të sjellë situata kur një prodhues vendor, i këpucëve, për shembull, ose i një produkti tjetër, do të jetë në disavantazh me prodhuesit e tjerë, të cilët ofertojnë nëpërmjet këtyre ofertuesve rezidentë.

Ky është thjesht një improvizim rezident, improvizim i cili vërtet nuk ka për ta sjellë një mundësi më të mirë, as për ambientin biznesor, por në të njëjtën kohë as për mundësinë e parandalimit ose të reduktimit dhe të zvogëlimit të korrupsionit, sepse definitivisht kemi nevojë për masa shumë të forta të parandalimit dhe reduktimit të korrupsionit. Dhe, ky është një shembull se si nuk po shkohet në atë drejtim, por po shkohet pikërisht në drejtimin tjetër që t'i jepet edhe 15% hapësirë më shumë korrupsionit. Faleminderit!

KRYTEARI: Fjalën e ka deputetja Vjosa Osmani.

VJOSA OSMANI: Faleminderit, kryetar!

Unë shumë shkurt dua ta trajtoj vetëm çështjen e përputhshmërisë së ligjit me 'acquis communautaire', një obligim që ky Kuvend e ka sipas Rregullores, e cila është në fuqi dhe na obligon të gjithëve.

Deklarata e Qeverisë e konfirmon që ky ligj nuk është në përputhje me 'acquis communautaire', sepse nuk është në përputhje me një numër traktatesh të BE-së.

Përveç kësaj, një prej parimeve kryesore të 'acquis communautaire' është parimi i hierarkisë së ligjeve, që nënkupton që secili ligj duhet të jetë në përputhje të plotë me Kushtetutën. Besoj që një numër kolegësh tashmë e sqaruan që përderisa Kushtetuta parasheh ekonomi të hapur të tregut dhe konkurrencë të tillë, një ligj i tillë do të binte në kundërshtim me parimin e hierarkisë së ligjeve, që është parim i 'acquis communautaire'.

Unë i kuptoj disa argumente që janë dhënë edhe më herët se kinse ka vende të rajonit që nuk e kanë bërë një ligj të tillë në përputhje të plotë deri në momentin kur e kanë marrë statusin e kandidatit, mirëpo obligimi i Kosovës në këtë rast është i ndryshëm për disa arsye.

Përderisa për të gjitha vendet e rajonit është kërkuar standardi i përafrimit, për Kosovën, sipas Rregullores së Kuvendit, kërkohet standard i përputhshmërisë. Pra, është standard shumë më i lartë i përputhjes me ‘acquis communautaire’, që kërkohet nga ne. Madje, edhe standardi që kërkohet nga Qeveria është i ulët, sepse edhe nga Qeveria kërkohet përafrim, mirëpo nga Kuvendi kërkohet përputhshmëri dhe unë them që edhe në qoftë se Qeveria e ka lejuar një gjë të tillë, Kuvendi nuk do të duhej të lejonte që të kalojë një ligj, qoftë edhe në qoftë se do të jetë ai vetëm për një ditë të vetme në fuqi, i cili kualifikohet si jo në përputhje me ‘acquis communautaire’.

Një vendim i tillë do të ishte në kundërshtim me Rregulloren e Kuvendit. Ky ligj nuk ka kaluar në Komisionin për Integritet Evropian, që ky komision të mund ta jepte një vlerësim të plotë. Megjithatë, ne mendojmë që as në lexim të parë ky Kuvend nuk duhet të regjistrohet se e ka kaluar në ligj, i cili nuk është në përputhje me ‘acquis communautaire’.

Pra, e kemi obligim dhe është një standard shumë më i lartë se që e kanë pasur vendet e tjera të rajonit, sepse si i tillë përcaktohet me Rregulloren e Kuvendit.

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Donika Kadaj-Bujupi

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Faleminderit, kryetar!

Edhe unë e konsideroj, sikur edhe Grupi Parlamentar, që realisht bëhet fjalë për një mashtrim, i cili në fakt më tepër lidhet me përpjekjen e fundit që të legalizohet në njëfarë forme nëpërmjet derës së vogël korrupsioni në Kosovës, sepse realisht ajo që është problemi më i madh në këtë vend është mungesa e zbatimit të Ligjit të prokurimit.

Dhe, sikur sot ta kishim një ligj për zbatimin e këtij ligji, kushtimisht po them, atëherë ndoshta do të kishim filluar të besojmë që ka ndonjë vullnet të mirë.

Po flasim për një ambient politik, për një frymë politike, ku korrupsioni dhe klientelizmi prej viti në vit po rriten dhe kjo është pjesë e përditshmërisë sonë dhe po reflekton edhe në të gjitha instancat, të cilat e bëjnë matjen dhe vlerësimin fatkeq të gjendjes në të cilën është Kosova sa i përket korrupsionit dhe sa i përket mungesës së luftës kundër korrupsionit, përkundër atyre dhjetëra këshillave, të cilët janë themeluar, por të cilët po shihen që nuk janë aspak funksional, ose më tepër janë mediatik, se që në fakt janë substancial.

Pse, për shembull, nëse ka vullnet të mirë të përkrahen kompanitë vendore, nuk përkrahet prodhimi vendor? U tha edhe më herët, janë format e subvencionimit, të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë do ta përkrahnin prodhimin vendor. Si është e mundur që edhe ato pak

para që kanë mbetur në buxhet, e si po duket janë harxhuar krejt edhe në fushatë zgjedhore, t'u jepen kompanive, të cilat do të konkurrojnë me çmim 15% më shtrenjtë, taksat e qytetarëve, të cilat nuk i kemi? Do të thotë, qytetarët e Kosovës kanë arritur në atë varfërinë e skajshme, dhe ju po doni edhe ato 15% të parave, të cilat nuk i kanë, t'ua vidhni nëpërmjet një projektligji, të cilin po mundoheni ta përbironi për derë të vogël.

Pse, për shembull, nuk po merreni me digjitalizimin e sistemit të prokurimit? Këtu të gjitha vendet në rajon kanë avancuar dhe kanë standarde të larta, përveç Kosovës që ka mbetur e fundit. Dhe, Transparency International nuk e tha rastësisht që jemi afër Etiopisë sa i përket gjendjes së prokurimit dhe sa i përket gjendjes së korrupsionit në vend.

Pse prodhimi vendor nuk po përkrahet dhe pse OSHP-ja, që gjithçka mund të jetë, përveçse organ i pavarur, nuk reflekton dhe në fakt është kthyer në organin më të korruptuar në vend?

KRYETARI: Deputetja Teuta Sahatqija e ka fjalën.

TEUTA SAHATQIJA: Faleminderit, kryetar!

Mendoj se ky është një ligj jashtëzakonisht i rëndësishëm, një ligj i cili deri më tash nuk është respektuar ashtu siç duhet dhe kjo nuk është vetëm frazë, por është edhe rezultat i një mbikëqyrjeje të Komisionit për Buxhet dhe ky komision me një mbikëqyrje bukur të thellë e ka analizuar implementimin dhe ka ardhur në përfundim që ligji ka nevojë për ndryshime substanciale dhe për plotësim në shumë aspekte.

Por, në anën tjetër, është interesant se nga Qeveria vjen kërkesa për ndryshim dhe plotësim, kërkesë e cila aspak nuk e respekton atë çfarë ka kërkuar komisioni. Domethënë kërkesat e komisionit nuk futen aspak në këtë plotësim-ndryshim, por është ndryshimi me një urgjencë të jashtëzakonshme, që kërkohet me 15% më lirë, që kompania vendore ta marrë një tender.

Duhet ta kemi të qartë që kjo nuk ka aspak të bëjë me prozimin vendor. Kjo ka të bëjë me kompani. A do të jetë ai tender për shitjen e kompjuterëve, a do të jetë tender për një rrugë, a do të jetë tender për diçka tjetër, por në asnjë mënyrë nuk nënvizohet prodhimi vendor.

Në anën tjetër, duke pasur parasysh që me Sierra Leonen jemi bërë komshinj, së paku në listën e korrupsionit, atëherë ky 15%-sh, 10 deri 15%, më tepër të jetë indikacion se ato para mund të përdoren për t'i korruptuar institucionet të cilat e shpallin tenderin, apo të cilat e mbikëqyrin shpalljen e tenderit, sesa një përkrahje për kompanitë vendore. Në anën tjetër, edhe me këtë projektligj shihet që deklarata e përputhshmërisë me 'acquis communautaire' nuk ekziston, ndonëse aty thuhet që është pjesërisht, duke pasur parasysh që ne ende ne nuk jemi në rrjedha ku e kemi ndonjë obligim, ndonëse në Kushtetutën tonë, në krahasim me shtetet tjera, është obligimi strikt që ne duhet ta kemi ndaj 'acquis communautaire'.

Në anën tjetër, në Kuvendin tonë sillet edhe Ligji për investimet e huaja, ku në mënyrë decitive dhe në mësynë eksplicite tregohet që investimet e huaja do të kenë trajtim sikur investimet vendore. Prandaj, në qoftë se i kemi të gjitha këto parasysh, nën një - që nuk ka të bëjë me prodhimin vendor; nën dy - që nuk ka përputhshmëri me 'acquis communautaire'; nën tre, që Ligji për investimet e huaja është në shpërputhje me këtë ligj dhe; nën katër, duke pasur parasysh që kompanitë vendore nuk janë të stimuluar, së pari nga korrupsioni dhe gjërat tjera, kjo na bën me dije që kjo urgjencë e paparë e Qeverisë më tepër ka të bëjë me një urgjencë për ta krijuar hapësirën e ndonjë kompanie mike të saj që ta marrë një tender shpejt e shpejt, sesa një kujdes i mirëfilltë për kompanitë tona vendore.

KRYETARI: Fjalën e ka ministri Besim Beqaj.

MINISTRI BESIM BEQAJ: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Unë dua edhe një herë të bëhet e qartë se ligji i cili është sjellë për plotësim-ndryshim është një ligj i cili ka për synim dhe, jo vetëm që ka për synim, por do ta stimulojë aktivitetin ekonomik prodhues vendor.

Njëkohësisht, është një projektligj, i cili e adreson çështjen e prokurimit me prioritet. U diskutua shumë këtu në atë se a është në harmoni me Bashkimin Evropian apo jo, me direktivat e Bashkimit Evropian, siç edhe e keni parë edhe deklaratën e Ministrisë së Integrimeve - është pjesërisht, por në faza transitore, të nderuar deputetë, shteteve u lejohet që të bëjnë veprime të tilla, derisa të bëhet edhe nënshkrimi i Marrëveshjes për Stabilizim-Asociim, dhe pastaj ka prapë periudhë transitore. Prandaj, nuk është çështje se a do të jetë kjo një javë apo një muaj, por ka mundësi që prodhimi vendor, respektivisht ndërmarrjet vendore të përkrahen.

Kur them respektivisht, dua të kuptojmë që ne në proceset e tenderimit nëpër të gjitha organizatat buxhetore kemi shumë aktivitete ekonomike, që nuk mund të ofrohen vetëm me prodhim vendor, por mund të ofrohen nga ndërmarrjet vendore. Pra, kemi aktivitet ekonomik. E përmendi këtu dikush kompjuterin. Ne nuk kemi prodhim të kompjuterëve, nuk kemi prodhim të teknologjisë, por kemi ndërmarrje ekonomike, të cilat e bëjnë atë aktivitet këtu, dhe në vend që t'i sjellë dikush tjetër nga jashtë, ato mund ta bëjnë këtë aktivitet në përfaqësinë e tyre që e kanë dhe forcohet pozicioni i ndërmarrjeve tona për të qenë përfaqësuese të denja, të drejtpërdrejta të institucioneve të mëdha.

Prandaj, në këtë drejtim, kisha dashur që këtë të mos e përdorim më shumë për momentin politik, por është çështje e përcaktimit të qartë. Ofertues vendor është ai i cili e ofron një, me bazë të origjinës së prodhimit vendor, caktohet origjina, dihet origjina e mallit, çka kuptohet origjinalizim të produkteve, prandaj në këtë drejtim kisha dashur që të ju lus të gjithë juve që ata kuptoni këtë, jo si tendencë, siç po thuhet për hyrje për derë të vogël, por është një kontribut i drejtpërdrejtë për zhvillimin ekonomik vendor.

Duhet ta themi hapur, pa u turpëruar, sepse jemi duke folur para popullit, para qytetarëve, para ekonomisë tonë, dhe ky propozim nuk është propozim i Qeverisë. Të nderuar deputetë, është propozim i komunitetit të biznesit në kuadër të komisionit qeveritar për zhvillim ekonomik, në të cilin janë përfaqësuesit e tri asociacioneve të biznesit: është Oda Amerikane, është Oda e Ekonomike e Kosovës dhe AKB-ja, të cilat kanë ardhur në këtë propozim për të përkrahur dhe ne kemi qenë mjaft të inkurajuar, kemi debatuar afro 2 muaj e gjysmë me Bashkimin Evropian.

Nuk është kjo çështje që duhet veç të tentohet të hyjë, por është diskutuar edhe me Bashkimin Evropian, a mund të bëhet në periudhën transitore. Dhe, po, mund të bëhet në periudhën transitore. Nuk është shkelje e asnjë rregulle të raporteve me Bashkimin Evropian sa i përket kësaj çështjeje.

U përmendën shumë çështjet e subvencioneve. Do t'ju them që në përkrahje të prodhimit, Qeveria ka ndërmarrë shumë hapa. Subvencionet në fushën e bujqësisë po na i tregojmë efektet e veta.

Të nderuar deputetë,

Ne në periudhën nëntëmuajore të këtij viti kemi rritje të aktivitetit ekonomik në brendi të vendit shumë më shumë sesa është paraparë dhe kjo ndodh falë aktivitetit ekonomik në bujqësi dhe në drejtim të kësaj, ne kemi marrë edhe masa shtesë për ta përkrahur prodhimin. Ju e dini se e kemi hequr TVSH-në për prodhimin primar bujqësor, i cili ndikon së paku në 20 000 njerëz anekënd Kosovës, dhe ndikon edhe në industrinë e tyre prodhuese, dhe kjo kërkesë ka qenë e tyre, sepse nëse flasim për prodhuesit e lëngjeve, ata i marrin ekstraktet e tyre edhe nga jashtë.

Prandaj, nëse themi që është vetëm prodhim vendor dhe pa komponentë të jashtëm, atëherë sigurisht që nuk do ta ndihmonim fort as aktivitetin ekonomik vendor, prandaj po ju lus që gjitha këto gjëra janë gjëra, të cilat ne jemi të interesuar për t'i bërë. Unë i ftoj të gjithë deputetët që ndërmjet dy leximeve, të gjitha ato shqetësime që kanë ardhur nga deputetët, në bazë të rishikimit, realisht në bazë të mbikëqyrjes së zbatimit të ligjit, le t'i thonë, le të inkorporojmë.

Ne jemi në leximin e parë, prandaj ju ftoj që ta kryejnë leximin e parë, t'i inkorporojmë dhe ta bëjmë një ligj të mirë, i cili i ndihmon ekonomisë së vendit. Prandaj, ky është orientimi ynë. Ndërsa, sa i përket, dikush e përmendi 'kjo nuk është masë e antikorrupsionit' - nuk është masë e drejtpërdrejtë kundër korrupsionit, por duhet t'ju them që pardje në Qeveri ka kaluar Ligji për Inspektoratin, që ka të bëjë me mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë. Në Qeveri po them ka kaluar për Administratën Tatimore dhe për ATK, që është një ligj i veçantë që ka të bëjë drejtpërdrejtë me masat antikorrupsion.

Ju e dini se ekziston një njësi për inteligjencë financiare dhe ju lus të gjithë juve, dhe ajo njësi i përgjigjet Ministrisë së Financave. Të gjithë ju që keni çfarëdo lloj shqetësimi sa i përket çfarëdolloj marrëveshjes, shkoni, po ju them janë nga 40 veta shumë kompetentë, të cilët, po ju them publikisht, të gjithë, jo vetëm njerëzve publikë, për të gjithë, është një

listë shumë e madhe të njerëzve, që përcjellin të gjitha transaksionet bankare dhe jobankare që bëhen.

Prandaj, kur flasim për masat korruptive dhe masat antikorruptive, po ju lus që të them, të jemi shumë konkretë, ekziston një masë e mirë dhe, për më shumë, para disa ditësh është nënshkruar një memorandum mirëkuptimi ndërmjet Prokurorisë së Shtetit, Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë të Financave, Doganave, Ministrisë për Inteligjencë Financiare për trajtim me prioritet të të gjitha ankesave të cilat vijnë nga ekonomia.

Prandaj, ju ftoj, nëse dëshirojmë ta ndihmojmë këtë aktivitet, të gjithë ata njerëz që kanë informacione, le t'i informojnë organet dhe kjo zyrë e ky koordinator nacional për luftimin e krimit ekonomik do të jetë i udhëhequr nga një prokuror, i cili do ta pushojë aktivitetin ekonomik të Prokurorisë, por do të merret ekskluzivisht me trajtimin e këtyre çështjeve.

Unë ju bëj ftesë që ta votojmë në leximin e parë. Urdhëroni, të gjithë, edhe ne do të angazhohemi në nivel të Qeverisë, për ta bërë një ligj, i cili e ndihmon zhvillimin ekonomik të vendit. Zhvillimi ekonomik ka nevojë të përkrahet me aktivitete konkrete, të cilat nuk janë në kundërshtim me Bashkimin Evropian, por të cilat në një periudhë të mesme kohore na japin hapësirë për t'i përkrahur ato. Faleminderit!

KRYETARI: Ministër, unë nuk po e kuptoj pse është çështje e memorandumit, pse duhet të nënshkruhet kur është ligji dhe ligji duhet të zbatohet, e jo memorandumit.

Fjalën e ka deputetja Hykmete Bajrami.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, kryetar!

Ministër, unë prapë ju pyes: sa kohë i merr një biznesi të huaj që të regjistrohet në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë? Nëse regjistrohet, a mund të ofertojë ai si biznes vendor? Edhe kësaj pune i thonë, Qeverisë po i pikon çatia, e po mundohet ta ndalë shiun! E keni orientimin gabim. Duhet ta riparoni çatinë. Mos provoni ta ndalni shiun.

KRYETARI: Zëvendëskryeministër, e do fjalën?

ZËVENDESKRYEMINISTRI BUJAR BUKOSHI: Faleminderit!

Zonja deputete dhe zotërinj deputetë,

Siç e patë, mua më ra hise ta lexoj këtë projektligj. Unë, ju kam thënë edhe njëherë se me profesion nuk jam ekonomist, por diçka tjetër, por e kam një ndjenjë se disa gjëra duhet të thuheshin kështu, pasi u hodhën prej shumë deputetëve këtu. Por, duhet ndoshta jo me radhë, por të shpreh së pari komplimentet e mia. Më ofron kënaqësinë që po diskutohet në këtë mënyrë, se nëse nuk e keni harruar kur diskutoheshin disa ligje lidhur me Serbinë, shkonin nga 10-15 flakë përnjëherë.

Është mirë që po diskutohet edhe ky projektligj. Sa më përket mua, unë i mora me seriozitet vërejtjet e deputetes Vjollca Osmani, dhe mendoj se kjo duhet të respektohet.

E dyta, zonja Hykmete Bajrami, tani u fillua këtu edhe me metafora, me figura rreth zbatimit të ligjit, por unë po them ky Parlament po mundohet, në kuadër të shtetformimit e tjera, ta bëjë një ligj. Ky ligj duhet të jetë i mirë. Kjo është, atëherë me metafora, është si puna e sëpatës. Domethënë, e keni një sëpatë të mirë të shkoni për të prerë dru në mal, por nëse nuk dini e në qoftë se abuzoni, atëherë e pritni këmbën tuaj, apo diçka tjetër. Kjo është logjika e ligjit.

Unë për vete jam që pas këtyre diskutimeve, natyrisht do të pasurohej ligji me ndryshime, me vërejtje kompetente, me ekspertiza e tjera, por nuk është ligj krye në vete që është sjellë nga Qeveria, përndryshe nuk do ta lexoja.

Zoti Burim Ramadani më pyeti se si e lufton korrupsionin, në qoftë se m'është drejtuar mua. Atëherë po më ngushton shumë, se nuk jam unë ai i plotfuqishëm për ta luftuar korrupsionin pa ju, por formula do të ishte: korrupsioni, nëse kategorizohet, që është si lloj krimi, është hajni, atëherë për hajnia duhet të denoncohet. Kur denoncohet është prokurori, që e kryen atë punë, nëse prokurori nuk e kryen atë punë, duhet prokurorin të denoncohet dhe të futet në burg. Po mendoj me procedura, jo me mënyrë arbitrare.

Kjo është sa i përket korrupsionit. Është një kancer në shoqëri dhe konsultimet që janë bërë siç i përmendi edhe ministri Beqaj, janë bërë me shumë formacione, vetëm ka mbetur të shkohet edhe te myftiu për ta konsultuar edhe atë për këtë punë.

Ju faleminderit për mirëkuptim, por nuk e ndiej veten kompetent që të futem në çështje doktrinare të këtij ligji alla-zotit Naser Osmani, por logjika flet, e kemi shembuj të mirë edhe prej anëtarëve të Bashkimit Evropian. Austria kur vjen sezoni i dredhëzave, i mbron dredhëzat e veta nëpërmjet Brukselit për një periudhë të caktuar për ta mbrojtur tregun e vet. Është puna e një rezoni për mbrojtjen e produkteve bujqësore. Sa u përket tenderëve, 15%-shave e tjera e tjera, besoni se nuk kam lidhje me ata tenderë. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Burim Ramadani, replikë.

BURIM RAMADANI: Faleminderit, kryetar!

Po shpresoj se kjo puna e dredhëzave nuk ka qenë e shkruar, se zëvendëskryeministri Bukoshi tha 'mua më ka rënë hise ta lexoj këtë që ma kanë shkruar', por ajo që po dua ta them, në pyetjen që ia bëra, realisht ministri Beqaj u përgjigj dhe u përgjigj shumë hapur. Tha 'po kjo nuk është masë kundër korrupsionit'. Prandaj, ne nuk di si mund ta mbështetim një iniciativë, e cila nuk ka lidhje me masat kundër korrupsionit. Faleminderit!

KRYETARI: Replikë, Vjosa Osmani, pastaj ministri Beqaj.

VJOLLCA OSMANI: Kryetar!

Vetëm edhe një herë të sqarohet. Kosova ka obligime ndryshe, sepse në Rregulloren e Kuvendit, më specifikisht Kuvendi ka obligime ndryshe, kërkohet përputhshmëri, jo përafrim. Shtetet tjera e kanë pasur standardin e përafrimit, që është një standard më i

ulët, që është kërkuar nga ato. Nga ne si Kuvend kërkohet një standard më i lartë i përputhshmërisë me rregullat e ‘acquis communautaire’.

Prandaj, përderisa ju si Qeveri na e sillni një ligj, i cili e përmban deklaratën që qartë thotë: është vetëm pjesërisht në përputhje, ne si Kuvend nuk na lejon Rregullorja ta miratojmë atë, prandaj edhe propozova që Komisioni për Integritet Evropian ta japë një vlerësim të vetin lidhur me këtë çështje. Pra, për Kosovën janë kërkuar gjithmonë standarde më të larta, sepse i kemi në Rregullore. Në fakt, në versionin e ri të Rregullores po provohet që të ndryshohet kjo çështje, që të kërkohet vetëm përafrim, mirëpo me atë që është për momentin në fuqi, nga ne kërkohet përputhshmëri, prandaj edhe duhet të sqarohet kjo çështje, që nuk mund të krahasohemi me vendet e tjera.

Në qoftë se ju keni marrëveshje me dikë tjetër, ne nuk kemi dëgjuar asnjë deklaratë nga Bashkimi Evropian, por edhe sikur të kishte një diçka të tillë, Kuvendi obligohet që ta respektojë Rregulloren e vet.

KRYETARI: Në lexim të dytë kërkohet nga Komisioni për Integritet Evropian përputhshmëria e ligjit. Fjalën e ka ministri Beqaj.

MINISTRI BEQIR BEQAJ: I nderuari kryetar!

Të nderuar deputetë,

Sa i përket përputhshmërisë dhe obligimit të Kuvendit, unë e kuptoj. Ju e dini që në këtë Kuvend janë sjellë shumë herë ligje, jo vetëm të harmonizuar, por edhe të përafruara, dhe harmonizimi i legjislacionit nënkupton kur çdo gjë duhet të shkojë konform atij ligji, i cili është në nivel të Bashkimit Evropian, ndërsa përafrimi i adreson gjërat të cilat janë të mundshme për t’u realizuar në vendin i cili është i përgatitur për ta aprovuar një ligj dhe për ta implementuar.

Duhet t’jua marrë vetëm një shembull: Ligji për energji në Kosovë është ligj i harmonizuar me Bashkimin Evropian. Ka kaluar këtu, por implementimi dhe zbatimi i këtij ligji do të duhej, atë ditë që ka kaluar në Kuvend, pra komplet i përafruara, të shpallej i pavlefshëm, sepse nuk ka mundur t’i adresojë dhe ky ligj është aprovuar shumë më herët.

Pra, po flasim për veprime konkrete të cilat mund të ndihmojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë zhvillimin ekonomik, prodhimin vendor dhe ndërmarrjet vendore në Kosovë, ndërsa sa i përket asaj se a është masë antikorruptive, apo nuk është masë antikorruptive, i nderuari deputet, në Qeveri ligjet bëhen dhe çdo ligj i cili aprovohet në Kuvend konsiderohet që është kontribut për vendosjen e rendit dhe ligjit në shtet.

Prandaj unë konsideroj që përkrahja e aktivitetit ekonomik, prodhimit dhe ndërmarrjeve vendore është çështje jashtëzakonisht e rëndësishme, kjo është esenca e këtij ligji, prandaj ju ftoj të gjithëve që të reflektoni pozitivisht në ligj dhe ta bëjmë një ligj sa më të mirë të mundshëm. Por, edhe një herë po ju them, të gjithë ata njerëz të cilët kanë ide, kanë informata për aktivitete jo të lejuara me ligj në nivel të shtetit, urdhëroni, ka mekanizma ndërkombëtarë.

Unë thashë për memorandum, është memorandum i harmonizuar, por Zyra e koordinatorit për luftimin e krimit ekonomik nuk është bazë e memorandumit, por është në bazë ligjore, pra do të jetë një koordinator i cili në nivel nacional do t'i përfshijë të gjitha këto mekanizma dhe i cili do të merret me këtë çështje, prandaj ju bëj thirrje të gjithëve që të kontribuojmë sa më shumë në luftimin e të gjitha dukurive tjera, por njëkohësisht ju bëj thirrje që ta votojmë ligjin në leximin e parë dhe ta përkrahim e ta përmirësojmë atë ligj në masën më të mirë të mundshme, që të jetë një ligj i cili e favorizon ekonominë.

Ligji është sjell për ta favorizuar prodhimin vendor, për t'i favorizuar ndërmarrjet vendore. Kjo është arsyeja pse është sjell ky ligj. Faleminderit!

KRYETARI: Replikë, Naser Osmani!

NASER OSMANI: Kryetar! Nuk po thuhet gjëra të sakta, po kamuflohet. Unë do ta lexoj, thotë kështu: Gjatë aplikimit të kriterit të ofertës më të favorshme ekonomike dhe në situatat me ofertë të dorëzuar nga ofertuesit vendorë dhe të huaj të cilët ofrojnë shërbime ose kryejnë punë, nuk ka kryetar, kurrkund që figuron prodhimi vendor. Fjala është, kryetar për punë dhe shërbime. Dhe po na kamuflohet këtu për ta tejkaluar dhe për ta votuar po flitet për produkte vendore, nuk ka të bëjë me produkte vendore. Mund dikush ta merr një punë që e tha deputeti Neziraj dhe ta bëjë krejt punën me prodhime të Serbisë, por s'ka të bëjë me prodhime vendore. Nëse domi ta fusim, atëherë prodhimet vendore e fusim, të gjithë ata ofertues që përdorin prodhimet vendore kanë një lehtësi deri në 10 pikë ose me 15% të çmimit, por le ta futin që janë për prodhime vendore, por jo me këso kamuflime që ka të bëjë me punë dhe me shërbime.

Nuk është e drejtë kështu t'u drejtohem deputetëve kur në dokumentin që e kanë prurë, kjo nuk figuron fare.

KRYETARI: Unë nuk po di sa replika ka. Hajt, replikë një minutë!

MINISTRI BESIM BEQAJ: I nderuar deputet!

E kemi diskutuar edhe në Komision dhe dua të them edhe një herë. Ne kemi shumë ndërmarrje të cilat nuk kanë mundësi të ofrojnë aktivitet ekonomik vetëm në prodhim vendor. Unë plotësisht pajtohem që ndërmjet dy leximeve ju ta specifikoni edhe prodhimin vendor, por njëkohësisht edhe ndërmarrjet vendore po them, sepse nuk mund t'i lëmë ndërmarrjet vendore të cilat nuk kanë aktivitet ekonomik vendor, të mos u japim përparësi.

Kjo është ideja e këtij ligji, prandaj edhe një herë po ju ftoj, hajde të punojmë të gjithë së bashku dhe ta bëjmë një ligj i cili është më i mirë i mundshëm. Faleminderit!

KRYETARI: Jo, ministër, të jemi korrekt. Ne i kemi dy nene që mund të amendamentohen, do të thotë nuk është në pyetje çështja e ligjit. Nëse është ligji, e doni të bëni ligj të mirë, bëjeni ligjin në tërësi, ne kemi të drejtë si Kuvend vetëm dy amendamente t'i votojmë, por jo më shumë.

(Ndërhyrje)

Jo, nuk e ka propozuar atë, kështu ta mbyllim, do të thotë diskutimet janë kryer, s'kemi më çka të ndalemi në këtë, në vazhdim kërkohet deklarimi me votim për miratimin në parim të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit të prokurimit publik në Republikën e Kosovës. Pra, fjala është për 2 nene që i ka afruar Qeveria. Ne s'mund të ndryshojmë më shumë se 2 nene, se po të kërkojmë ndryshimin e më shumë se 2 neneve që janë afruar, duhet t'i kthehet Qeverisë, prandaj janë 2 nene që duhet të amendamentohen.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Të pranishëm janë 84 deputetë. Prania fizike elektronike 83.

Konstatohet se me 48 vota për, 26 kundër, 2 abstenime, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin numër 04/L-237 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për prokurimin publik në Republikën e Kosovës.

Ngarkohen Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit, ta shqyrtojnë Projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raporte me rekomandime.

Vazhdojmë me pikën e gjashtë të rendit të ditës:

6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin numër 03/L-102

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe procedurat, të ndryshuar dhe të plotësuar me Ligjin numër 03/L-102 dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Ftoj kryetaren e Komisionit Funkcional për Buxhet e Financa, deputeten Safete Hadërgjonaj që para deputetëve të arsyetojë raportin me rekomandime.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, kryetar!

Komisioni për Buxhet dhe Financa, në pajtim me Rregulloren e Kuvendit e ka caktuar Grupin punues për hartimin e propozimeve të projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit numër 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, të ndryshuar dhe të plotësuar me Ligjin numër 04/L-102.

Kryesues i këtij Grupi punues është caktuar zëvendëskryetari i parë i Komisionit, zoti Naser Osmani, i cili ka kryer punët bashkë me grupin në kohë të caktuar. Grupi punues ka punuar bashkërisht edhe me Ministrinë e Financave ku janë dhënë sqarime të

nevojshme rreth plotësim-ndryshimeve të cilat janë kërkuar në Projektligjin për plotësim-ndryshim.

Grupi punues, bashkërisht kanë harmonizuar qëndrimet dhe raportin me propozime e kanë proceduar në shqyrtim dhe miratim në Komision.

Komisioni për Buxhet dhe Financa i ka shqyrtuar propozim-amendamentet e Grupit punues për Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit numër 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe procedurat, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin numër 04/102 dhe njëzëri i ka miratuar amendamentet e propozuara dhe raportin me amendamente e ka proceduar për shqyrtim në komisionet tjera të përhershme sipas kompetencës së tyre.

Komisioni për Buxhet dhe Financa, në mbledhjen e mbajtur më 12 nëntor e ka shqyrtuar raportin me rekomandime të Komisionit për Legjislacion i cili ka kundërshtuar një nen të këtij amendamenti në Komisionin për Buxhet dhe Financa dhe ka vlerësuar se rekomandimet e Komisionit për Legjislacion nuk janë të specifikuara dhe për më tepër nuk kanë mbështetje dhe referencë të saktë, sepse neni 25 i Projektligjit dhe amendamenti 4 i Komisionit FunkSIONAL janë në kundërshtim me Kushtetutën dhe ligjin zbatueshëm.

Për shkak të natyrës specifike të projektligjit, respektivisht të mandatit të Bordit të Pavarur për Rishqyrtime dhe anëtarëve të këtij bordi, është propozuar që mandati i bordit dhe i anëtarëve të vazhdohet në këtë ligj deri më 31 dhjetor të vitit 2014, kur pritet të përfundojë shqyrtimi i të gjitha ankesave ndaj vendimeve të organeve doganore dhe tatimore që janë parashtruar në bord deri më 30 nëntor 2012.

Ndërkaq, nga 1 dhjetor 2012 përgjegjës dhe kompetent për pranimin dhe shqyrtimin e ankesave ndaj vendimeve të organeve të sektorit të ankesave është Gjykata Themelore e Prishtinës, respektivisht Divizioni fiskal i Departamentit administrativ të kësaj gjykate.

Komisioni për Buxhet dhe Financa nuk ka përkrahur rekomandimet e Komisionit për Legjislacion duke pasur parasysh se në këtë bord kanë mbetur ende edhe 1 250 lëndë të pashqyrtuara dhe njëzëri ka vendosur që t'i rekomandojë Kuvendit të miratojë projektligjin në amendamentet e Komisionit FunkSIONAL me konstatimin se amendamenti nuk bie në kundërshtim me Kushtetutën e vendit.

KRYETARI: Fjalën e ka kërkuar deputeti Arben Gashi.

ARBEN GASHI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Fjalën po e marr në emër të Komisionit për Legjislacion, meqenëse zonja Hadërgjonaj ka paqartësi dhe pretendon që Komisioni për Legjislacion nuk ka dhënë arsyeshmërinë e duhur, unë po e marr përsipër ta lexoj arsyetimin e Komisionit për Legjislacion.

Komisioni për Legjislacion i rekomandon Komisionit FunkSIONAL që neni 25 i projektligjit dhe amendamenti 4 të riformulohen.

Arsyetim: Komisioni për Legjislacion, në mbledhjen e mbajtur më 21.10.2013, shqyrtoi projektligjin dhe amendamentet e propozuara dhe konstatoi se projektligji me amendamentet e propozuara nuk është në kundërshtim me Kushtetutën dhe ligjet e zbatueshme, përveç nenit 25 dhe amendamentit 4.

Në dispozitën e nenit 4 të Ligjit numër 04/L-102 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe procedurat numër 03/L-222 është hequr baza ligjore që përcakton subjektin që i propozon, që i emëron dhe për mandatin e anëtarëve të bordit.

Me këtë dispozitë është përcaktuar kompetenca e bordit për rishqyrtim për të shqyrtuar me të gjitha ankesat të cilat duhet të dorëzohen deri më 30 nëntor 2012.

Po ashtu edhe me dispozitën e nenit 6 të këtij ligji është caktuar afati 31 dhjetor 2013 për përfundimin e të gjitha rasteve të pazgjidhura nga bordi.

Andaj, Komisioni për Legjislacion vlerëson se mandati i disa anëtarëve të bordit ka përfunduar, kurse i disa tjerëve është duke vazhduar mbi bazën e vendimit për emërimin e tyre dhe duhet të përfundojë në pajtim me mandatin e përcaktuar me atë vendim. Pasi që baza juridike për propozim, emërim dhe mandat të anëtarëve të bordit është hequr është e nevojshme që me këtë ligj të përcaktohet autoriteti që propozon, emëron dhe mandati i anëtarëve të bordit.

Ndërtimi i praktikës duke futur dispozita me fuqi retroaktive dhe për zgjatje dhe ndërprerjen e mandatit me ligj, pa u nënshtuar procedurave formale paraqet bazë për diskriminim dhe krijon precedent të panevojshëm në praktikën e hartimit të legjislacionit.

Duke u bazuar në faktet e theksuara Komisioni për Legjislacion i rekomandon Komisionit FunkSIONAL që neni 25 i Projektligjit të riformulohet duke definuar procedurat për propozimin, emërimin dhe mandatin e anëtarëve të bordit.

Më qartë, më saktë, më i drejtpërdrejtë nuk di qysh mund të jetë. Nëse nuk e kam të qartë, prapë mund t'u ofrojmë ndihmë dhe ta sqarojmë, por mendoj se sqarimi dhe interpretimi është shumë i saktë dhe për të mos u përsëritur në diskutimin tim, edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike qëndron prapa këtij formulimi dhe përkrah qëndrimin e Komisionit për Legjislacion. Faleminderit!

KRYETARI: Edhe unë po pajtohem, por ne nuk votojmë rekomandim, ne votojmë amendament. Nuk e keni bërë ju amendamentin që ne ta votojmë sot. Fjalën e ka deputetja Safete Hadërgjonaj, kryetare e Komisionit.

SAFETE HADËRGJONAJ: Kryetar, e shoh të nevojshme ta jap edhe një sqarim. Rekomandimet të cilat i ka dhënë Komisioni për Buxhet dhe Financa, nuk janë rekomandime të mia, ashtu siç u deklarua parafolësi. Ato janë rekomandime të cilat janë amendamente të miratuara nga Komisioni për Buxhet dhe Financa dhe janë të miratuara unanimisht nga të gjithë anëtarët e Komisionit për Buxhet dhe Financa.

Mua më duhet të them se Komisioni për Legjislacion, në rekomandimin e tij është dashur të japë sqarime të nevojshme se me cilin nen të Kushtetutës është në kundërshtim neni 25 i projektligjit dhe ta japë arsyetimin.

Komisioni për Legjislacion ka dhënë vetëm rekomandim të përgjithshëm, pa dhënë zgjidhje se si duhet të veprohet në raste të tilla. Komisioni për Legjislacion si Komision kompetent, përveç opinionit që e ka konsideruar nenin si në kundërshtim me Kushtetutën, në rekomandim është dashur të afrojë edhe zgjidhje duke afruar amendament ose një opinion se si duhet të zgjidhet problemi i tillë ligjor.

Neni 25 ka për qëllim të zgjidhë një situatë të paparë e përkohshme dhe për fazë tranzitore.

Në Ligjin për Administratën Tatimore është paraparë që bordi t'i zgjidhë kërkesat e paraqitura deri më 30 nëntor 2012.

Puna për shqyrtimin e kërkesave është dashur të përfundojë më 31 dhjetor 2013, por nuk është arritur të zgjidhen kërkesat dhe kanë mbetur edhe 1 260 kërkesa të pazgjidhura për këtë periudhë dhe është shfaqur nevoja për vazhdimin e mandatit të bordit deri me 31 dhjetor të vitit 2014.

Në momentin kur ka ardhur ligji nuk u ka skaduar mandati anëtarëve të bordit dhe u kërkuar që të vazhdohet, mirëpo për shkak të rrethanave të cilat i ka pasur Parlamenti dhe nuk kemi mbajtur mbledhje ashtu siç është dashur të mbahet, tash po miratohet pak me vonesë për çka edhe e kemi shënuar në amendamentin, të cilin e ka dhënë Komisioni për Buxhet.

Vazhdimi i mandatit nuk është në kundërshtim me asnjë nen të Kushtetutës, së paku Kushtetuta as nuk flet për këtë çështje. Situata e tillë është situatë kalimtare, sepse me Ligjin për tatimin në pronë, me Ligjin për TVSH, në Ligjin për tatimin e të ardhurave personale, Ligjin për të ardhurat e korporatave është paraparë që këto kërkesa të paraqitura pas 1 dhjetorit 2012 t'i shqyrtojë Divizioni fiskal i departamentit për çështje administrative në Gjykatën Themelore të Prishtinës.

Në vazhdimin e mandatit të bordit nuk cenohet asnjë e drejtë e ndonjë pale në procedurë as e anëtarëve të bordit, por vetëm mund të fitojë të drejta. Kjo nuk është kundërshtuese, sepse ka për qëllim rregullimin e një situatë kalimtare për një organ që do të shuhet sipas ligjit dhe kompetencat e tij do të kalojnë në gjykatë.

Nëse duhet t'i zgjedhë sërish anëtarët e bordit, kjo është në kundërshtim me Ligjin për tatimin në pronë që parasheh kalimin e kompetencave në gjykatë. Gjithashtu zgjedhja nuk është e mundur, sepse janë fshirë nenet e Ligjit për Administratën Tatimore që e kanë rregulluar procedurën e zgjedhjes.

Gjithashtu nëse do të fillohet me procedura të zgjedhjes kjo do të marrë kohë, sepse së pari duhet të ndryshohet Ligji për Administratën Tatimore duke krijuar bazën e zgjedhjes

dhe pastaj procedurat, konkursi i zgjedhjes dhe kështu do të ketë zvarritje në procedurën e zgjedhjes së kërkesave të grumbulluara e që mund të paraqitet si shkelje e të drejtës së palëve në procedurë administrative për zgjidhjen e kërkesave në kohë të arsyeshme. Kjo mund të shkelë nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut që kërkon një proces të shpejtë dhe efektiv për shqyrtimin e kërkesave të palëve në një procedurë administrative ose gjyqësore. Faleminderit, kryetar!

KRYETARI: Në emër të Komisionit sqarim, replikë 2 minuta i ke tash.

ARBEN GASHI: Faleminderit, kryetar!

Unë po marr të drejtën të lexoj vendimin e nënshkruar nga zonja Hadërgjonaj, pika b) zgjidhja, thotë: Ndryshimet dhe plotësimet e propozuara me këtë projektligj kanë për qëllim kryesor zgjatjen e mandatit të Bordit të pavarur për shqyrtimin e ankesave deri në fund të vitit 2014, ku është vlerësuar se deri në atë kohë do të zgjidhen të gjitha ankesat e tatimpaguesve që janë pranuar nga bordi deri më 30 nëntor 2012.

Njëkohësisht me këtë projektligj është propozuar që anëtarëve aktual të bordit t'u vazhdohet mandati deri në përfundim të mandatit të bordit. Dy probleme konceptuale juridike- kushtetuese.

Nuk ka fuqi prapavepruese ligji dhe nuk mund të vazhdohet mandati me një ligj për derisa emëruesi dhe shkarkuesi kanë qenë dikush tjetër. Ky është problem konceptual ligjor dhe kushtetues dhe bazohet në rekomandimin që e ka dhënë zonja Hadërgjonaj. Gjithsesi vendos Kuvendi. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit Arben! Fjalën e ka deputetja Albana Fetoshi.

ALBANA FETOSHI: Faleminderit, kryetar!

Është hera e dytë brenda dy vjetëve që ky ligj po vjen për plotësim- ndryshim dhe për të njëjtën arsye që t'i zgjatet mandati anëtarëve të Bordit për shqyrtimin e ankesave.

Këtij bordi i është zgjatur mandati në vitin 2013 deri më 31 dhjetor të vitit 2013 dhe ne si Grup Parlamentar e kemi përkrahur në atë kohë këtë plotësim-ndryshim të ligjit me mendimin që do të shqyrtohen të gjitha ankesat dhe mandej do të përfundojë edhe mandati i këtij bordi.

Mirëpo, po e shohim që edhe në këtë vit na ka ardhur plotësim-ndryshim ligji pikërisht për të njëjtën arsye që t'i zgjatet mandati bordit për shqyrtimin e ankesave, mendoj se kjo është shumë jo serioze, është dashur që të përfundojë puna dhe ne si Grup Parlamentar nuk do ta përkrahim një plotësim-ndryshim të tillë të ligjit për shkak se nuk e dimë nëse kjo praktikë do të përfundojë vitin tjetër apo jo, nëse na ka ardhur në dy vjet rresht për të njëjtën arsye që të plotësohet ligji kur e dimë që nuk do të na vijë prapë edhe në vitin tjetër një kërkesë e tillë që të zgjatet mandati i këtij bordi për shqyrtimin e ankesave.

Mendojmë se kjo është shumë joserioze dhe nuk do ta përkrahim një propozim të tillë.

KRYETARI: Faleminderit! Deputeti Naser Osmani e ka fjalën.

NASER OSMANI: Faleminderit, kryetar!

Do të mundohem që të jap zgjidhje. Jam ai që kam votuar dhe kam menduar se kjo është zgjidhja më e mirë, por krejt problemi është që nuk është shqyrtuar amendamenti me kohë dhe na ka prurë tash në një situatë krejt tjetër.

Nuk kemi ligj për të zgjedhur një bord të ri, me procedurat të cilat po i kërkon Komisioni për Legjislacion. Ligji që është në fuqi, kryetar e thotë qartë që Departamenti i Gjykatës për shqyrtimin e këtyre ankesave kërkon që të jenë vetëm kërkesa të reja, domethënë starton me zero, me të reja. Dhe e vetmja gjë që neve tash na mundësohet apo jemi të detyruar për t' u kthyer dhe për ta amendamentuar ligjin e ri që është në fuqi që këto 1 400 lëndë të pashqyrtuara për t'ia gjuajtur Gjykatës. Është e vetmja mundësi.

Prandaj, duhet tash të na jepni kohë që ne të hyjmë në procedurë të amendamentimit të ligjit të ri, aty ku thuhet që shkon me lëndë të reja për t' i pranuar lëndët e mbetura dhe të vazhdojë gjykata t' i trajtojë se është fjala për 1.400 lëndë që nuk janë trajtuar. Kjo është e vetmja mundësi që unë e shoh.

KRYETARI: Faleminderit! Megjithatë, është Kuvendi që vendos. Ne po shkojmë në votim të amendamenteve. Janë gjithsej 5 amendamente.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë tash amendamentin e parë.

Amendamenti 1.

Me 42 vota për, 20 kundër, 7 abstenime, miratohet amendamenti 1.

Të pranishëm janë 77 deputetë.

Amendamenti 2.

Me 45 vota për, 20 kundër, 7 abstenime, miratohet amendamenti 2.

Tani e votojmë amendamentin e tretë dhe votojmë tash.

Amendamenti 3.

Konstatohet se me 44 vota për, 20 kundër, 6 abstenime miratohet amendamenti 3.

E votojmë amendamentin e katërt dhe votojmë tash:

Amendamenti 4.

Konstatohet se me 44 vota për, 21 kundër, 7 abstenime miratohet amendamenti 4.

Votojmë amendamentin e pestë dhe votojmë tash:

Amendamenti 5.

Me 44 vota për, 22 kundër, 7 abstenime, miratohet amendamenti 5.

Tani e votojmë ligjin në tërësi. Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash!

78 deputetë janë pranishëm.

Me 45 vota për, 24 kundër, 6 abstenime, Kuvendi e miratoi Ligjin numër 04/L-223 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe procedurat, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin numër 03/L-102.

Tani e bëjmë një pauzë dhe në orën 14:00 e vazhdojmë seancën.

* * *

Vazhdimi i mbledhjes pas pauzës

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Jakup Krasniqi

KRYETARI: Të nderuar deputetë, e vazhdojmë seancën me pikën e shtatë të rendit të ditës:

7. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për lojërat e fatit

Komisioni për Buxhet e Financa e ka bërë mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për lojërat e fatit dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime.

E ftoj kryetaren e Komisionit për Buxhet e Financa deputeten, Safete Hadërgjonaj, për arsyetimin e raportit me rekomandime.

SAFETE HADËRGJONAJ: Kryetar, në emër të Komisionit raportin do ta arsyetojë Naser Osmani, sepse ka qenë kryetar i Grupit punues.

KRYETARI: Atëherë, fjalën e ka Naser Osmani.

NASER OSMANI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Duke u bazuar në rregullën 73 të Rregullores së Kuvendit të Kosovës, Komisioni për Buxhet dhe Financa nëpërmjet grupit punues ka bërë mbikëqyrjen e zbatueshmërinë në praktikë të Ligjit për lojërat e fatit.

Grupi ka bërë vlerësimin e vet duke u bazuar në të dhënat nga dëgjimet në Administratën Tatimore, në Doganat e Kosovës, në Lotarinë e Kosovës si dhe nga vizitat të cilat i ka bërë gjatë verifikimit në terren.

Gjithashtu Grupi punues ka pasur fokus që të vlerësojë nëse Qeveria e Kosovës dhe Ministria e Financave së bashku me institucionet relevante për zbatimin e këtij ligji që

janë Administrata Tatimore dhe Doganat e Kosovës janë duke i përmbushur obligimet që dalin nga ky ligj.

Gjatë mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit për lojërat e fatit, Grupi punues ka arritur që të mbledhë të dhënat e mjaftueshme mbi nivelin e zbatimit të Ligjit, duke u bazuar në ato të dhëna ka identifikuar fusha të ndryshme ku ligji, ose nuk është zbatuar tërësisht, ose nuk është zbatuar fare.

Grupi punues ka arritur me sukses të përmbyllë aktivitetet e planifikuara në planin e veprimtari për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për lojërat e fatit dhe gjatë gjithë procesit të mbikëqyrjes ka realizuar disa aktivitete, si:

Është bërë identifikimi i kërkesave ligjore dhe personave përgjegjës për zbatimin dhe monitorimin e ligjit, si dhe përcaktimi i detyrave dhe përgjegjësi të tyre.

Ka bërë disa takime me institucionet relevante si Administrata Tatimore e Kosovës, Doganat e Kosovës, si dhe Lotaria e Kosovës.

Gjithashtu në mënyrë që të verifikohet situata faktike në terren janë bërë disa vizita në tri qytete ku këto veprimtari janë më të shprehura si në Prishtinë, Vushtrri dhe në Prizren.

Nga tri aktivitetet e përmendura është konstatuar se ka mosrespektim dhe moszbatim të ligjit, qoftë nga institucionet relevante, por edhe nga vetë personat që ushtrojnë aktivitetin e lojërave të fatit si më poshtë.

Qeveria e Kosovës duhet të caktojë sa më parë bordin udhëheqës të Lotarisë së Kosovës në mënyrë që t'i zgjedhë organet legjitime, të regjistrojë Lotarinë si ndërmarrje publike, të caktojë shkallën e kontributeve që do të duhej të derdhen në Buxhetin e Kosovës për t'i mbështetur organizatat humanitare që duhet ato mbasandaj të ndahen për përkujdesjen e fëmijëve të dëshmorëve, për jetimët, për fëmijët me të meta, për të drejtat e njeriut, për zhvillimin e kulturës, zhvillimin e sportit, e tjera.

Dogana e Kosovës duhet të shtojë hetimin për të siguruar se po përmbushet obligimi i normës së tatimit të akcizës për aparate. Që konfiskimi i aparateve t'i kalojë Administratës Tatimore dhe të harmonizojë shënimet me Administratën Tatimore në mënyrë që të eliminohen mbi 886 aparate që funksionojnë në Kosovë në mënyrë ilegale.

Administrata Tatimore duhet të gjejë mënyrën për t'iu shmangur konfliktit të interesit si organ licencues mbikëqyrës dhe kontrollues. Ajo duhet t'i përmbushë kërkesat ligjore me rastin e vazhdimtë të licencave si dhe duhet të evidentojë numrin e saktë të të punësuarve në këtë veprimtari, pasi ka shumë të padëkluar.

Gjendja faktike në terren tregon se ka shkelje të ligjit, sidomos nuk respektohen distanca ligjore ndërmjet lokalit që duhet të jetë afër njëra me tjetrën në një largësi prej 300 metrave, si dhe distanca 500 metra nga objektet arsimore, institucionet shkollore, shtetërore, kulturore, fetare.

Po përmend vetëm një shembull të monitorimit të lokalit në Prishtinë, të ashtuquajturat lokale të “Lesnës”, ku ky aktivitet ushtrohet me më shumë se në 10 lokale në një distancë prej 20 apo 30 metra larg njëra nga tjetra dhe 50 metra larg nga Administrata Tatimore, Fakulteti Filozofik dhe çerdhja e fëmijëve. Për këtë janë dëshmi edhe fotot, të cilat ia kemi bashkëngjitur raportit të punës.

Prandaj, Qeveria e Kosovës së bashku me Ministrinë e Financave duhet të caktojë numrin e lokaleve që do të ushtrojnë këtë veprimtari në Kosovë që mos të lihet mundësia që këto lokale të jenë kudo nëpër Kosovë dhe me numër sa të donë ato vetë. Prandaj, Komisioni i ka bërë këto rekomandime:

1. I rekomandohet Qeverisë së Kosovës që t’i përmbushë detyrimet e saj ligjore në lidhje me veprimtaritë e lojërave të fatit si më poshtë: të bëjë garantimin e pagesës së fitimeve nga lojërat e fatit të cilat i organizon Lotaria e Kosovës si është e paraparë në nenin 7 paragrafi 4 të Ligjit për lojërat e fatit.

a). Të emërojë anëtarët e Bordit menaxhues të Lotarisë së Kosovës, siç është paraparë në nenin 8 të Ligjit për lojërat e fatit të vlerësojë dhe përcaktojë shkallën e kontributeve të cilat Lotaria e Kosovës do t’i derdhë në Buxhetin e Republikës së Kosovës me propozim të ministrit të Financave, siç është paraparë në nenin 23, paragrafi 1 të Ligjit mbi lojërat e fatit.

2. Të aprovojë numrin e përgjithshëm të klubeve në të cilat organizohen lojëra të fatit me automate të propozuar nga Ministria e Financave siç është paraparë në nenin 65 të Ligjit për lojërat e fatit.

Rekomandime që Administrata Tatimore e Kosovës t’i përmbushë:

a). Të shtojë aktivitetet e saja për mbikëqyrje më të mirë të veprimtarive të lojërave të fatit në përmbushjen e obligimeve që dalin nga ky ligj.

b). Të zbatojë nenet 66, paragrafi 2.4 dhe paragrafi 2.6 të Ligjit të lojërave të fatit për respektimin e distancës ndërmjet klubeve të lojërave të fatit më së paku 300 metra dhe më së paku 500 metra prej objekteve edukativo- arsimore dhe institucioneve historike fetare dhe pronës komunale.

c). Të zbatohet neni 25, paragrafi 1 sipas të cilës kërkohet që në klubet e bastoreve sportive të mos ketë edhe automate të lojërave të fatit.

3. U rekomandohet Doganave të Kosovës që kompetencën e konfiskimit dhe të magazinimit të aparateve jashtë përdorimit t’ia kalojë Administratës Tatimore të Kosovës, që është organ përgjegjës sipas ligjit. Të ngritë bashkëpunimin me Administratën Tatimore të Kosovës duke i rishikuar edhe një herë informatat në mënyrë që të zbulojë numrin e saktë të aparateve të cilat janë në përdorim në tregun e zi dhe për të cilat nuk është mbledhur akciza.

Të nderuar deputetë,

Lojërat e fatit në Kosovë kanë marrë hov të madh në vitet e fundit. Në Kosovë lojërat e fatit më së shumti janë të frekuentuara nga mosha mesatare dhe të rinjtë, pra nga mosha më vitale më produktive e shoqërisë, por edhe frekuentimi i adoleshentëve po tregon rritje të vazhdueshme.

Frekuentimi i madh në lojërat e fatit po sjell në vete probleme të shumta në familje dhe raste dhune, shkatërrimin e familjes si dhe individit bixhozxhi bëjnë që të rritet fatura sociale e shtetit në disa raste edhe në mënyrë të pakompensueshme.

Ndikimi i lojërave të fatit është i shtrirë në shumë dimensionë politike të familjes, në atë shëndetësore, sociale, ekonomike dhe ligjore.

Varshmëria ndaj lojërave të fatit aq sa është brengosëse për dëmet e mëdha materiale që i sjellin personit dhe familjes, po ashtu edhe për faktin se merr përmasa patologjike.

Efektet negative nuk mbeten vetëm në rrafshin personal psikosocial dhe financiar, ato zgjerohen në familje, në vendin e punës, në komunitet e tjerë.

Meqenëse Kosova është vend në tranzicion dhe studimet tregojnë se këto efekte bëjnë të paevitueshme shtimin e varfërisë, problemet që vijnë nga përfshirja në lojërat e fatit janë të mëdha në numër dhe mjaft serioze.

Përveç përfitimeve të shtetit nga taksat e këtyre lojërave, krahas humbjes dhe pasojave negative, përfitime ka vetëm një grup i caktuar si qiradhënësit e lokaleve, pronarët dhe ata të cilët në një formë apo tjetrën janë të lidhur me ta, por nuk i kompensojnë themelet e një shoqërie të shëndoshë të bazuar në familjen e mirë tradicionale apo moderne.

Shteti së bashku me institucionet e tij mban përgjegjësinë kryesore të ndërtimit të familjes së shëndoshë, andaj është e nevojshme të krijojë edhe mekanizmat për mbrojtjen e saj.

Prandaj, Komisioni për Buxhet dhe Financa ka bërë rekomandimin e katërt, që të nisë nismën për hartimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për lojërat e fatit. Faleminderit për vëmendjen, zoti kryetar!

KRYETARI: Mendoj që u trajtua një temë interesante. Tani është radha e grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, fjalën e ka deputetja Hasime Krasniqi.

HASIME KRASNIQI: I nderuar kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka shqyrtuar dhe analizuar këtë raport me rekomandime për zbatimin e Ligjit të lojërave të fatit dhe në parim do ta mbështetë gjithë punën që e ka bërë Grupi punues dhe në përgjithësi Komisioni Funkcional dhe do t'i mbështetë rekomandimet e dhëna nga Komisioni Funkcional. Ju faleminderit!

KRYETARI: Në emër të “Vetëvendosjes”, Albana Fetoshi e ka fjalën.

ALBANA FETOSHI: Faleminderit, kryetar!

Mendoj që Grupi punues e ka bërë një punë të mirë sa i përket rekomandimeve që i ka dhënë për moszbatimin e Ligjit për lojërat e fatit. Mendoj që ky ligj nuk po zbatohet për shkak të numrit të madh të kazinove që ekzistojnë këtu edhe nuk po respektohet distanca që ekziston që të ketë 300 metra ndërmjet këtyre objekteve të lojërave të fatit edhe ne si Grup Parlamentar i mbështesim rekomandimet që kanë dalë nga Komisioni për Buxhet dhe Financa, mirëpo i kemi vërejtjet tona sa i përket moszbatimit të ligjit.

Përhapja e kazinove, bastoreve sportive dhe kompanive të tjera që organizojnë lojëra fati në Kosovë, ka krijuar një situatë të papranueshme me shkelje të ligjeve të Kosovës, në shkallën e një plaje të vërtetë shoqërore.

Në çdo komunë dhe në çdo vendbanim ku janë licencuar këto kompani ka shkelje sistematike të Ligjit të lojërave të fatit, por situata me sa duket nuk i shqetëson institucionet tatimore dhe as Qeverinë edhe pse me qindra kazino, bastore dhe aparate elektronike, lojërash fati operojnë haptazi dhe qartazi në kundërshtim me ligjin.

Është shokues fakti se nenet 60, 66, 70 dhe 72 të Ligjit për lojërat e fatit në të cilat definohen kushtet për licencim të ndërmarrjeve në fjalë më shumë shkelen sesa respektohen nga ATK-ja që është agjencia përgjegjëse pikërisht për të garantuar zbatimin e ligjit.

Afërsia e drejtpërdrejtë e lojërave të fatit me shkollat, institucionet historike e fetare apo pronat komunale, tashmë nuk është ndonjë ngjarje e rrallë, por një dukuri e përgjithshme edhe pse ligji e ndalon këtë gjë shprehimisht. Shumica dërmuese e kazinove dhe bastoreve duket se kanë strategji biznesi afërsinë me shkollat, sepse me sa duket i konsiderojnë fëmijët si klientët kryesor.

Përveç kësaj edhe pse Ligji ndalon licencimin e dy kazinove apo bastoreve në një largësi më së paku se 300 metra me njëra-tjetrën, në qytetet e Kosovës, vargjet e ngjeshura të sallave të lojërave të fatit, përbëjnë tashmë fenomen.

Përkundër faktit se këto kompani operojnë në kundërshtim me ligjin, Qeveria e Kosovës i ka pajisur ato me licenca. Në këtë mënyrë pra nëpërmjet favorizimit të paligjshëm kjo Qeveri ka krijuar një kontekst ku bixhozi po përhapet si epidemi. E kjo epidemi më së shumti i prek nxënësit si dhe shtresat më të ndjeshme sociale që manipulohen nëpërmjet joshjes së fitimeve të lehta e të shpejta, e që në fakt rezultojnë kryesisht vetëm me humbje të sigurta.

Është i domosdoshëm respektimi i plotë i ligjit aktual, që duhet imponuar me rigorozitet në çdo pjesë të Kosovës. Ky ligj përmban masat e domosdoshme për t'i mbajtur fëmijët, por edhe shtresat e gjera popullore larg kazinove.

Në një ekonomi në krizë dhe një shoqëri e dobësuar sikur shoqëria jonë, nuk ka nevojë për të bartur plagë të tjera.

Për këtë arsye kërkojmë aplikimin e ligjit aktual, që nënkupton edhe spastrimin e shumicës së vendbanimeve nga ndërtimet e lojërave të fatit. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Aleancës, deputeti Xhevdet Neziraj e ka fjalën.

XHEVDET NEZIRAJ: Faleminderit, i nderuar zoti kryetar!

Ministër,

Kolegë deputetë,

Edhe Grupi i Aleancës i ka analizuar rekomandimet të cilat i ka dhënë Grupi punues dhe Komisioni për Buxhet dhe Financa, sepse gjatë monitorimit të ligjit, përveç që ka dhenë rekomandim që duhet të iniciohet për plotësim- ndryshim, është konstatuar që edhe Ligji që është nuk ka funksionuar ashtu qysh duhet dhe institucionet të cilat kanë dashur ta zbatojnë dhe duhet ta zbatojnë këtë ligj nuk e kanë zbatuar, sidomos Administrata Tatimore, Doganat dhe institucionet tjera.

Për Grupin e Aleancës është shqetësuese përhapja e shumë lojërave të fatit afër shkollave që është e ndaluar edhe me ligj dhe afër shumë institucioneve tjera që po ashtu është e ndaluar me ligj, do të thotë se Ligji mbi lojërat e fatit nuk është zbatuar nga asnjë institucion.

Prandaj, Grupi i Aleancës rekomandimet të cilat janë nxjerr nga Grupi punues dhe Komisioni i Buxhetit i përkrah dhe do t'i votojë për dhe do të kontribuojë që në plotësim-ndryshimin e ligjit që ai ligj të jetë më funksional se sa ky që është dhe të zbatohet në praktikë. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, deputetja Sevdije Lama e ka fjalën.

SEVDIJE LAMA: Faleminderit, i nderuar zoti kryetar,

Të nderuar deputetë,

Të gjeturat nga takimet që i kemi bërë si Grup punues në terren janë si në vijim:

Lotaria e Kosovës është ndërmarrje shoqërore, në vend që të jetë ndërmarrje publike, siç është paraparë me nenin 7, paragrafi 1 të Ligjit për lojërat e fatit.

Qeveria e Kosovës nuk po i zbaton detyrat e saj nga pika a) deri në pikën e), siç është marrja e përgjegjësi për të gjitha detyrimet e Lotarisë së Kosovës miratimin e statutit si dhe vlerësimin dhe përcaktimin e shkallës së kontributit që Lotaria e Kosovës do të derdhë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Pastaj, mungesa e kapaciteteve të ATK-së bën që konfiskimet t'i bëjnë Doganat e Republikës së Kosovës.

Tjetra, nga shifrat që i kemi pranuar nga informatat zyrtare, nga Doganat e Kosovës na bëjnë për të besuar se kjo veprimtari nuk po kontrollohet në mënyrë të duhur për faktin se 886 automatë janë duke funksionuar të pa lajmëruar që mund të nënkuptohet se ata janë në funksion dhe nga ata nuk mbledhet akciza.

Pastaj janë diku 387 punëtorë të padeklaruar në lokalet ku po ushtrohen të gjitha veprimtaritë e që numri i tyre arrin në 670.

Këto ishin disa nga të gjeturat në ligj gjatë monitorimit, mirëpo në anën tjetër shqetësimet për lojërat e fatit nuk përfundojnë vetëm me miratimin apo monitorimin e ligjit.

Shteti së bashku me institucionet e tij mbajnë përgjegjësinë kryesore në ndërtimin e familjes së shëndoshë, andaj është e nevojshme të krijojë edhe mekanizmat për mbrojtjen e saj.

Duke mbajtur familjen e shëndoshë e mbajnë shoqërinë të shëndoshë e me të mbrohet edhe shteti. Shqetësimet qëndrojnë në atë se frekuentimi nga mosha produktive e shoqërisë, përkatësisht nga mosha mesatare dhe ata të rinj në lojërat e fatit po sjell në vete probleme të shumta në familje.

Veprimtaria ndaj lojërave të fatit sa është brengosëse për dëmet e mëdha që i sjell personit dhe familjes, është po aq brengosëse për faktin se merr përmasa patologjike, e cila mund të rregullohet vetëm me anë të trajtimit.

Dhuna emocionale që shkakton në familje duke injoruar të tjerët përreth, neglizhimi i fëmijëve, përfshirë dhunën fizike, bëjnë që raportet ndërmjet familjarëve të përkeqësohen dhe të ftohen në tërësi.

Personi në vazhdimësi ndien nevojën të rrisë shpenzimet në lojë për të arritur kënaqësinë e dëshiruar. Fillimisht mundohet që parat t'i sigurojë nëpërmes rrugëve ligjore, si borxhet, marrja e kredive, kredi me interes të vonuar e deri te shitja e pasurisë dhe ngelja pa strehë dhe falimentimi. Pastaj përfshirja në akte kriminale, vjedhja, plaçkitja, manipulime, falsifikime me pronat, marrja e borxheve me fajde, paraqitja në gjykatë, në burg apo përfshirja në vrasje e bixhozxhinjve bën shkelje të ligjeve të njëpasnjëshme.

Duke mos lënë anash këto shthurjen e vlerave shoqërore, humbja e kapitalit njerëzor duke emigruar jashtë vendit, shtimi i papunësisë, përdorimi i substancave narkotike dhe alkoolit, me këtë bëhet edhe shtimi i barrës së taksapaguesve që të rrisë fondin shtetëror për arsye se shtohet nevoja ligjore policore, shërbimi gjyqësor i qendrave të rehabilitimit.

Ne si Grup Parlamentar e kemi shqyrtuar raportin me rekomandime të dala nga monitorimi i zbatimit të Ligjit për lojëra të fatit dhe të njëjtin e përkrahim, gjithnjë duke shpresuar që Qeveria t'i marrë parasysh këto rekomandime. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka në emër të “6+”, deputeti Fikrim Damka.

FIKRIM DAMKA: Faleminderit i nderuar kryetar!

Şans oyunlari yasa taslaginin ugulanmasina yonelik hazirlanan raporu, 6+ Grubu olarak sunulan onerileri ilk once destekledigimizi ifade etmek istiyorum. Tabi bir buçuk yıldır bu Yasa uygulanmakta, fakat görüyoruz ki bir sürü boşuklarla, bir sürü yanlışlarla bu Yasa Taslağı veya pratikte uygulanmadığını görüyoruz.

Tabi ki şahsen komple bu şans oyunların Kosoav'da olmasına karşı olduğumu da ilk önce ifade etmek istiyorum. Çünkü gelecek nesillerimizi, aileleri, gençlerimizi yıkan bir olay. Ve bunun karşılığında devletin elde etmiş olduğu çok fazla mebla olduğunu da göremiyoruz. Sunulan Rapora baktığımızda yaklaşık olarak 740 makinenin illegal olarak Kosova'da faal gösterdiğini. Yaklaşık olarak 384 kişinin yine kayıt dışı çalıştığını, yine bakmış olduğumuz rapora göre okullar, camiler ve diğer dini yerlerimizin etrafında bu tür kasinolara, bu tür şans oyunlarına rastlıyoruz.

Yani her geçen gün bu şans oyunları nerdeyse her sokakta, her mahalede bir değil hatta birkaç tane açıldığını gözümüze çarpmaktadır. Ümit ediyoruz ki bu Yasa Taslağı incelendikten sonra, uygulanmasında ve önerilerin fiiliyata geçmesinde hükümet, gerekli önlemleri alacaktır, belki de Yasa Taslağı değişikliğinde bütünüyle vazgeçip bu şans oyunlarının artık Kosoav'da olmamasına karar verebilir, inşallah bunu bu Meclis'te arkasında duracağız, biz de bunun peşinde olacağız.

Bu Yasa önerisini, daha doğrusu bu Raporu hazırlayan komisyon üyelerine teşekkür ediyorum, ümit ediyorum ki bunun uygulanması ve hükümete düşen görev yerine gelecektir. Sağolun.

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Burim Ramadani.

BURIM RAMADANI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuara deputete, të nderuar deputetë,

Unë besoj se fakti i këtyre përfundimeve që kanë ardhur prej këtij raporti që e ka bërë Grupi punues i Komisionit Parlamentar për Buxhet e Financa, besoj që këto përfundime janë vërtet shqetësuese dhe realisht nuk do të duhej të kalonin kështu sikur janë vetëm disa përfundime, sepse diçka s'është në rregull.

E vërteta është se këtë temë, sidomos për lojërat e fatit ka qenë një prej temave ma të përhapura politikisht nëpër Kosovë, edhe gjatë javëve dhe muajve të fundit, një prej temave më shumë të theksuara ka qenë kjo, ndërkaq kur e shohim tash se realisht kush janë përgjegjësit për moszbatimin e ligjit sikur i mbyllim nga pak sytë.

Kjo është shqetësuese për mua dhe besoj se përgjegjësia e qartë për zbatimin e Ligjit për lojërat e fatit, që nënkupton përgjegjësi të qartë se kush janë ata ose ato institucione dhe ata njerëz, ata zyrtarë që paguhen prej Buxhetit të Kosovës për t'i kontrolluar dhe për t'i mbikëqyrur aktivitetet e lojërave të fatit me këtë raport qartësohen. Edhe unë besoj se këtu duhet të ketë edhe përgjegjësi penale për ata që deri tash nuk e kanë zbatuar ligjin, por e kanë lejuar një situatë në Kosovë e cila është kthyer në një lloj përhapje hysterike e

shpifjeve dhe elementeve tjera që kanë të bëjnë pikërisht me këtë temë dhe tash kur e shohim se kush janë përgjegjës sikurse hajt të themi se të kalojë kjo punë.

Të dhënat vërtet janë shqetësuese. Vërtet shihet që nuk ka zbatim të ligjit dhe ideja e ekzistimit të një ligji për këtë temë është fakti se kjo temë ose kjo fushë nuk është ilegale, por është legale e përcaktuar dhe e rregulluar me ligj. Prandaj, ligji duhet të respektohet në mënyrë që të kalohet në tema tjera se si duhet të shkojë.

Sidomos të Administratës Tatimore, por edhe të Doganave, çështjet për numrin e veprimtarive që ndodhin në lojërat e fatit nuk duhet të kalohen sikurse po kalohet një temë krejt e thjeshtë.

Ligji i tillë i lojërave të fatit, që pajtohem se duhet të ketë plotësim- ndryshim, sikurse është një prej rekomandimeve të Grupit punues që ka ardhur, nuk zbatohet dhe për këtë edhe në raport e shohim se edhe zyrtarët e institucioneve përgjegjëse e thonë se nuk po e zbatohet në mënyrë efikase.

Kjo është tema dhe kjo është logjika, e cila vërtet e ka dëmtuar, jo vetëm një fushë ose vetëm një aspekt, por dëmtimet që vijnë prej kësaj dukurie negative, se dukuri negative është shkelja e ligjit dhe moszbatimi i ligjit, njëjtë sikur dukuritë tjera negative që janë në Kosovë, të pranishme.

Prandaj duhet të qartësohet mirë dhe qartë, nuk ka komunë në Kosovë që nuk ka veprimtari të tilla, nuk ka vend në Kosovë që nuk ka veprimtari të tilla, por lidhur me zbatimin e ligjit për mbikëqyrjen e këtyre aktiviteteve po shihet kush është përgjegjës dhe ku janë problemet.

Definitivisht kjo çështje duhet të jetë shqetësuese, është shqetësuese. Ne nuk duhet vetëm ta selektojmë as krejt veprimtarinë, as krejt temën dhe as vetëm të selektojmë një pjesë të dëmeve që i vjen. Edhe çështja të afërsia të shkollat në Kosovë është temë jashtëzakonisht ose aspekt jashtëzakonisht dëmtues, por edhe temat tjera sikur është numri i këtyre veprimtarive, numri i aparateve që po del që më shumë janë të palicencuar ose jashtë ligjit se sa brenda ligjit.

Dhe, kush e ka përgjegjësinë? E kanë përgjegjësinë ata që i përcakton ligji, edhe me nenin 4, paragrafi 2 të Ligjit për lojërat e fatit, edhe ligjet tjera që janë.

Vërtet kjo është temë shqetësuese e cila e ka dëmtuar edhe demokratizimin e kësaj shoqërie, sepse një temë e cila kthehet në një histori totale prej shumëkujt, po qartësohet se kush është përgjegjës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Po konsideroj që nuk është dukuri negative moszbatimi i ligjit, është vepër penale. Fjalën e ka Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

E para, duhet përshëndetur punën e këtij grupi punues që ka të bëjë me një temë që me të vërtetë është bërë gangrenë në shoqërinë tonë kosovare, jo vetëm për nga ajo që kemi shkelje të ligjit dhe kemi në aspektin të quaj më shumë që është korruptiv dhe kriminal, por kjo tregon qartë edhe nga raporti edhe pse nuk shprehet detalisht, por dikush qëndron shumë i fuqishëm prapa lojërave të fatit në Republikën e Kosovës.

Dhe, unë mendoj se ata që qëndrojnë mbrapa dihen publikisht, kanë emra dhe mbiemra dhe sigurisht që janë mbështetur më së shumti në politikë dhe kjo nuk ka nevojë të verifikohet as në terren dhe nuk ka nevojë të thuhet a të deklarohet as në Parlament, por duhet të luftohet dhe të kërkohet nga organet e rendit që ta kryejnë punën, sepse po shihet qartë se këtu Ministria përkatëse dhe Doganat nuk kanë mund ta bëjnë punën sipas këtij raporti dhe sipas këtyre të gjeturave.

Andaj, Kosova është duke vuajtur nga ky fenomen. Shumë familje në Kosovë e kanë pasur fatin e keq, pikërisht duke mos pasur zbatim të ligjit dhe duke mos pasur kush t'i luftojë këto dukuri në të dy aspektet, edhe atë legjislativ, edhe në aspektin e informalitetit, dhe që ne më së shumti e quajmë edhe këtu që i bën dëm në fund të fundit edhe Buxhetit të Republikës së Kosovës.

Andaj, këto rekomandime duhet t'u shtohen, ndoshta është dashur që të jetë mendimi edhe i Ministrisë përkatëse se cila është kostoja e këtyre, e para. Dhe, pse operojnë kaq shumë ilegalisht dhe kush i mbështetë, sepse tash është më se e qartë dhe po shihet nga vetë raporti, edhe pse këta nuk e kanë shkruar këtu dhe nuk e kanë deklaruar, po të jenë mbi 1 000 operatorë ilegalë në këtë Kosovën tonë të vogël, kjo domethënë shumë. Domethënë shumë më shumë se sa një ligj, ose se sa atë që duhet ta bëjë Dogana dhe Administrata Tatimore e Kosovës.

Nga raporti shihet se Administrata Tatimore dhe Doganat janë munduar ta bëjnë punën e vetë ashtu siç e parasheh ligji, por ka edhe disa aktorë tjerë që është dashur të jenë të përfshirë, duke filluar nga komunat përkatëse, por edhe nga vetë organet e rendit, të cilat duhet ta luftojnë informalitetin, por edhe krimin dhe korrupsionin.

Prandaj, unë nuk mendoj që kjo çështje duhet të kalojë kështu në këtë formë. Rekomandimet duhet të jenë shumë më të ashpra se sa kështu dhe çka duhet të nxjerrë Kuvendi?

Nëse me të vërtetë e kemi seriozisht që duhet ta parandalojmë këtë të keqe, apo ta ndalojmë në tërësi këtë aktivitet, derisa t'i nënshtrohet ligjit dhe derisa t'i nënshtrohet ashtu siç e kanë të gjitha vendet demokratike.

Përndryshe, çdo ditë e më shumë është duke u thelluar varfëria, është duke u thelluar krimi nga kjo veprimtari. Ata që janë duke u pasuruar janë ata që kanë emra e mbiemra, janë aktorë politikë dhe që qëndrojnë prapa lojërave të fatit në Republikën e Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Alma Lama.

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryetar!

Ajo që desha t'i shtoj këtij diskutimi në lidhje me lojërat e fatit është një letër, e cila i ka ardhur sot secilit deputet besoj në kutitë e tyre, kur qytetarët, duke qenë të informuar se sot do të diskutohet për këtë ligj, na kanë informuar se si në qendër të Prishtinës, në vendbanimet të cilat frekuentohen nga njerëz, afër shkollave, afër çerdheve e tjera, ka lojëra fati, dhe kjo pa diskutim që është kthyer në shqetësim për shkak se lojërat e fatit frekuentohen nga njerëz, të cilët kanë probleme, ose gjenerojnë probleme.

Në fakt, këto vende ku luhen këto lojëra shërbejnë si krijuese të problemeve. Kam pasur rastin t'i bëj disa investigime dhe e di që shumë njerëz futen rrugës së basteve dhe të fatit dhe humbin deri edhe shtëpitë e tyre.

Për mendimin tim, këto qendra, jo vetëm që duhet të eliminohen nga vendbanimet, pra nga zonat që frekuentohen nga shumë njerëz, e sidomos aty ku ka fëmijë për shkak të rrezikut potencial të krimit, por do të isha e mendimit që të mos lejoheshin fare në Republikën e Kosovës, sepse një shtet i cili ende ka shumë probleme me respektimin e ligjit, natyrisht që nuk mund t'u vë fre këtyre lojërave që shërbejnë si prodhuese të krimit.

Vetëm vendet të cilat e kanë shumë të fuqishëm respektimin e ligjit mund t'i kontrollojnë, por edhe ato vende madje kanë shumë probleme.

Kështu që projektligji, i cili është sjellë për ndryshim mendoj që është dashur t'i eliminojë plotësisht këto. Vetëm ato që licencohen dhe nuk prodhojnë krim mund të lejohen. Të tjerat do të duhej që të mbylleshin fare.

Dikush po përfiton, natyrisht në mënyrë krejtësisht të paligjshme. Viktimat kryesore janë të rinj të papunë, të cilët i shohin lojërat e fatit si shpresë për të fituar ndonjë para, por në fakt Qeveria duhet të hapë vende pune, të hartojë politika të cilat krijojnë vende pune në Kosovë, e jo të licencojë dhe të hapë lojëra të fatit, sepse këto nuk janë vende pune, po janë vende - oaza të krimit potencial. Faleminderit!

KRYETARI: Nuk ka të tjerë të lajmëruar për diskutim. Unë i ftoj që të vijnë, por dua t'i them dy-tri çështje, pastaj ministri.

Unë i dëgjova me vëmendje, edhe pse këtu nuk pati vëmendje të shtuar për këtë çështje mjaft të ndjeshme.

Deputeti Xhevdet Neziraj tha se të gjitha institucionet në Kosovë nuk e kanë respektuar ligjin. Do të thotë, në të gjitha institucionet bëjnë pjesë edhe komunat që i japin lejet për legalizimin e këtyre farë lojërave ose të bastoreve.

Mandej ne i dëgjua edhe rekomandime, ka shumë. Po nëse kemi 100 ose 1 000, siç u tha, pa leje, që domethënë të gjitha institucionet e shtetit, edhe Parlamenti është pjesë e institucioneve të shtetit, nuk i kanë kryer detyrat e veta, atëherë pse nuk është kërkuar që të ndryshohet ligji dhe të ndalohen automatet dhe bastoret?

Mendoj që komisioni është dashur ta thotë si rekomandim që të ndalohen me ligj automatet dhe bastoret, se vërtet nëse janë 1 000 pa leje, kjo do të thotë se as administrata komunale, as administrata e shtetit nuk ka kapacitete për të mbikëqyrë dhe për të kontrolluar, nëse të gjitha institucionet nuk e kanë hisen e vet në gjithë këtë parregullsi.

Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI BESIM BEQAJ: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar deputetë,

Më lejoni edhe unë ta falënderoj komisionin për punën të cilin e ka bërë. Sigurisht që në përgjigjet që janë marrë edhe nga Administrata Tatimore është vënë në pah që çështja e licencimit të mbikëqyrjes dhe kontrollit të këtyre subjekteve duhet të ndahet nëpër institucione. Ligji e ka përcaktuar si të tillë.

Njëkohësisht është trashëguar një situatë kur shumica e lejeve të punës janë dhënë nga organet komunale. Realisht, Administrata Tatimore e ka bërë një punë, në të cilën shumë prej tyre u është shqiptuar edhe masa e ndalimit të ofrimit të këtyre aktiviteteve, por Administrata Tatimore nuk ka mundësi më shumë, sepse duhen organet e rendit dhe ato të cilat duhet t'i largojnë.

Unë dua të ju them që Ministria e Financave, së bashku me Administratën Tatimore dhe Doganën jemi të gatshëm të bashkëpunojmë me gjithë ju për një amendamentim të ligjit, për ndarjen e përgjegjësisë, funksionimin e plotë të rendit dhe të ligjit, sepse pa funksionuar rendi dhe ligji, pa qenë të gjithë aktorët, pa qenë komunat, pa qenë institucionet shkollore, të gjithë ata të cilët janë të thirrur për të vepruar në këtë drejtim, do të jetë çështje me problematikë për t'u implementuar.

Si do që të jetë, po e them edhe njëherë gatishmërinë e Ministrisë së Financave, të Administratës Tatimore dhe të Doganës, që të merremi me çdo detaj të saj. Procedurat shumë prej tyre kanë filluar. Nga korriku ne i kemi të paguar të gjitha taksat, akcizën nga të gjitha lojërat të fatit në nivel 100%, por kemi edhe më tutje borxhe të vjetra, të cilat duhet t'i mbledhim. Por, kjo duhet të harmonizohet me zbatimin e ligjit.

Prandaj, në këtë drejtim, ju ftoj që së bashku të bashkëpunojmë, por njëkohësisht edhe rekomandimet, të cilat do të dalin, ne do t'i implementojmë në tërësi. Faleminderit!

KRYETARI: A jeni dakord që në emër të rekomandimeve të shkojë edhe ndryshimi i ligjit për ndalimin e automateve dhe të bastoreve?

Atëherë, le të futet pra edhe një rekomandim që del nga seanca e sotme.

Të pranishëm i kemi 62 deputetë. Tani e votojmë raportin me rekomandimet e komisionit.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Edhe dy deputetë duhet të votojnë. Ju lutem, edhe një herë e përsërisim votimin, me votim elektronik.

Kush është pa kartelë? Vetëm një është i lajmëruar pa kartelë. Edhe një herë! Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. E votojmë tash raportin me rekomandime të komisionit dhe me rekomandimin e seancës.

Konstatoj se me 60 vota dhe Idriz Vehapi pa kartelë, me 61 vota për, Kuvendi e miratoi raportin me rekomandime dhe rekomandimin e seancës.

Vazhdojmë me pikën e tetë të rendit të ditës:

8. Shqyrtimi i raportit të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2012

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore e Persona të Pagjetur dhe Peticione e ka shqyrtuar raportin vjetor të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2012 dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

Gjithashtu, edhe Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar raportin vjetor financiar të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2012 dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

E ftoj kryetaren e Komisioni FunkSIONAL, deputeten Suzan Novobërdaliu, për arsyetimin e raportit me rekomandime. Deputete, e ke fjalën. Kërkoj falje, se nuk e pashë që avokati është këtu. Fjalën e ka Avokati i Popullit, zoti Sami Kurteshi, që ta paraqesë raportin para deputetëve.

AVOKATI I POPULLIT SAMI KURTESHI: I nderuar kryetar i Kuvendit! Të nderuara zonja dhe zotërinj deputetë,

Bazuar në nenin 135, paragrafi 1 dhe 2, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe në nenin 27, paragrafi 1 dhe 2, të Ligjit për Avokatin e Popullit, ju paraqes raportin vjetor, të dymbëdhjetin me radhë të Institucionit të Avokatit të Popullit të Republikës së Kosovës, që përfshin periudhën 1 janar - 31 dhjetor 2012.

Shpërfaqja e punës njëvjeçare të Institucionit të Avokatit të Popullit përfshin të gjitha hallkat vepruese të tij, të paraqitura sipas një renditjeje logjike të bazuar në misionin kushtetues të Avokatit të Popullit, mbrojtja, mbikëqyrja dhe promovimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Paraqitja e gjendjes së të drejtave dhe lirive të njeriut në Kosovë dhe kahet e zhvillimeve të kësaj gjendjeje, bazuar në të dhënat e mbledhura dhe të arkivuara në Institucionin e Avokatit të Popullit, por edhe në informatat dhe dështimet e mbledhura nga burime të tjera pa primare dhe sekondare, është postulati kryesor që shpërfaq ky raport.

Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut e përbëjnë bazën e rendit juridik të Republikës së Kosovës. Drejtësia ligjore, e pranueshme dhe e zbatueshme në jetën praktike, për të gjithë

individët pa asnjë dallim, në gjithë territorin e shtetit, përbën bazën e shtetit ligjor. Fatkeqësisht, në Kosovë, këto shtylla qenësore të shtetit ligjor cenohen në vazhdimësi dhe vazhdojnë të jenë të brishta në secilën fushë të jetës.

Pasojë e drejtpërdrejtë e mosangazhimit të mekanizmave shtetërorë në fushën e zbatimit të drejtësisë është besimi i humbur në shtetin ligjor. Ky mosbesim shtrihet që nga shtresat më të varfra dhe më të pafuqishme të shoqërisë, deri te zyrtarët më të lartë të shtetit. Edhe më tutje, në Republikën e Kosovës, drejtësia e shtetit është përzgjedhëse. Në vend se ta sheshojë, ajo gjithnjë e më tepër po e thellon hendekun ndërmjet qytetarit të pambrojtur dhe shtetit, që për detyrë themelore dhe të vetme e ka ta mbrojë qytetarin.

Humbja e besimit në shtetin ligjor dhe mungesa e angazhimit të mekanizmave shtetërorë për përmirësimin e kësaj gjendjeje dëshmon mungesën e përpjekjeve për përmirësimin e kësaj gjendjeje.

Mungesa e ndërgjegjësimin institucional për zbatimin e ligjit po shoqërohet me një tronditje që po prek të gjitha porët e sistemit ligjor në Republikën e Kosovës.

Humbja gjithnjë e më e madhe e besimit të qytetarëve në mekanizmat e drejtësisë në Kosovë po shkakton pasojat e tjera shumëfish më të mëdha dhe më të rrezikshme, tentimet gjithnjë e më të shumta të marrjes së ligjit në duar të veta nga qytetarët. Fatkeqësisht, kjo gjendje po shpie në anarki ligjore, e cila po i kaplon të gjitha fushat e shoqërisë sonë. Si pasojë vërehet edhe një përkeqësim në rritje i raporteve ndërsqetërore dhe ndërnjerëzore.

Avokati i Popullit vazhdimisht ka dhënë dhe jep rekomandime për përmirësimin e lëshimeve dhe mangësive të vërejtura.

Moszbatimi dhe injorimi i rekomandimeve pikërisht nga institucionet të cilat janë të thirrura t'i zbatojnë ligjet dhe t'u krijojnë mundësi qytetarëve për të zgjidhur problemet e tyre, është tejet shqetësues.

Avokati i Popullit, me të gjeturat e shkeljeve të ndryshme dhe rekomandimet për mënjanimin e tyre, me përpjekjet për komunikimin e pandërprerë me institucionet përkatëse dhe ndërmjetësimet ndërmjet tyre dhe qytetarëve në vazhdimësi është angazhuar dhe angazhohet në përmirësimin e kësaj gjendjeje.

Ai do të vazhdojë ta bëjë këtë me gjithë neglizhencën e disa institucioneve për ta krijuar një klimë më të mirë për drejtat dhe liritë e njeriut.

Jashtëzakonisht shqetësuese për Avokatin e Popullit është tendenca e institucioneve të ndryshme shtetërore për minimin dhe minimizimin e rolit të institucioneve të pavarura kombëtare përgjithësisht: qoftë duke shpërfillur të gjeturat e tyre, qoftë duke mos i zbatuar rekomandimet e tyre, apo qoftë edhe duke bërë përpjekje kundërligjore për cenimin e pavarësisë së tyre kushtetuese.

Institucioni i Avokatit të Popullit ka bërë hapa të rëndësishëm në drejtim të ofrimit të shërbimit të qytetarëve dhe personave të tjerë në nevojë.

Përveç mundësisë për paraqitjen e ankesave me të gjitha format e komunikimit, drejtpërdrejt në zyrat e Avokatit të Popullit, çdo ditë pune, me postë, me postë elektronike, nëpërmjet familjarëve apo avokatit dhe me telefon, Institucioni i Avokatit të Popullit organizon edhe Ditët e Hapura, duke ofruar takime të drejtpërdrejta një herë në muaj, jashtë zyrave regjionale të Institucionit të Avokatit të Popullit për të gjithë personat në nevojë në të gjitha komunat e Republikës së Kosovës, kryesisht në ndërtesat e kuvendeve komunale.

Po ashtu, me qëllim të rritjes së transparencës ndaj qytetarëve dhe të gjithë ankuesve, Avokati i Popullit çdo kërkesë të drejtuar atij i përgjigjet me shkrim.

Megjithëse të gjitha këto veprime përcillen me një ngarkesë dukshëm më të madhe për bashkëpunëtorët e Institucionit të Avokatit të Popullit, satisfaksion për të vazhdon të mbetet rritja e besimit të qytetarëve dhe e disa institucioneve shtetërore në punën e institucionit.

Nga 1 janari deri më 31 dhjetor 2012, në Institucionin e Avokati të Popullit janë paraqitur 1 670 raste ankesa, në selinë e tij në Prishtinë dhe në zyrat rajonale për të parashtruar ankesa, ose për të kërkuar këshilla dhe ndihmë juridike. Prej tyre, në 377 raste këta persona janë takuar personalisht me Avokatin e Popullit apo zëvendësit e tij gjatë Ditëve të Hapura, të ashtuquajtura, të mbajtura në periudhën raportuese.

Numri më i madh i rasteve që janë hetuar nga Institucioni i Avokatit të Popullit gjatë periudhës raportuese kanë qenë kryesisht lidhur me të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, mbrojtjen shëndetësore dhe sociale, të drejtën për mjete juridike, mbrojtjen e pronës, të drejtën e punës dhe ushtrimit të profesionit dhe barazinë para ligjit.

Fatkeqësisht, një numër i ankesave ka të bëjë edhe me vendimet e padrejta, me elemente të korrupsionit dhe falsifikimeve, që nënkupton padrejtësi nga ata që pritet ta vënë drejtësinë në vend, qoftë nga administrata shtetërore, apo ajo gjyqësore.

Me gjithë ndërmarrjen e veprimeve të pakta për luftimin e kësaj dukurie nga vetë Gjyqësori, bazuar në të dhënat e Institucionit të Avokatit të Popullit, në përgjithësi, në këtë drejtim nuk vërehet ndonjë përmirësim i dukshëm në krahasim me periudhën e mëparshme raportuese.

Një numër i konsiderueshëm i ankesave, gjithnjë në rritje, kanë të bëjnë me mosrregullimin ligjor të pensioneve, të sigurimit shëndetësor, mbrojtjen jo të duhur shëndetësore, mungesën e barnave nga e ashtuquajtura listë esenciale në institucionet publike shëndetësore.

Një fushë e ankesave që përcillet me pasoja serioze për marrëdhëniet ndërnjerëzore, ku vërehet edhe dështimi më serioz i sistemit të drejtësisë, qoftë për shkak të zvarritjeve të

mëdha, qoftë për shkak të moszbatimit të vendimeve të plotfuqishme gjyqësore, apo qoftë edhe të falsifikimeve të dëshmuara, është cenimi i të drejtës së pronës. Në këto raste, kur drejtësia shtetërore i mbështet njerëzit për murin e padrejtësisë, ata e marrin drejtësinë në duart e tyre.

Fatkeqësisht, rastet e izoluara të marrjes së drejtësisë në duart e tyre nga vetë qytetarët, të cilat po shpeshtohen pikërisht për shkak të mungesës së veprimit ligjor të shtetit, po përcillet edhe me pasoja të rënda tragjike.

Një shqetësim për Avokatin e Popullit mbetet gjendja e sigurisë në Republikën e Kosovës. Një rritje e numrit të rasteve të vrasjeve me armë është evidente.

Një tendencë rritjeje e numrit të ankesave vërehet për shkak të dështimit të mbrojtjes së mjedisit jetësor, qoftë për shkak të përkeqësimit të vazhdueshëm të gjendjes në këtë fushë, qoftë ...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: I vazhdohet fjala, regjia!

AVOKATI I POPULLIT SAMI KURTESHI: ...për shkak të vetëdijesimit të një numri të madh të qytetarëve për gjendjen e patolerueshme e kemi një reagim gjithnjë e më të shpeshtë të qytetarëve të ndërgjegjësuar dhe kurajoz.

Liria e lëvizjes në pjesën veriore të qytetit të Mitrovicës, si dhe në komunat Leposaviq, Zubin-Potok dhe Zvečan vazhdon të mbetet gati tërësisht e kufizuar për qytetarët, sidomos për personat e përkatësisë etnike joserbe, por dhe për autoritetet publike të Republikës së Kosovës, si dhe për institucionet ndërkombëtare. E njëjta gjë vlen edhe për sigurinë fizike.

Një gjendje shumë e rëndë sa i përket lirisë së lëvizjes vërehet edhe në trafikun rrugor. Në qendrat urbane, përveç zënies së trotuareve nga parkimi i pandërgjegjshëm i automjeteve, vërehet edhe një papërgjegjësi dhe kaos i patolerueshëm në ngasjen e automjeteve, si në qendrat urbane, ashtu edhe në rrugët e hapura. Përveç rrezikimit të drejtpërdrejtë të jetës së njerëzve nga aksidentet fatale, shpeshherë kufizohet liria e lëvizjes së këmbësorëve, sidomos e fëmijëve, e të moshuarve dhe e personave me aftësi të kufizuara.

Gjendja e rëndë ekonomike në vend prek shumicën e qytetarëve të Republikës së Kosovës, duke ndikuar drejtpërdrejt në kualitetin e tyre jetësor. Shqetësuese në këtë drejtim është mungesa e perspektivës për të rinjtë, si dhe gjendja e pensionistëve.

Në këtë drejtim, Avokati i Popullit sërish kërkon nga Kuvendi i Republikës së Kosovës miratimin e Ligjit për sigurimin shëndetësor, si dhe të Ligjit për sigurimin invalidor e pensional. Po ashtu, ripërsërit kërkesën për përfshirjen e Konventës për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore në kuadër të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si

një ndër instrumentet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut të zbatueshme drejtpërdrejt në Republikën e Kosovës.

Shqetësim të veçantë për Avokatin e Popullit paraqet edhe izolimi strukturor nga jeta publike dhe si pasojë vetizolimi shoqëror i komuniteteve ashkali, egjiptian dhe rom.

Përpyekjet e deritanishme të autoriteteve publike në Republikën e Kosovës, përfshirë këtu edhe vetë Institucionin e Avokatit të Popullit, për integrimin e mirëfilltë të këtyre komuniteteve në jetën publike dhe shoqërore, përveç disa përmirësimeve modeste në fushën e banimit dhe të arsimit, nuk kanë dhënë rezultate të lakmueshme.

Avokati i Popullit, me qëllim të përmirësimit të gjendjes së të drejtave dhe lirive të njeriut, për të gjitha rastet e veçanta kur ka konstatuar shkelje të të drejtave, në raportet e tij vjetore dhe të veçanta ka bërë rekomandimet për të gjitha autoritet publike, ministritë, komunat, si dhe agjencitë tjera publike përgjegjëse.

Por, fatkeqësisht, në këtë drejtim kemi të bëjmë me një dështim të institucioneve publike.

Gjatë periudhës raportuese, Avokati i Popullit nuk ka marrë asnjë informatë apo njoftim nga ndonjë institucion nëse janë zbatuar rekomandimet e tij sistemore. Edhe pse në praktikë një praktikë e tillë vazhdon të përcillet nga viti në vit dhe si e tillë është mjaft shqetësuese, me kënaqësi të kujdesshme dëshiroj ta theksoj faktin se në këtë drejtim vërehet një lëvizje pozitive, sidomos në vitin e fundit.

Meqenëse zbatimi i ligjit është premisa kryesore për funksionim e shtetit ligjor, në Republikën e Kosovës, përveç disa përpjekjeve modeste, moszbatimi i ligjit është plaga më e rëndë institucionale. Ky është indikator kryesor për humbjen e besimit të qytetarit në institucionet shtetërore, të cilat zbatimin e ligjit e kanë detyrim ligjor dhe kushtetues. Kjo humbje e besimit Avokatin e Popullit e vë në pozicion të palakueshëm, drejt të cilit shtrihen kërkesa për ta vënë drejtësinë në vend. Kjo ndodh pikërisht për shkak të moszbatimit të ligjit në të shumtën e rasteve, e edhe të shkeljes së ligjit në raste të veçanta nga institucioneve shtetërore.

Avokati i Popullit do të vazhdojë t'i evidentojë dhe t'i nxjerrë në pah veprimet apo mosveprimet e parregullta e të paligjshme të autoriteteve publike, pikërisht për ta forcuar rolin që e ka në ndërtimin e një shoqërie të bazuar në parimin se të gjithë janë të barabartë para ligjit.

Por, me gjithë këto veprime dhe përpjekje për përmirësimin e gjendjes së të drejtave dhe të lirive të njeriut, dua të theksoj qartë se Avokati i Popullit nuk ndan drejtësi. Janë gjykatat që e ndajnë dhe e zbatojnë drejtësinë. Janë pikërisht institucionet shtetërore ato të cilat nuk do të duhej ta shkelnin ligjin, sepse po që se shkelin mbi të, atëherë e kanë dëmtuar thelbin e domosdoshëm për funksionimin e një shoqërie të lirë dhe demokratike. Kjo nuk duhet lejuar.

Avokati i Popullit, përveç përkushtimit dhe përgjegjësisë individuale e shoqërore, kërkon sidomos përkushtim dhe përgjegjësi institucionale dhe ligjore të autoriteteve publike për veprimet apo për mosveprimet e tyre.

Duke qenë mbikëqyrës i zbatimit kushtetues dhe ligjor i të drejtave dhe lirive të qytetarëve të Republikës së Kosovës, Avokati i Popullit njëkohësisht është edhe ndriçues i rasteve kur qytetarët privohen nga ndonjë e drejtë e tyre, si dhe këshilltar qëllimshëm i institucioneve publike, kur ato shprehen mospërfillëse në zbatimin kushtetues dhe ligjor të të drejtave dhe lirive të tyre.

Avokati i Popullit shpreson, por edhe kërkon me ngulm që të gjitha autoritetet publike dhe organizatat që ushtrojnë autorizime publike në Republikën e Kosovës t'i marrin në konsideratë të gjeturat e Avokatit të Popullit dhe zbatimin e rekomandimeve, të bëra qoftë në raportin vjetor, apo edhe në raportet e veçanta.

Për fund, Avokati i Popullit vazhdon t'i mbetet besnik parimit se qeverisja e mirë është e drejtë e qytetarëve dhe obligim i autoriteteve të zgjedhura publike.

Prandaj, vazhdon të mbetet i përkushtuar për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe për një qeverisje të mirë.

Zoti kryetar,

Zonja dhe zotërinj deputetë,

Duke mbetur në dispozicionin tuaj për sqarime të domosdoshme, ju falënderoj për vëmendjen e treguar. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka kryetarja e Komisionit FunkSIONAL, deputetja Suzan Novobërdaliu, për arsyetimin e raportit me rekomandime.

SUZAN NOVOBËRDALIU: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Nga Kabineti qeveritar qenka vetëm një person, përshëndetje!

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, duke u bazuar në nenin 72 të Rregullores së Kuvendit, e ka shqyrtuar raportin e Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2012.

Në takimet e mbajtura më 22 tetor, më 12 dhe më 19 nëntor dhe ka miratuar përfundimin për t'ia paraqitur Kuvendin këtë raport me rekomandime.

Institucioni i Avokatit të Popullit, duke u bazuar në nenin 27.1 të Ligjit për Avokatin e Popullit e ka parashtruar në Kuvendin e Republikës së Kosovës raportin për vitin 2012 me numër të protokollit 04/46-84/a35 më 7 tetor të vitit 2013. Gjatë shqyrtimit të raportit, komisioni ka vërejtur se raporti i institucionit të Avokatit të Popullit nuk është parashtruar konform nenit 27, paragrafi 2 të Ligjit për Avokatin e Popullit, i cili e përcakton afatin për paraqitjen e raportit për vitin paraprak deri më 31 mars të vitit vijues, andaj raporti është parashtruar me 6 muaj vonesë.

Në përmbajtje, raporti nuk përfshin diskriminimin si kategori e veçantë raportuese. Rastet e dhunës në familje janë të përfshira vetëm në tri komuna. Për gratë dhe vajzat e dhunuara gjatë luftës, është dhënë një shifër prej 20 000 grave dhe vajzave të dhunuara, ndërsa nuk ka një statistikë të saktë për këtë çështje.

Në fusnotën 26 është shkruar Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës, zvarritja e procedurave gjyqësore dhe shqiptimi i dënimeve të ulëta janë raportuar sipas gazetave ditore, do të thotë si burim merren gazetat ditore.

Sa i përket lirisë së lëvizjes, u është kushtuar shumë rëndësi disa vendeve, ndërsa lirisë së lëvizjes në veri të Mitrovicës i është kushtuar shumë më pak rëndësi.

Në sistemin arsimor është konstatuar se komuniteti serb në Kosovë punon në bazë të planprogrameve të Serbisë dhe të punësuarit marrin paga të dyfishta, por mungon rekomandimi i institucionit lidhur me këto çështje.

Në raport kemi gjithashtu mungesë, sepse nga faqja 96 deri në faqen 105, ku kemi të bëjmë me 7 pika për të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian, kthimi i të zhvendosurve dhe refugjatëve në Kosovë, ripranimi dhe riatdhesimi nga Evropa Perëndimore, gjendja e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian, arsimimi i pjesëtarëve të komuniteteve pakicë, pastaj mediet e kultura, këtu paraqiten probleme të cilat i ka komuniteti joshumicë në Kosovë, mirëpo nuk kemi rekomandime, do të thotë ato mungojnë.

Nga anëtarët e komisionit gjithashtu kemi pasur edhe vërejtje të tjera. Ne i kemi lënë një javë ditë Institucionit të Avokatit të Popullit që t'i bëjë këto përmirësime, por i njëjti disa rekomandime i ka marrë parasysh dhe tani në këtë raport, të cilin ju duhet ta votoni, nuk i keni ato përmirësime, mirëpo në raportin të ciline ka publikuar Avokati i Popullit ekzistojnë ato përmirësime.

Por, sidoqoftë tani ne do ta votojmë këtë raport, i cili u ka ardhur deputetëve të Kuvendit.

Kryetar

Unë do të flas edhe në emër të Grupit Parlamentar, nëse më lejohet, meqë e kam marrë fjalën. Faleminderit!

Atëherë, do të them se edhe Grupi Parlamentar Koalicioni për Kosovë të Re e ka shqyrtuar dhe do ta përkrahë këtë raport. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Qeveri nuk kemi! Jo, këtu nuk e kemi të pranishme! Desha t'i tregoj Suzanit që tha një nga Qeveria, por jo - Avokati i Popullit nuk është pjesë e Qeverisë.

Sefete, e dëshiron në emrin tënd, të Komisionit, apo të Grupit? Fjalën e ka deputetja Safete Hadërgjonaj.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Në bazë të nenit 135, paragrafi 1 të Kushtetutës të Republikës së Kosovës dhe nenit 27, paragrafi 1 dhe 2 i Ligjit për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit i paraqet raport vjetor Kuvendit të Republikës së Kosovës jo më vonë se 31 mars për çdo vit kalendarik, kur këtij raporti të punës ai është i obliguara t'ia bashkëngjisë edhe raportin financiar, të cilin e shqyrton Komisioni për Buxhet dhe Financa.

Komisioni për Buxhet dhe Financa, në mbledhjen e mbajtur më 20.11.2013, e ka shqyrtuar raportin vjetor financiar të Institucionit të Avokatit të Popullit dhe vlerësoi se raporti ofron një pasqyrë të përgjithshme për nivelin e shpenzimeve sipas kategorive dhe nënkategorive ekonomike dhe jepen arsyetimet apo sqarimet e nevojshme për rrjedhën e shpenzimeve buxhetore për periudhën kohore të raportimit dhe krahasimet me periudhën paraprake.

Megjithatë, komisioni ka bërë vërejtje për mosdërgimin e raportit me kohë në Kuvend, meqë nuk mund të arsyetohet vonesa prej më shumë se prej 6 muajve për ta bërë këtë.

Po ashtu, komisioni ka bërë vërejtje edhe në tejkalimin e pjesës më të madhe të të gjitha shpenzimeve nga Institucioni i Avokatit të Popullit me kategoritë ekonomike, mallra dhe shërbime, në krahasim me buxhetin e planifikuar.

Dua t'i njoftoj deputetët e nderuar të këtij Kuvendi se kërkesat e Institucionit të Avokatit të Popullit për shtim të buxhetit edhe për kategorinë paga dhe mëditje, edhe për kategorinë mallra dhe shërbime, edhe për shtimin e numrit të punësuarve, edhe për mjetet për investimet kapitale janë rritur sipas kërkesës së Avokatit të Popullit për vitin 2013, çka do të thotë që në vitin 2013, krahasuar me vitin 2012, Avokati i Popullit ka pasur një shtim të numrit të të punësuarve, ka pasur shtim të pagës dhe mëditjeve për 142 272 euro, për mallra dhe shërbime për 81 707 euro, kurse për investime kapitale janë shtuar mjetet në vitin 2013, krahasuar me atë të vitit 2012, për 69 050 euro, çka do të thotë se gjithsej shtesat kanë qenë 286 729 euro.

Megjithatë, Institucioni i Avokatit të Popullit ka bërë tejkalim të shpenzimeve pothuajse në të gjitha kategoritë e shpenzimeve. Për shpenzimet e udhëtimit janë tejkaluar shpenzimet në krahasim me atë që është planifikuar për 11,37%. Për shpenzimet e udhëtimit zyrtar jashtë vendit janë tejkaluar shpenzimet për 4,38%, krahasuar me atë që është planifikuar. Për mëditjet e udhëtimeve zyrtare jashtë vendit për 84,16%. Shpenzimet e telefonisë mobile janë tejkaluar prej 68,85%. Shpenzimet kontraktuese, shërbimet kontraktuese janë tejkaluar për 239,73%. Për mobilie 17,40%, për mirëmbajtje dhe riparim të automjeteve për 34,24%, për dreka e darka zyrtare janë tejkaluar për 6,75%, çka do të thotë që Institucioni i Avokatit të Popullit e ka pasur buxhetin prej 681 310 euro, ndërsa shpenzimet gjatë kësaj periudhe kanë qenë 625 389 097 euro, që do të thotë janë shpenzuar 91,79%.

Për paga dhe mëditje janë shpenzuar 96,35%, kurse për shpenzime komunale 62,38% dhe investimet kapitale kanë qenë të shpenzuara 91,79%.

Të hyrat nga donatorët - Institucioni i Avokatit të Popullit i ka shfrytëzuar edhe disa të hyra nga donatorët në vlerë totale për 23 338 euro, prej të cilave janë shpenzuar 12 879 euro dhe donatorët që e kanë mbështetur Institucionin e Avokatit të Popullit për vitin 2012 ka qenë Mbretëria e Norvegjisë, Republika e Turqisë, OSCE, UNDP dhe institucionet e tjera.

Pas një diskutimi që është bërë në Komisionin për Buxhet dhe Financa, ku është kërkuar nga Institucioni i Avokatit të Popullit t'i japë sqarimet e nevojshme për tejkalimin e shpenzimeve në krahasim me atë që është planifikuar në vitin 2012, sqarimet e tij ishin të pamjaftueshme për ta arsyetuar mospërputhjen e planifikimit në shpenzimin e mjeteve të buxhetit. Kështu që Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka miratuar raportin financiar të Avokatit të Popullit, por me qëllim të një auditimi të mënyrës ekonomike, efikasitetit dhe efektshmërisë në menaxhimin e mjeteve financiare të Institucionit të Avokatit të Popullit gjatë kryerjes së detyrave të tij, Komisioni i ka rekomanduar Kuvendit që, duke u bazuar në nenin 3.7 të Ligjit nr. 03/L-075 për themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe Zyrës së Auditimit në Kosovë, të kërkojë nga Auditori i Përgjithshëm të kryejë auditimin e mbarëvajtjes apo auditimin e performansës së Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2012 dhe raportin e auditimit t'ia dërgojë Kuvendit. Njëkohësisht rekomandohet që Institucioni i Avokatit të Popullit t'i ngrejë kapacitetet e brendshme profesionale për planifikim më të mirë të shpenzimeve buxhetore për të ardhmen.

Rekomandimet e Komisionit për Buxhet dhe Financa janë miratuar njëzëri nga të gjithë anëtarët dhe me këto rekomandime është miratuar edhe raporti financiar i Institucionit të Avokatit të Popullit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, fjalën e ka deputeti Kurtan Kajtazi.

KURTAN KAJTAZI: Faleminderit, kryetar!

I nderuar Avokat i Popullit,

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar raportin e Institucionit të Avokatit të Popullit, raport ky i ardhur me vonesë mjaft të madhe në Komisionin për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të pagjetur dhe Peticione, që është përgjegjës për shqyrtimin e këtij raporti dhe monitorimin e Ligjit për Avokatin e Popullit.

Mbi të gjitha, vërejtjet që ia ka dhënë komisioni këtij raporti dhe kërkesat për plotësime dhe ndryshime, përkatësisht largimin e disa segmenteve ku Avokati i Popullit u referohet medieve të shkruara në Kosovë, e jo hulumtimi i punës së Avokatit të Popullit, pastaj plotësimi i raportit me hulumtime rreth Ligjit mbi diskriminimin, pastaj hulumtimet më të mëdha dhe më të thukëta edhe nëpër komunat tjera rreth Ligjit për barazinë gjinore, raporti i është kthyer në komision me ndryshimet, përkatësisht plotësimet simbolike me qëndrimin e Avokatit të Popullit se ky raport nuk kërkon të miratohet as nga komisioni, e as nga Kuvendi, por vetëm të shqyrtohet.

Dinjiteti i lënduar i të drejtave të barabarta dhe të patjetërsueshme i të gjithë anëtarëve të familjes njerëzore është themel i lirisë, drejtësisë dhe paqes në botë. Te dinjiteti i njeriut, raporti i Avokatit të Popullit përpilohet vetëm në një punë nëpër qendrat e shëndetit mendor në Shtime dhe qendrat tjera dhe nuk e thekson asnjë rast të shkeljeve të dinjitetit dhe njeriut, dhe një rast të të punësuarve të ansamblit “Shota”.

Te barazia gjinore, Avokati me të drejtë shpreh brengosjen e tij për pozitat udhëheqëse të grave dhe vendimmarrjen, veçmas në nivelet komunale, por jo edhe te e drejta e grave për punë, përkatësisht punësimi i tyre në institucionet publike.

Gjatë monitorimit të Ligjit për barazi gjinore, ne si komision kemi të dhëna të sakta se ka një avancim të pozitës së gruas në shoqëri, respektim i kuotës për punësim, bile edhe tejkalim i saj në shumë institucione, shkelja e të drejtave të lehonave në institucionet publike nuk ka ndodhur asnjëherë dhe respektohen rregullat e konkursit në institucionet publike sa i përket barazisë gjinore, por rastet e theksuara nga Avokatit të Popullit janë nëpër disa institucione private dhe gjatë leximit të këtij raporti ta krijon një opinion krejt tjetër nga ai që është te barazia gjinore.

Sa i përket shkollimit, situata është shqetësuese. Është situata te vajzat e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë. E drejtë është kërkesa e Avokatit të Popullit për rregullimin e bazës gjinore, përkatësisht definimit të qartë të bartjes së simboleve fetare nëpër shkolla.

Trend i vazhdueshëm i dhunës në familje, i raportuar nga Avokati i Popullit në Kosovë, është shqetësues jo vetëm për institucionet përgjegjëse të vendit, por edhe për shoqërinë kosovare. Tek e drejta për jetën, përkatësisht të drejtat e akuzuarve, Avokati paraqet një situatë jo të mirë në burgje dhe trajtimin joadekuat të të burgosurve, zvarritje të procedurave gjyqësore, mbajtja e të burgosurve larg nga vendbanimet dhe familjarët e tyre, procedurat e gjata të paraburgimit dhe Avokati me të drejtë rekomandon të shqiptohen masat e tjera alternative dhe jo vetëm paraburgimi si mjet i sigurimit të të akuzuarve.

Te liria e lëvizjes, raporti i Avokatit të Popullit është i mangët, edhe pse si çështje mjaft e rëndësishme, me theks të veçantë, në pjesën veriore të Kosovës, ai e kalon shkarazi dhe këtë të drejtë aq themelore në të drejtat e njeriut e trajton jo drejt, jo në formën e duhur dhe krijon huti dhe opinion të gabuar për ata që nuk e njohin mirë situatën dhe lirinë e lëvizjes në Kosovë.

Shqetësues është raporti i përpunuar mirë nga Avokati i Popullit me rastin e zvarritjes së procedurave të shkurorëzimit, procedurat për vendosjen e kujdestarisë së fëmijëve, alimentacionit dhe ekzekutimit të vendimeve gjyqësore.

Sa u përket lirive fetare në Kosovë, përveç kërkesës për plotësim dhe ndryshimin e ligjit dhe rregullave të pozitës edhe rregullimit të pozitës juridike të bashkësive fetare, nuk ka ndonjë hulumtim dhe analizë të duhur nga Avokati i Popullit.

I drejtë është rekomandimi i Avokatit të Popullit për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, për azhurimin e listave të votuesve, shlyerja e personave të vdekur dhe azhurimi i adresave të votuesve dhe të bëhet revidimi dhe ndryshimi i ligjeve zgjedhore.

Shqetësues është fakti i shkeljes së të drejtave, mospërfillja, përkatësisht moszbatimi i vendimeve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës, por vlen të theksohet edhe shqetësimi ynë, edhe si Grup Parlamentar, edhe si komision, për mospërfilljen e këtij institucioni dhe nga vetë Avokati i Popullit.

Shqetësues është edhe grumbullimi i lëndëve gjyqësore në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, që ka të bëjë me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, dhe gjendja e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptian, kushtet joadekuate jetësore dhe banesore në të cilat jetojnë, arsimimi i fëmijëve të tyre, gjendja e rëndë ekonomike. Numri i madh i të papunëve të këtyre komuniteteve nuk duhet ta shqetësojë vetëm Avokatin e Popullit, jo vetëm ne si deputetë, por të gjitha institucionet shtetërore, që kanë për obligim ta përmbushin strategjinë për integrimin e komuniteteve rom, ashkali, egjiptian, strategji kjo e përpiluar 2009-2015, që në mënyrë të hollësishme elaboron shqetësimet dhe problemet me të cilat ballafaqohen këto komunitete, si dhe masat të cilat duhet të ndërmerren, si në nivelin qendror, ashtu edhe në nivelin lokal, edhe pse ka pasur lëvizje pozitive në këtë drejtim. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, deputeti Haki Demolli e ka fjalën.

HAKI DEMOLLI: Faleminderit, kryetar!

I nderuari Avokat i Popullit, zoti Kurteshi,

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Ndonëse me një vonesë relativisht të madhe, ne sot para vetes e kemi për diskutim raportin vjetor të Avokatit të Popullit për vitin 2012.

Për këtë raport, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës vlerëson se është gjithëpërfshirës dhe se është punuar me metodologji profesionale, duke e pasqyruar me sukses dhe në mënyrë tejet reale punën njëvjeçare të këtij institucioni shumë të rëndësishëm për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Kosovë, kurse sa i përket përmbajtjes së raportit do të veçonim disa çështje, të cilat, jo vetëm që e meritojnë një trajtim dhe komente shqyrtuese, por në të njëjtën kohë paraqesin shqetësime serioze për cenimin e të drejtave të qytetarëve tanë.

Kësisoj, është mjaft shqetësuese që me gjithë të gjitha masat dhe përkrahjes që u bëhet gjykatave dhe prokurorive tona, ende ka raste të zvarritjes së procedurave penale, madje edhe për veprat penale të vrasjeve, siç ishte rasti me vrasjen e një të reje në Prizren, kur paramendoni - prokurori madje edhe një vit pas vdekjes së viktimës - nuk e ka siguruar raportin e autopsisë nga Instituti i Mjekësisë Ligjore, me pretekst se në Prokurorinë e Qarkut në Prizren ishin ndërruar disa prokurorë të kësaj çështjeje penale.

Po ashtu, shqetësuese është se, siç theksohet në faqen 40 të raportit, për territorin e Kosovës dhe shtetasit e saj ende vlen regjimi i vizave të BE-së, që do të thotë se qytetarët e Kosovës ende nuk mund të udhëtojnë në vendet e Bashkimit Evropian pa viza.

Është e ditur se Institucioni i Avokatit të Popullit nuk mund ta zgjidhë këtë problem vital për lirinë e lëvizjes së kosovarëve, por vetëm mund të konstatojë gjendjen dhe cenimin e kësaj lirie. Përndryshe, kompetente dhe përgjegjëse është Qeveria dhe ministritë e saj, të cilat, duke përmbushur kërkesat e bashkësisë ndërkombëtare, përfshirë këtu edhe luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, do ta përshpejtonin procesin e heqjes së vizave për kosovarët.

Por, gjithsesi, njëri prej shqetësimeve më të mëdha për të drejtat e qytetarëve të Kosovës vërehet nga konstatimi i Avokatit të Popullit, sipas të cilit: “Siguria nga keqpërdorimet, sa i përket përgjimit të paligjshëm të komunikimeve në Kosovës, e drejtë e garantuar me Kushtetutë, është baras me zero. Në Kosovë nuk ka as siguri minimale nga përgjimet abuzive të komunikimit. Sikur autoritetet vendore, ashtu edhe ato ndërkombëtare përgjegjëse në Kosovë, kanë dështuar plotësisht në ofrimin e sigurisë së komunikimeve të të gjitha llojeve në Kosovë”.

Paramendoni, sa e ndiejnë vetën të sigurt qytetarët e rëndomtë të Kosovës, kur e kuptojnë dhe e kanë të ditur se vetëm në 2 vjetët e fundit, si viktimat të përgjimeve të paligjshme janë paraqitur vetë personat udhëheqës të Qeverisë, pastaj të Ministrisë të Punëve të Brendshme, deputetët, si dhe personat e tjerë në pozita udhëheqëse të institucioneve të larta shtetërore. Vetvetiu shtrohet pyetja: Kush janë ata keqpërdorues të ligjit, të cilët i keqpërdorin pozitat e tyre për të përgjuar komunikimet e qytetarëve pa urdhëresën dhe pëlqimin e organeve kompetente? Kush janë ata që në mënyrë të paligjshme ndërhyjnë në privatësinë e qytetarit? Kush janë ata që janë mbi ligjet, të cilat i aprovon ky Kuvend?

Lidhur me respektimin e kësaj të drejte të qytetarit tanë, gjithsesi duhet bërë edhe pyetjen e radhës: Si duhet mbrojtur qytetarin nga këto keqpërdorime, të cilat janë veprimet konkrete në këtë drejtim? Në vend të përgjigjes, ne kërkojmë që Kuvendi të angazhohet për shtytjen e Qeverisë që nëpërmjet mekanizmave ligjorë t’i ndërmarr hapat konkretë për pengimin dhe ndalimin e keqpërdorimeve në sferën e përgjimit dhe kësisoj - mbrojtjen e qytetarëve ta ngrejë në nivel të kënaqshëm, e jo ta lërë në shkallën zero, siç është thënë në raport.

Një shqetësim tjetër i theksuar tjetër në këtë raport është shkalla e lartë e papunësisë në Kosovë, me gjithë faktin se me Kushtetutë është e garantuar e drejta e punës dhe e ushtrimit të profesionit. Përveç kësaj, sipas raportit, bazuar në hetimet e Avokatit të Popullit, gjatë kësaj periudhe janë konstatuar shkelje të të drejtës së marrëdhënies së punës, si në sektorin publik, ashtu edhe në atë privat, si gjatë procedurave të punësimit, pastaj ndërprerjes së marrëdhënies së punës, kohëzgjatjes dhe kompensimit jashtë orarit, mosshfrytëzimit të së drejtës për pushim vjetor e të tjera.

Në sferën e punës, shqetësues është edhe fakti se me gjithë synimin që shoqëria kosovare të bëhet një shoqëri humane, edhe gjatë kësaj periudhe raportuese është e pranishme

dukuria e punës së fëmijëve që punojnë punë të dëmshme dhe të rrezikshme për shëndetin e tyre. Kështu, fëmijët e moshës jomadhore hasen për çdo ditë duke punuar me karroca dore, duke kërkuar lëmoshë nëpër lokacione publike, duke shitur cigare dhe duke kryer punë të tjera të rënda.

Andaj, nga ky vend shfrytëzoj konstatimin e këtij raporti që të trokas në ndërgjegjen e qeveritarëve tanë që po pasurohen dita-ditës në mënyra rapide, që t'i reduktojnë shpenzimet jashtëzakonisht të larta për vetura luksoze, për telefonata, për darka e dreka të shumta, dhe të hollat e kursyera nga këto shpenzime t'ua dedikojnë këtyre fëmijëve të varfër, të cilët në vend të punës së rëndë do t'u ktheheshin bankave shkollore për ta zënë diturinë sikur moshatarët e tjerë të tyre.

Kur jemi te shkollat, mjaft shqetësues është edhe fakti se në shkollat kosovare, sipas raportit, është e tejet e pranishme dukuria e dhunës që shfaqet, qoftë nga mësimdhënësit kundër nxënësve, qoftë nga nxënësit ndaj nxënësve, e veçmas dhuna nga nxënësit ndaj mësimdhënësesve, dhe ajo nga prindërit ndaj mësimdhënësesve.

Me qëllim të ofrimit të sigurisë për nxënësit dhe për personelin mësimor të shkollave tona, si dhe me qëllim të mbrojtjes së tyre nga dhuna, kërkoj një angazhim të posaçëm të Ministrisë së Arsimit, pastaj të drejtorive komunale të Arsimit, e posaçërisht Ministrisë të Punëve të Brendshme për t'i ndërmarrë masat e nevojshme ligjore që nxënësit dhe mësimdhënësit tanë ta ndiejnë veten më të sigurt dhe të mbrohen nga çfarëdolloj dhune dhe rreziku që mund t'u paraqitet ndaj tyre.

Duke pasur parasysh këto, si dhe shqetësimet e tjera që janë trajtuar në raport, e që për shkak të kohës nuk u theksuan, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës në parim do ta përkrahë dhe do ta japë votën për aprovimin e këtij raporti. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të “Vetëvendosjes”, fjalën e ka deputetja Albana Gashi.

ALBANA GASHI: Gjatë shqyrtimit në parim të raportit të Institucionit të Avokatit të Popullit në Komisionin për të Drejtat e Njeriut, ne i kemi dhënë disa vërejtje dhe rekomandime që kanë të bëjnë rreth këtij raporti. Disa nga vërejtjet e Lëvizjes “Vetëvendosje” në këtë raport, kanë qenë si mospërfshirja e rastit të sulmit terrorist ndaj familjes Haradinaj, kur e humbi jetën Selver Haradinaj, si dhe u plagosën gruaja dhe fëmijët e tij. Këtë pjesë ia kemi sugjeruar avokatit që ta përfshijë tek e drejta për jetën, ku përveç definimit të të drejtës për jetën, nuk kemi parë që është përfshirë diçka tjetër.

Edhe te e drejta e lëvizjes së lirë nuk janë përfshirë rastet e shqiptarëve të pjesës veriore të Mitrovicës. Ata nuk mund të kthehen nëpër shtëpitë e tyre në veri për shkak të kriminelëve serbë atje. Edhe në ato pak raste kur kanë provuar të kthehen e t'i ndërtojnë shtëpitë e tyre në tokat e tyre, ata janë penguar po ashtu nga kriminelët serbë.

Këto raste nuk janë përfshirë në këtë raport me arsyetimin se nuk ka pasur ndonjë ankesë zyrtare nga shqiptarët e asaj ane. Mirëpo, në anën tjetër, te pjesa “liria e fesë, e besimit dhe e ndërgjegjes”, më saktësisht te Kisha Ortodokse Serbe, edhe pse Institucioni i

Avokatit të Popullit nuk ka marrë ndonjë ankesë zyrtare, në këtë raport është përfshirë në më shumë se një faqe me informacione se si qenkan dëmtuar varrezat dhe kishat ortodokse dhe e gjithë kjo duke u bazuar në disa media serbe.

Publikimi i një lajmi të tillë në disa media i ka mjaftuar Institucionit që t'i përfshijë ato në një dokument zyrtar, ndërsa humbja e një jete, plagosja e disa të tjerëve, pengimi i ndërtimit të shtëpive nuk është parë e arsyeshme që të përfshihet në këtë raport. Ne insistojmë që Avokati i Popullit nuk duhet të punojë në mënyrë selektive, duke e favorizuar një grup qytetarësh dhe duke i diskriminuar të tjerët. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, deputetja Kymete Bajraktari e ka fjalën.

KYMETE BAJRAKTARI: I nderuar zoti kryetar!

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e ka shqyrtuar raportin për vitin 2012 të Institucionit të Avokatit të Popullit. Sa i përket përmbajtjes së tij, është raport përafërsisht i strukturuar dhe me përmbajtje të njëjtë sikur edhe raportet e viteve të mëparshme, i cili është i bazuar në kapitullin e dytë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Ballafaqimi i Institucionit të Avokatit të Popullit me ankesat e qytetarëve, si dhe hetimi i këtyre ankesave paraqesin situatën dhe gjendjen reale dhe alarmante në të cilën gjendet qytetari i Kosovës, i paraqitur në këtë raport. Mbrojtjen shëndetësore dhe sociale, të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të drejtën për mjete juridike, mbrojtjen e pronës, mosrregullimin ligjor të pensioneve, të sigurimeve shëndetësore, mbrojtjen jo të duhur shëndetësore, gjendjen jo të mirë të institucioneve publike shëndetësore dhe mungesën e barnave nga lista esenciale, janë disa nga çështje me të cilat përballlet qytetari i Kosovës.

Pastaj, alarmante është gjendja në sistemin e drejtësisë, ku bëhen zvarritje të mëdha të lëndëve dhe të çështjeve. Moszbatimi i vendimeve të plotfuqishme gjyqësore, falsifikimet, cenimi i të drejtës në pronë. Në këtë raport është përfshirë edhe çështja e sigurisë, e që mendoj që është një nga elementet bazë për mirëqenien e qytetarit, sepse pa siguri nuk ka liri të lëvizjes, zhvillim ekonomik, sistem efikas të drejtësisë dhe liri të shprehjes. Në këtë raport, Institucioni i Avokatit të Popullit kërkon nga Kuvendi i Kosovës miratimin e Ligjit për sigurime shëndetësore dhe të Ligjit për sigurimin invalidor dhe pensional, si dhe krijimin e infrastrukturës ligjore për rregullimin e çështjeve pronësore.

Miratimi i këtyre ligjeve do ta përmirësojë dhe lehtësojë jetën e qytetarëve, të cilët janë të zhgënjyer dhe të dëshpëruar në përkushtimin e institucioneve për ta përmirësuar mirëqenien e tyre.

Raporti i 12-të vjetor i Avokatit të Popullit paraqet gjendjen reale të të drejtave dhe lirive të njeriut në Kosovë. Përmban rekomandime të bëra institucioneve qeveritare, Gjyqësorit

dhe të gjitha institucioneve, të cilat nuk e kanë respektuar ligjin për të drejtat dhe liritë e njeriut.

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës do ta votojë raportin e 12-të të Institucionit të Avokatit të Popullit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit “Zajednička Budućnost”, deputetja Biserka Kostiq e ka fjalën.

BISERKA KOSTIĆ: Zahvaljujem predsedniče!

Poštovane kolege narodni poslanici,

Parlamentarna “Zajednička Budućnost” je razmatrala izveštaj institucije Narodnog advokata za 2012. godinu.

Sama činjenica da je ovaj izveštaj Skupštini dostavljen sa više od šest meseci zakašnjenja, i da u ovom periodu bi već trebalo početi sa kompletiranjem izveštaja za 2013. godinu, mi tek danas razmatramo i usvajamo izveštaj za 2012. godinu, što moram iskazati svoje nezadovoljstvo i svoju zabrinutost.

Uzimajući u obzir primedbe i sugestije prethodnih govornika mojih kolega, sa kojima se i ja u potpunosti slažem, i ja imam za obavezu da dam određene primedbe uočene prilikom analize izveštaja institucije Ombusmana.

Smatram da sam izveštaj nije kompletiran. Izveštaj je nepotpun, iako se u funkcionalnoj komisiji sugerisalo da se izveštaj treba dopuniti, mnoge primedbe i zahtevi članova Funkcionalne komisije nisu uvaženi. Izveštaj je površno urađen i isključivo su obuhvaćene one teme koje je sam Narodni advokat smatrao da treba napomenuti.

Tako da recimo u pojedinim slučajevima poziva se isključivo neizveštavanje medija, kao najverodostojnije informacije, prema kojima se vodi i donesi određene zaključke.

Što se tiče podglavlja u izveštaju koji se odnosi na upotrebu i poštovanje službenih jezika na Kosovu i poštovanje člana Ustava 5. i zakona o jezicima, znamo da institucija Narodnog advokata nema izvršnu vlast, ali smatram da se ne radi dovoljno i ne preduzimaju se konkretni koraci da se preporuke institucije Narodnog advokata poštuju, uvažavaju u javnim institucijama, gde se identifikovalo kršenje Ustava zakona, kako bi se smanjila diskriminacija.

Po pitanju povratnika i povratka raseljenih lica, postoje samo podaci i komparacija broja povratnika 2011/12. godina, ali ne i konkretne preporuke, koje treba preduzeti po ovom pitanju.

U izveštaju u podglavlju “sloboda okupljanja”, u podglavlju “sloboda veroispovesti”, uveravanja i savesti, u podglavlju “sloboda izražavanja”, niti u bilo kojem drugom podglavlju, ne pominje se 28. jun 2012. godine i obeležavanje tradicionalnog srpskog

praznika Vidovdan, diskriminacija koja se desila tog dana, prekomerna upotreba sile KPS policije.

Generalno ponašanje policije, prijavljeni slučajevi o primeni sile, iako Ustav garantuje isticanje svih simbola svih nacionalnih zajednica, tog dana nije bio slučaj, već razlog za neadekvatno ponašanje policije, podizanje tenzija, što nije primereno niti u skladu sa demokratskim načelima.

Čak ni ovakvi slučajevi diskriminacije prema srpskoj zajednici širokih razmera nisu ni naglašeni u izveštaju, iako su sve medije glasno to preneli. A Narodni advokat, pošto se često poziva na medije, u ovo nije bio slučaj.

Na kraju, što se tiče nestalih osoba, kao posledica oružanog sukoba na Kosovu, u izveštaju nije obuhvaćena ova kategorija, uz obrazloženja Narodnog advokata da se ne bavi i da nije u njegovoj nadležnosti. Pa se ja pitam, da li je u nadležnosti diskriminacija najteži oblik kršenja ljudskih prava? Da li je u nadležnosti institucije da se bavi pitanjem lišenja slobode, slobode ljudi i da li je u nadležnosti institucije pravo članova porodice da znaju o sudbini svojih najmilijih, koji su nestali i koji se još uvek traže?

S pravom smatram da ovo pitanje i ova tema treba biti jedna od prioriternih u izveštaju, jer u XXI veku čin kidnapovanja i lišenje slobode je najveći zločin protiv čovečnosti i najteži oblik kršenja osnovnih ljudskih prava, kako osoba koje se vode nestalih, tako i njihovih članova porodica.

Takođe, zabrinjava i sama činjenica zapravo nepoštovanje Narodnog advokata same institucije i članova komisije, koji podnosi izveštaj. Smatram za shodno Vas predsedniče, i ostale članove ovog uvaženog doma, da informišem o nepoštovanju mene kao osobe, kao člana ovog uvaženog doma, kao poslaniku u Skupštini, gde sam u više navrata na redovnom zasedanju Skupštine, skupštinskog Odbora za ljudska prava, u kojem sam inače druga potpredsednica, bila vređana od strane Narodnog advokata, gde sam dobijala epitete da sam “racista”, gde pri tom smatram da niti je njegov komentar uvaženog Narodnog advokata umesan, niti realan, bar ne prvog čoveka ispred institucije koja treba da pruža besplatnu pravnu pomoć, da radi na smanjenju diskriminacije, i da štiti osnovna ljudska prava. Smatram da nije umesno da ja u ovom domu, na ovaj način moram da štitim svoja prava i dobijam takve nazive od čoveka ispred takve ugledne institucije. Naravno pred svim članovima komisije, pred svim posmatračima koji nadgledaju komisiju u prisustvu medija.

Takođe mene zabrinjava jako govor mržnje od strane Narodnog advokata, što smatram da bi svi članovi ovog doma trebali biti upoznati sa dešavanjima na komisiji onda kada Narodni advokat podnosi izveštaj, gde u više navrata svoje zamenike, odnosno jednog od zamenika narodnog advokata - Bogoljuba Staletovića, ispred srpske zajednice naziva, citiraću “idiotom”, naziva “glupim”, “šovinomom”, “neprofesionalnim” i “nesposobnim”, i sve to u prisustvu medija. Isto tako zabrinjava me i činjenica i nemogućnost obavljanja posla istoimenog čoveka, koji je legitimno izabran, koji ne može da ostvari svoja prava u instituciji, koja treba da štiti druga prava i koja zapravo takvo kršenje treba da

identifikuje u drugim institucijama, a ne da takvo kršenje ljudskih prava radi u svojoj instituciji.

Isto tako naglasila bih da je jako zabrinjavajuće i nepoštovanje odluka nezavisnog narodnog organa i zbog niz drugih nepravilnosti uočenih u samom izveštaju Narodnog advokata, Parlamentarna grupa “Zajednička Budućnost” neće podržati izveštaj i glasaćemo protiv. Hvala!

KRYETARI: Pasi u përsërit nga disa deputetë të komisionit, unë them që komisioni ka të drejtë të rekomandojë, por raporti është i Avokatit të Popullit.

E drejta e komisionit është të rekomandojë, por raporti është i Avokatit të Popullit dhe deputetët s’kanë të drejtë ta diktojnë si e bën raportin Avokati i Popullit.

Fjalën e ka deputeti Hydajet Hyseni.

HYDAJET HYSENI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Do të dëshiroja t’i përshëndes edhe përfaqësuesit e Qeverisë, por ata po mungojnë. Është domethënëse kur në një debat që i ka për temë të drejtat e njeriut mungojnë të gjithë ministrat, e i kemi me bollëk, zëvendësministrat edhe më shumë.

Megjithatë, unë dua ta përshëndes posaçërisht Avokatin e Popullit dhe ekipin e tij, ta përshëndes raportin që na është ofruar dhe rekomandimin e komisionit. Konsideroj se raporti është i mirë, jo vetëm si hartim, por edhe si zhvillim. Është gjithëpërfshirës, e ka brenda tij vazhdimësinë që u theksua edhe nga parafolësit e tjerë, por është një vazhdimësi e angazhuar. Konstaton gjendjen reale dhe objektive, konstaton progresin e pamohueshëm në fushën e të drejtave të njeriut, por konstaton edhe sfidat, konstaton edhe lëshimet e shumta dhe këto në funksion të progresit të ardhshëm.

Mendoj që si ndërtim i raportit është me rëndësi të theksohet.

Theksohet në raport dhe mendoj që do shquar fakti që angazhimi i Institucionit të Avokatit të Popullit këto vitet e fundit, edhe me ndihmën që është dhënë nga partnerët e jashtëm, e ka shtuar edhe respektin për të drejtat e njeriut, në përgjithësi, dhe për Institucionin e Avokatit të Popullit si një mekanizëm i pazëvendësueshëm në këtë fushë.

Interesimi i rritur i qytetarëve dhe efektet e këtij interesimi mendoj që janë indikator i rëndësishëm edhe i besueshmërisë së Institucionit të Avokatit të Popullit. Mendoj që një kualitet që e ka sjellë angazhimi i ekipit të tashëm në Institucionin e Avokatit të Popullit, që do theksuar dhe do mbajtur edhe për të ardhmen, është qasja e pavarur dhe e paanshme që e ka krijuar edhe një imazh dinjitoz për Institucionin e Avokatit të Popullit jashtë politikave dhe jashtë lojërave politike, jashtë ndikimeve të ndryshme politike etj.

Mendoj që është një vlerë që i duhet Institucionit të Avokatit të Popullit dhe jo vetëm atij.

Mendoj që mund të vlerësohet edhe funksionimi i brendshëm i Institucionit të Avokatit, madje edhe menaxhimi i brendshëm si një model i funksionimit edhe për institucionet simotra. Ajo që ndoshta ka munguar dhe nuk është afirmuar sa duhet ka qenë e pranishme edhe në gjeneratat e mëparshme të Institucionit të Avokatit të Popullit dhe ka zënë vend edhe në raportin që e kemi përpara. Është edhe avancimi i bashkëpunimit ndërkombëtar i Institucionit të Avokatit të Popullit dhe rritja e reputacionit të këtij institucioni edhe në arenën ndërkombëtare.

Kjo dhe në saje të cilësisë së punës së efekteve të angazhimit të Institucionit të Avokatit të Popullit, të cilat janë vlerësuar dhe vlerësohen edhe në përmasa ndërkombëtare. Në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Evropës ka qenë i dukshëm angazhimi dhe roli i Institucionit të Avokatit të Popullit, jo vetëm në fushën që e mbulon, por edhe në ndërtimin e imazhit të Kosovës së re dhe zhvillimet demokratike në Kosovë.

Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës kohëve të fundit e ka miratuar një raport, një rezolutë dhe rekomandime për forcimin e rolit të Institucionit të Avokatit të Popullit në të gjitha vendet. Përvoja e Kosovës është theksuar dhe mendoj që është diçka që e nderon, jo vetëm Institucionin e Avokatit të Popullit, por gjithë shoqërinë kosovare. Roli i Avokatit të Popullit në shoqëri është edhe një indikator i gjendjes së përgjithshme dhe i shkallës së demokratizimit, shkallës së respektimit të drejtave të njeriut.

Mendoj që si i tillë është bazë edhe për angazhimet e ardhshme. Megjithatë, 2-3 çështje konkrete do të dëshiroja t'i theksoja edhe në segmentin që u theksua këtu me të drejtë në raportin e duhur adekuat që duhet të ndërtohet ndërmjet të drejtave të njeriut dhe funksionimit të sistemit të drejtësisë. Është krijuar një klishe, sipas së cilës në funksion të pavarësisë së gjyqësisë nuk bën as të debatohet për dimensionin e të drejtave të njeriut, kur ato shkelen edhe nga drejtësia. Edhe drejtësia mund t'i shkelë të drejtat e njeriut. Edhe drejtësia mund ta shkelë ligjin dhe shembulli më i mirë se kjo nuk është ndonjë herezi, nuk është ndonjë flagrancë, siç ka ndodhur që njëfarë mënyre edhe Kuvendit të Kosovës t'i faturohet edhe një debat i kujdesshëm pa u përzier në ndarjen e drejtësisë, por për shkelje evidente të të drejtave të njeriut, të njerëzve të dënuar pa të drejtë, pa bazë ligjore, me fakte që dihen ashikare prej të gjithëve, është edhe ajo që kohë më parë në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Evropës, jo vetëm është zhvilluar debat, por është miratuar rezolutë, do të thotë ndërkombëtare, për rastin "Magnicki".

Askush nuk e vlerësoi atë si ndërhyrje në punët e drejtësisë, por nëse mbrohen të drejtat e njeriut pa u përzier në ndarjen e drejtësisë është diçka që i duhet, e ndihmon drejtësinë. Në këtë kuadër do të dëshiroja ta vë theksin edhe te ajo që sot na u prezantua këtu. Nuk është përzierje edhe në pavarësinë e Ekzekutivit e të Policisë, nëse ne e ngremë zërin edhe për ato që i dëgjuam, natyrisht nëse është ashtu siç tha kolegu ynë dhe unë dëshiroj të besoj ashtu që Policia të keqtrajtojë edhe deri në rrahje brutale deputetin e Kuvendit të Kosovës.

Është diçka që nuk na lë të jemi indiferentë, prandaj edhe mendoj që është diçka që duhet të ketë vëmendjen, jo vetëm të ministrisë, siç u kërkua sot në fillim të kësaj seance, por edhe të të gjithë atyre që merren me të drejtat e njeriut. Nëse shkelen të drejtat e deputetit,

le të jetë ai edhe fajtor për diçka, në mënyrën siç u prezantua sot në Kuvend, merreni me mend çka ndodh me qytetarët e pambrojtur.

Është një alarm që mendoj se duhet të trokasë në ndërgjegjen e të gjithë atyre që janë përgjegjës për të parandaluar situata të tilla.

Unë e falënderoj Institucionin e Avokatit të Popullit për punën që ka bërë dhe për raportin që na ka sjellë. Uroj suksese të ardhmen!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Xhevdet Neziraj.

XHEVDET NEZIRAJ: Faleminderit, i nderuar zoti kryetar!

Kolegë deputetë,

Unë do të flas shumë shkurt dhe për mua, si përfaqësues i komunitetit egjiptian, janë shqetësuese të gjitha ato në raport që institucionet janë duke bërë shkelje, mospunësimin e komunitetit egjiptian nëpër shumë institucione për vendet që i takojnë. Mandej, për banime joformale që të zgjidhet dhe ky problem, por do ta kisha sugjeruar Avokatin e Popullit që prej pesë zëvendësve do të ishte mirë që një të jetë i komunitetit egjiptian. Jo vetëm të jetë Bogolubi ose dikush tjetër, por ka edhe të komuniteteve tjera, dhe në pamundësi që nuk mund ta gjejnë dikë, unë do të mund t'ia gjej një person, vajzë ose mashkull, që përafërsisht është i përgatitur si ata zëvendësit e tij dhe të fillojë nga Avokati i Popullit, por të fillojnë edhe institucionet tjera. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Ganimete Musliu.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuara deputete dhe ju deputetë,

I nderuari Avokat i Popullit,

Fillimisht në këtë seancë, ose në këtë pikë të rendit të ditës u diskutua nga shumë deputetë që ky raport na është sjellë me mbi gjashtë muaj vonesë dhe gjithashtu nga parafolësit u kuptua që përveç raporti i cili na ka ardhur në shqyrtim, tani e kemi edhe një raport tjetër që na ka ardhur në kutitë tona, një raport tjetër nga raporti të cilin ne e shqyrtojmë sot.

Dhe, unë kur i marr këto dy raporte, e pyes veten çfarë po bëjmë ne sot me shqyrtimin e këtij raporti dhe konsideroj që ne nuk po bëjmë asgjë më shumë sesa një humbje kohe kur e shqyrtojmë një raport me mbi gjashtë muaj vonesë dhe gjithashtu paralelisht me këtë raport e kemi edhe një raport tjetër dhe unë sot nuk di se cilit raport t'i referohem faktikisht, cili raport është i besueshëm: është ai i cili na i ka sjellë rekomandimet komisioni, apo është raporti i publikuar nga Avokati i Popullit, se faktikisht këto dy raporte kanë ndryshueshmëri ndërmjet vete.

Të gjeturat në raport që janë ofruar nga komisioni përkatës janë të shumta dhe konsideroj që janë me vend, sepse e kemi shqyrtuar edhe ne. Por, megjithatë, ajo çka mua më shqetëson faktikisht si deputete është shifra që është cekur për gratë dhe vajzat e dhunuara gjatë luftës në Kosovë, ku jepet një shifër strikte prej 20 mijë vetash. Unë

mendoj që Institucioni i Avokatit të Popullit duhet të jetë më i kujdesshëm kur jep shifra të tilla, sepse e dimë që është një pikë shumë e ndjeshme dhe ka qenë disa herë pjesë e debatit edhe këtu, aq më tepër që në kohën e fundit, ose para disa muajve është iniciuar të futet edhe në ligj kategorizimi i këtyre grave, ose i kësaj kategorie.

Mendoj që duhet të jemi më të matur dhe më të kujdesshëm kur kemi të bëjmë me këtë kategori dhe thjesht të mos japim numra blanko, sepse mund t'i hyjmë në hak dikujt që është pjesë e kësaj kategorie.

Gjithashtu, në njërin nga rekomandimet ku thuhet “përdorimi i gjuhëve dhe kthimi i personave”, janë përfshirë në raport, por mungojnë rekomandimet lidhur me këto. Do të ishte mirë që në raporte të tilla të kemi edhe rekomandime të drejta ose thjesht të arsyeshme, siç është një rekomandim ose thjesht siç e ka bërë te KQZ-ja, që mendoj që është diçka me vend që e ka dhënë Avokati i Popullit. Prandaj, mendoj që duhet të jetë edhe në pikat tjera.

Për të mos e zgjatur shumë dhe për të mos i përsëritur kolegët, të cilët veç diskutuan dhe i përmendën të gjitha gjërat, nuk pajtohem plotësisht me rekomandimin që e ka dhënë komisioni përkatës për ta votuar këtë raport, sepse unë e shtroj pyetjen: Çka nëse ne sot e votojmë këtë raport? Cilat janë ndryshimet që mund të ndodhin ose përparësitë nga votimi i këtij raporti? Dhe, e kundërta, çka nëse ky raport sot nuk votohet në Kuvend? Cilat janë pasojat?

Prandaj, mendoj që është mirë që ka ardhur për shqyrtim një raport i tillë, por nuk ka pasur nevojë të rekomandohet për votim. Kështu që nuk e shoh arsyeshmërinë e votimit të këtij raporti, apo mosvotimin e këtij raporti. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Donika Kadaaj-Bujupi.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Konsideroj që aspektet teknike, të cilat u përmendën këtu, sidomos çështja e vonësës, në fakt nuk është kyçe në këtë rast, sepse kemi të bëjmë me një raport mjaft kredibil, i cili substancialisht e pasqyron realitetin në vendin tonë dhe unë kisha dashur ta përgëzoj Avokatin e Popullit për një kredibilitet të lartë që po e tregon.

Mund të them që është në mesin e institucioneve të pavarura, i cili po e ruan pavarësinë përtej faktit që ne mund të konsiderojmë që dy ose tri aspekte, të cilat do të diskutohen edhe nga kolegët tjerë, e që janë të rëndësishme së veçantë nuk janë pjesë e raportit. Ndoshta këto do të jenë edhe rekomandimet e Grupit të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës.

Mirëpo, konsiderojmë se si tërësi koncepti i ruajtjes së pavarësisë dhe pasqyrimin të drejtë është diçka që po e përcjell këtë institucion edhe në vitin e kaluar, edhe këtë vit. Prandaj, kisha dashur ta përgëzoj.

Konsideroj që është momenti i fundit që të reflektojmë në çështjet e përsëritura prej raportit të kaluar, e që janë përsëri të theksuara në këtë raport, që lidhen me sundimin e

ligjit dhe drejtësinë selektive, e cila është paraqitur dhe prezantuar si problem edhe në raportin e vitit 2012. Pastaj, me çështjet që lidhen me drejtësinë në punë, të drejtën e pronës dhe të drejtën për arsim që lidhen kryesisht me 50% e popullsisë që janë gratë e të cilat për shkak të gjendjes së rëndë, krizës së madhe ekonomike, por edhe specifikave që kanë, bazuar edhe në raport, po edhe në atë se çfarë ne e gjejmë gjatë punës dhe përditshmërisë sonë, në fakt janë kategoria që edhe më tepër po rrezikohet dhe diskriminohet në këtë rast.

Kisha dashur tek faqja 23, kemi të bëjmë me një rekomandim të drejtpërdrejtë, është një kërkesë e vazhdueshme e Avokatit të Popullit, te paragrafi i barazisë gjinore, kur thotë që të bëhet plotësim ndryshimi i Ligjit për barazi gjinore. Ndoshta në këtë rast duhet të kemi një përshkrim më të saktë se ku janë sipas Avokatit të Popullit, ngecjet të cilave duhet t'u qasemi dhe përtej retorikës si deputete, të realizojmë veprime konkrete në përkrahjen dhe zbatimin e të drejtave të grave.

Në përgjithësi, edhe njëherë më duhet të them që shpresoj se ky qëndrim i dinjitetshëm nga ana e këtij institucioni, të na i rritë shpresat si vend se atëherë kur kemi individë me vullnet të mirë, në Kosovë mund të kemi edhe sundim të ligjit, kur individë me vëmendje dhe vetëdije të plotë veprojnë konform ligjit dhe japin shembuj të mirë edhe për institucionet tjera. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputetja Blerta Deliu-Kodra e ka fjalën.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje për Avokatin e Popullit, për të gjithë deputetët, për qytetarët e Republikës së Kosovës.

Për të mos i përsëritur ato që u thanë edhe paraprakisht, do të thotë, edhe Raporti i Progresit për Kosovën, një kapitull të rëndësishëm dhe të veçantë ia kushton edhe të drejtave të njeriut dhe në këtë rast edhe mbrojtjes së të gjitha komuniteteve në Kosovë.

Edhe unë e kam brengën e njëjtë, që përmendi zonja Kadaj, për shkak se në raportin e Avokatit të Popullit për vitin 2012 është përmendur plotësim-ndryshimi i Ligjit për barazi gjinore. Po të njëjtin konstatim dhe kërkesë e kemi edhe brenda Raportit të Progresit për Kosovën, ku kërkohet plotësim-ndryshimi i këtij ligji dhe nuk jepen edhe aty detaje se çfarë duhet të ndryshojë. Dhe, është mirë që këto rekomandime të na jepen në vazhdim.

Po ashtu, një gjë që trajtohet brenda raportit është edhe rasti kur kërkohet që të ndryshohet edhe Ligji i punës, konkretisht tek lehonat, ku sipas Raportit të Progresit ka pasur ndikim negativ te gratë që punojnë në sektorin privat.

Prandaj, edhe unë mendoj që është një raport i detajuar, mirëpo do të duhej që të ofroreshin edhe rekomandimet dalëse nga situatat që janë përshkruar, që janë evidentuar brenda Raportit. Konfirmohet edhe njëherë që ka shkelje të drejtave të njeriut, shkelje të drejtave edhe të fëmijëve edhe diskriminim dhe shkelje të parimit të barazisë gjinore, do të thotë që është më së shpeshti e shprehur tek e drejta e pronës, e përmendi edhe kolegja

Novobërdaliu. Do të thotë, gratë vazhdojnë të jenë të privuara dhe vetëm 7% e tyre janë pjesë e trashëgimisë dhe mendoj që këtu duhet të mendohet më detajisht se çfarë duhet të punohet më tepër që këto gra të jenë mbrojtëse të pronës së tyre dhe të jenë trashëguese të kësaj prone.

Po ashtu në këtë raport evidentohet edhe shkalla e rritjes së dhunës në familje. Këtu u përmend, që janë përmendur disa prej komunave, po i përmendi këto, shkalla e dhunës në familje në komunën e Prishtinës, në Gjilan, Ferizaj, Prizren, Pejë, pastaj në Mitrovicë. Unë e kuptoj që brenda raportit është menduar që të spikaten konkretisht komunat e mëdha, mirëpo ka qenë mirë që të kemi një pasqyrë edhe në këto komuna tjera, sepse e dimë që është një tendencë në rritje në shkallën e dhunës në familje.

Dhe, kur jemi te dhuna në familje, do të thotë, shumë shpejt këtyre ditëve e kemi edhe Ditën Ndërkombëtare Kundër Dhunës ndaj Gruas dhe ju ftoj, që bashkërisht të jemi pjesë edhe e fushatës, ku do të ndihmojmë bashkërisht që të zgjatë kjo fushatë 16 ditë aktivitet, do të shpalosen shifra, trajtimi i dhunës në familje, të drejtat e viktimave, si dhe mbrojtja dhe rehabilitimi i këtyre viktimave.

Do të thotë, raporti i Avokatit të Popullit i vë theks të veçantë edhe kuotës gjinore dhe këtu me theks afirmativ. Po e përmend për të dytën herë kuotën gjinore, sepse para dy ditësh me disa kolege deputete kemi qenë në një debat, ku është diskutuar thellësisht për kuotën gjinore dhe ka pasur edhe indikacione që kjo kuotë është diskriminuese për gjininë tjetër. Dhe, unë mendoj se as që do të duhet të vijë në diskutim kjo, sepse së fundi kemi edhe vendimin e Parlamentit Evropian, i cili do të thotë ka marrë vendim që të rrisë kuotën me 40% për të gjitha gratë që janë anëtare të bordeve të ndërmarrjeve publike dhe nëse ne po tentojmë të përafrohemi me vendet e Bashkimit Evropian, mendoj që duhet që kuota të mbetet.

Dhe, diçka tjetër që dua të përmend brenda këtij raporti, do të thotë ka një kapitull të veçantë që i kushtohet edhe të drejtave të njeriut, të cilat janë të parashikuara edhe me ligjet në fuqi. Madje, janë të shumta institucionet që edhe vetë i kemi krijuar për t'i mbrojtur të drejtat e njeriut, por ajo që shoqëria jonë para së gjithash duhet të bëjë dhe të mendojë është që përveç përparimit në infrastrukturën ligjore, të kontribuojmë edhe ne si shoqëri, që këto të drejta të jenë të mbrojtura ashtu si duhet.

Dhe në fund, meqë u diskutua për çështjen e mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe për raportin vjetor të Avokatit të Popullit për vitin 2012, kemi obligim moral të përshëndes vendimin e Asamblesë të Organizatës së Kombeve të Bashkuara për një çmim që i ndahet Hilmjeta Apukut, do të thotë çmim që u ndahet çdo pesë vjet individëve dhe organizatave për kontribut të jashtëzakonshëm në promovim të të drejtave të njeriut.

Mendoj se ky çmim, përveçse i shkon Hilmjetës, u shkon edhe gjithë qytetarëve dhe shtetit të Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Daut Haradinaj.

DAUT HARADINAJ: Faleminderit, kryetar!

Edhe unë e përshëndes këtë Raport. Më shumë kisha pasur t'ia bëj një pyetje Avokatit të Popullit, se cilat janë masat e Avokatit të Popullit rreth rasti "Kiçina", kur e dimë që para disa muajsh ne kishim një debat në Parlamentin e Kosovës dhe u tha qartë se është ndërhyrje në drejtësi.

Ndërsa, po ashtu kemi informacione që i janë drejtuar Avokatit të Popullit tash e sa kohë dhe neve më shumë na intereson se përse nuk është përfshirë në raport rasti "Kiçina", cilat janë ato angazhimet e juaja rreth këtij rasti, për shkak se pretendohet nga palët se ka ndërhyrje ose deri diku, nëse mund të themi, ndoshta edhe një dënim i padrejtë?

Sidoqoftë, kisha pasur dëshirë që të marr një përgjigje! Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Bekim Haxhiu!

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar Avokat i Popullit,

Shumica e çështjeve u diskutuan edhe nga kolegët tjerë deputetë, mirëpo fokusi im do të jetë kryesisht në dy mangësi, të cilat kam arritur t'i vërej në këtë raport. Dhe, e para ka të bëjë rreth një problematike e cila vazhdon të jetë e pranishme në Kosovë dhe e cila mungon në raportin e Avokatit të Popullit, koha kur kemi të bëjmë me mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, koha e gjatë e mbajtjes në paraburgim të të akuzuarve pa vendim gjyqësor. Dhe, kemi pasur rastin që të vërejmë, të marrim informacione edhe nga mediet që një rast më eklatant për shembull, i të akuzuarit për një vepër ordinere mbahet tani 4 vjet pa pasur një proces gjyqësor, që është cenim i të drejtave e lirive të drejtave dhe lirive të njeriut. Dhe, në këtë kontest, në mbajtjen gjatë në paraburgim të të akuzuarve pa vendim dhe pa proces të shpejt gjyqësor, Kosova mban vendin e parë për nga kohëzgjatja apo kohë mbajtja e gjatë në paraburgim të të akuzuarve, pa pasur ndonjë vendim apo një seancë gjyqësore të shqyrtimit për ta.

Çështja tjetër ka të bëjë me të drejtat e mbrojtjes së fëmijëve. Në Kosovë ende vazhdojnë të angazhohen në punë fëmijë të moshave minore, qoftë ata të detyruar nga prindërit apo në forma të tjera të detyrimeve dhe kemi fëmijë të cilët kanë ardhur në Kosovë për të bërë punë, qoftë të lypsarëve apo tregtive të tjera dhe të cilat mungojnë në pjesën e këtij raporti, në veçanti te ata të cilët kanë ardhur në Kosovë dhe gjenden udhëkryqeve të Kosovës, fëmijë të cilët kanë ardhur nga Shqipëria.

Dhe, kam pritur që pjesë e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve të jetë edhe një problematikë, të cilën disa herë e kam trajtuar këtu në këtë Kuvend dhe është problematika e peshave të rënda të çantave të fëmijëve shkollor, e cila ka ndikuar që këto çanta të ndikojnë në dëmtimet kurrizore te fëmijët. Dhe, mendoj që kjo është jo vetëm cenim i të drejtave të fëmijëve, por edhe cenim i shëndetit të tyre. Dhe, kam pritur shumë më shumë punë, i nderuar Avokat i Popullit, nga ju, se sa që është bërë deri më tani. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Ramiz Lladrovci e ka fjalën.

RAMIZ LLADROVCI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuari Avokat i Popullit,

Kryetar, edhe unë pajtohem në përgjithësi me raportin që ka sjell Avokati i Popullit, por po ashtu pajtohem me parafolësit e fundit, si zonja Deliu apo zonja Kadaj edhe me pyetjet e zotit Haradinaj, por unë ndaj një mendim krejt tjetër nga Komisioni për Buxhet e Financa, i cili në rekomandimin e saj ka kërkuar një auditim të performansës për Avokatin e Popullit.

Unë mendoj që kjo seancë ose ky Parlament duhet të kërkojë auditim të performansës për disa organizata tjera buxhetore, siç janë Ministria e Punëve të Brendshme apo Ministria e Arsimit apo Ministria e Shëndetësisë, ose ndonjë organizatë tjetër, sepse Zyra e Auditorit të Përgjithshëm edhe ashtu nuk ka kapacitete të mjaftueshme për të zhvilluar auditime të performansës, por mendoj se atje ka shkelje të mëdha dhe të rënda dhe atje duhet përqendruar mendimin, se atje duhet bërë auditim të performansës. Prandaj, mendoj që kjo seancë nuk duhet ta votojë një kërkesë të Komisionit për Buxhet dhe Financa për një auditim të performansës.

Nuk jam për të mos i bërë Avokatit të Popullit auditim të performansës, sepse është një gjë e mirë, por kemi vende të tjera ku është shumë më e domosdoshme të bëhet auditimi i performansës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nuk ka të lajmëruar për diskutim. Para se t'ia jap fjalën Avokatit, dua t'i them edhe unë dy-tri fjalë.

Konsideroj që Avokati i Popullit si institucion i pavarur është institucioni më kredibil në Republikën e Kosovës dhe kredibiliteti i këtij institucioni ka kaluar dhe kufijtë e Kosovës dhe për këtë duhet falënderuar.

Por, megjithatë unë kisha dëshiruar që institucionet e pavarura, që kemi krijuar shumë dhe kemi shumë, ta kenë një drejtues, që është autonom dhe i pavarur në kuptimin e fjalës për t'i kryer detyrat dhe përgjegjësitë e veta konform ligjit në bazë të cilit punon dhe i kryen detyrat dhe përgjegjësitë e veta.

Megjithatë unë i kam dy-tri pyetje, jo pyetje por dy-tri kërkesa pasi ka shumë kërkesa dhe shkelje të të drejtave të punëtorëve, qoftë të administratës publike, qoftë dhe të të punësuarve në ndërmarrjet private, ndoshta në të ardhmen është mirë të dihet saktësisht, se cili është ai numër që u shkelet shërbyesve civilë e drejta në nivelin lokal, cila është përqindja e nivelit qendror dhe cila është shkelja e të drejtave të punëtorëve në sektorin privat?

Gjithashtu, mendoj që është përgjithësuese edhe çështja e shkeljeve në sistemi e drejtësisë. Unë mendoj që pasi që kemi tri nivele të këtij sistemi, kemi nivelin themelor, do të thotë Gjykatën Themelore, Gjykatën e Apelit dhe Gjykatën Supreme, është mirë që

në të ardhmen ne ta dimë saktësisht se cili është numri i ankesave të qytetarëve veç e veç të të tri nivelet e gjykatave. Dhe, kështu mendoj se do të ishte më i konkretizuar.

Por, edhe njëherë unë e falënderoj për punën që ka bërë dhe për kredibilitetin, që i ka sjell këtij institucioni dhe ne si deputetë duhet të kërkojmë, që edhe institucionet tjera ta kenë përgjegjësinë, profesionalizmin dhe kredibilitetin në këtë shkallë që e ka Avokati i Popullit.

I nderuar Avokat i Popullit, e ke fjalën.

AVOKATI I POPULLIT: Zoti kryetar, faleminderit!

Të nderuara zonja dhe zotërinj,

KRYETARI: I nderuar Avokat i Popullit, unë kam për ju një njoftim apo sqarim, koha është e kufizuar në 5 minuta.

AVOKATI I POPULLIT: Unë nuk do të mund t'u përmbahem 5 minutave, por në qoftë se nuk doni përgjigje në disa gjëra, sigurisht se mund të ma ndërpritni fjalën dhe nuk do të ketë përgjigje.

Por, megjithatë pa marrë parasysh vërejtjet, kritikën, mospajtimet, veç një dua ta them se kjo është hera e parë që Parlamenti i Kosovës merr seriozisht gjetjet e Avokatit të Popullit. Kjo nuk i bën nder vetëm Avokatit të Popullit, kjo i bën nder këtij Parlamenti.

Duhet ta dini që përveç Parlamentit slloven, ky është Parlamenti i dytë që bën përpjekje të diskutojë për gjetjet e Avokatit të Popullit, të mos pajtohet me gjetjet e tij, të pajtohet me gjetjet e tij, të kërkojë ndoshta ta votojë ose të mos e votojë.

Po ajo nuk është, domethënë, zonja deputete tha: “nuk di a ka kuptim të votohet apo të mos votohet?” Shumë e drejtë është. Nuk ka kuptim të votohet a të mos votohet, këto janë gjetjet. Me gjetjet mund të pajtohemi dhe mund të mos pajtohemi, mund të pajtohemi me rekomandimet dhe të mos pajtohemi.

Por, unë kam disa çështje domethënë që i nxora, megjithatë janë si përgjigje, është vonesa, vonesa është pjesërisht me fajin tonë, vonesa është se kemi pasur ngarkesë jashtëzakonisht të madhe në vitin 2013, kurse është raporti i vitit 2012. Kemi pasur edhe vonesa procedurale.

Vonesa është shkelje e ligjit dhe unë po e them hapur, por kjo shkelje e ligjit dijeni nuk i shkel të drejtat e njeriut. Kjo është shkelje e ligjit, nuk është bërë më 31, por me vonesën e raportit nuk i janë shkelur të drejtat kurrkujt, sepse në ndërkohë ne kemi botuar edhe 30 raporte tjera. Dhe, ato kanë qenë për ne më të rëndësishme për arsye se janë të veçanta, kanë të bëjnë me çështje të veçanta dhe prekin të drejtat e veçanta. Kjo është një pasqyrë. Dhe, këtë pasqyrë ne e kemi ofruar pak me vonesë, është e vërtetë, 6, 8 apo 10 muaj.

Një çështje që dua ta theksoj megjithatë është, numrat e saktë kërkohen. Ne kemi ata numra në të shumtën e rasteve që na lajmërohen, ose së paku përpiqemi t'i gjejmë zyrtarisht. Por, ne nuk i gjejmë të gjitha, ne përpiqemi t'u përmbahemi numrave zyrtarë, vendeve zyrtare ose informatave që nganjëherë mund t'i verifikojmë edhe vetë. Kjo është çështja.

Avokati i Popullit ka të drejtë të marrë informata edhe nga burime të tjera, por të bëjë përpjekje që t'i verifikojë ato.

Mungojnë të dhënat për fëmijët lypsarë, çantat e rënda për fëmijët. Krejt këto janë probleme për të cilat ne nuk mund të marrim vendime, sepse ato janë vendime të institucioneve publike. Ne e themi se ky është problem dhe duhet marrë seriozisht. Shumë shpesh kërkohet nga Avokati i Popullit të ketë çdo shkelje, nuk është e mundur.

Raporti i Avokatit të Popullit është vetëm një vetëm një pasqyrë e reduktuar e realitetit në Kosovë. Edhe ju të gjithë e dini se pasqyra është një objekt i tillë ku njerëzit shohin vetëm atë që duan ta shohin. Kur duam ta shohim fytyrën tonë i kthehemi pasqyrës, kur duam ta shohim shpinën tonë duhet ta kthejmë kokën, por është vetëm një pasqyrë, vetëm një pjesë e realitetit.

Kishte domethënë një varg çështjesh tjera, zonja deputete tha 20 mijë gra.

Zonja deputete, vetëm sa për informim, ky raport këtu është raporti përfundimtar. Raporti që e keni pasur ju në formë elektronike, ai ka qenë raporti të cilin e kemi diskutuar në Komisionin Parlamentar dhe i kemi miratuar dhe i kemi marrë ato vërejtje për të cilat jemi pajtuar në Komisionin Parlamentar. Prandaj, ajo shifër nuk është këtu, sigurisht edhe nuk mund të jetë, sepse kemi thënë që ajo ka qenë lëshim që ka qenë i përmirësuar.

Ne kemi një varg çështjesh tjera që u përmendën këtu, por një çështje domethënëse që ka të bëjë me të drejtat e njeriut, sepse ky nuk është raport financiar, raportin financiar ia bashkëngjisi këtij raporti jo pse e kemi obligim ligjor, sepse askund në ligj nuk është paraparë përfshirja e raportit financiar, por Avokati i Popullit do që këtij raporti t'ia bashkëngjisë raportin financiar që të gjithë ta shohin, se si është gjendja. Mirë, mirë është, keq, keq është, por nuk është obligim ligjor, obligim ligjor është t'i paraqitet Komisionit për Buxhet dhe Financa, që e bëjmë rregullisht.

Unë do t'u kthehem domethënëse edhe çështjeve tjera që janë të theksuara këtu, por sidomos vërejtjet për tejkallimet buxhetore. Ky është raport i vitit 2012. Në vitin 2012, në Avokatin e Popullit janë zgjedhur 5 zëvendës edhe 5 zëvendës kanë shkaktuar shpenzime shumë më të mëdha, 5 njerëz. Dhe këto nuk kanë dashur të merren parasysh, janë pagat, janë shpenzimet, janë mobilet, shërbimet telefonike, zyrat e tyre, krejt ato është dashur të rregullohen me të hollat e institucionit, ne s'kemi të holla tjera. Ose, shpenzimet, tejkallimet në udhëtime jashtë. Unë po them Institucioni i Avokatit të Popullit është pjesë e të gjitha rrjeteve ndërkombëtare që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut.

Edhe po e them edhe një çështje, shumica e udhëtimeve, sidomos që i bën Avokati i Popullit, nuk bëhen me para të buxhetit, por bëhen pikërisht ajo që e kam kërkuar unë nga donacionet e jashtme, vetëm për të mos i shpenzuar këto mjete. Por, megjithatë duhet të merret parasysh, nuk mund të kërkohej me një anë angazhim dhe gjetje shumë e madhe e të dhënave edhe zvogëlim i shpenzimeve, ajo është e pamundur.

Në gjuhën shqipe thuhet: “Me hy në ujë dhe mos me u lagë, duhet me qenë patë.”, ne pata nuk jemi. Po, në qoftë se e gjeni vetëm një cent të shpenzimeve ku ka element keqpërdorimi dhe korrupsioni, atë dua ta shoh, atë nuk mund ta gjeni në financat e Avokatit të Popullit, nuk është e mundur.

Kemi edhe çështje të tjera, domethënë, unë do t’i drejtohesha edhe çështjes së zonjës deputete nga komuniteti serb. Unë e di se dikujt i duket gjuha e Avokatit të Popullit, e rëndë, e ashpër. Ne mund ta zbusim gjuhën, gjuha nuk është me rëndësi, është mjet komunikimi. Por, unë mendoj se nuk është e drejtë dhe nuk mund të kërkonim nga Avokati i Popullit që të mos i emërojë gjërat me emrat e vërtetë. Kjo është çështja. Edhe këtë çështje, këtë s’mund ta kërkonim, po edhe po ta kërkonim, Avokati i Popullit nuk do ta bëjë, do t’i quaj veprimet, dukuritë, çështjet me emrat e vërtetë.

Unë e di se dikujt mund të mos i pëlqejë, ajo nuk është gjuhë e ashpër, ajo është gjuhë e sinqertë. Në qoftë se dikujt i them diçka që nuk ka bërë, pa marrë parasysh, po të them diçka që nuk ka ngjarë, ajo është një çështje tjetër, por unë them që gjuha e qartë, e saktë dhe e pa ekuivok, është gjuha që duhet të përdoret, por jo me fyerje. Edhe, sigurisht fyerjet për të cilat tha zonja deputete, nuk janë bërë për qëllime personale, se fundi i fundit asnjë nga... ka deputetë që i njoh personalisht, ka edhe prej tyre që i njoh shumë gjatë, por çështja e raportit të Avokatit të Popullit, nuk është çështje private, nuk është çështje personale. Ne, kur të doni, mund të pimë kafe bashkë, nuk kam çështje personale.

Unë mund ta marr me mend, domethënë, se ka vërejtje për mangësi të ndryshme, nuk janë futur personat e zhdukur, tha zonja deputete. Unë e kam shpjeguar në Komision, por edhe njëherë po e shpjegoj, jo që nuk është një çështje dhe një plagë shumë e rëndë, ajo është shumë e rëndë, por, ju lutem, merreni Ligjin për Avokatin e Popullit edhe shihni cilat janë kufizimet kohore, se po t’i futnim çështjet që janë jashtë kufizimeve kohore, sigurisht se do të dalë dikush e të thotë: “ti s’ke pasur kompetenca për këtë çështje”, po të mos i futim përsëri.

Unë e di sa ka mospajtime nga të gjitha anët. Ky është raport i Avokatit të Popullit me ato të gjetura, me atë përgatitje profesionale, me atë përgatitje intelektuale dhe me punë të sinqertë brenda një viti...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Dhjetë minuta i ke pasur. Do të thotë, pesë minuta më tepër. Faleminderit!

Veç një çështje dua ta them, që të gjitha njësitë buxhetore të pavarura edhe të varura, kanë obligim të hartojnë raport financiar. Kështu që, ne jemi në përfundim, po edhe një

njoftim që ka të bëjë me Rregulloren. Çdo çështje që shqyrtohet në Kuvend, ajo miratohet, votohet në fakt. E a miratohet apo jo, është diçka tjetër, por votohet.

Të pranishëm janë 57 deputetë. Regjia, bjeri ziles që të na vijnë deputetët për votim.

Të nderuar deputetë të pranishëm.

Kërkoj një votim, por para se të kërkoj votimin, kemi 74 kartela të vendosura, le të hiqen kartelat, sepse kemi vetëm 57 deputetë.

(Debat në sallë)

Së pari na duhet prania juaj, pastaj shohim. Edhe tri kartela duhet të hiqen. Faleminderit!

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash për praninë.

Të pranishëm janë 57 deputetë. Këta deputetë marrin mëditje për sot!

Për pikat e mbetura, Kryesia vendos të hënën.

Mirupafshim në seancën e radhës!

* * *

Më 12 dhjetor 2013

Vazhdimi i mbledhjes plenare, të filluar më 5 dhjetor 2013

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

I nderuar ministër,

Vazhdojmë me punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të filluar më 5 dhjetor 2013.

Për ta konstatuar praninë, është mirë që deputetët t'i zënë vendet e tyre. 88 deputetë janë të pranishëm me elektronikë. Ta verifikojmë praninë fizike. Është 80 deputetë. Të votojmë për praninë, ju lutem! Votojmë tash!

Prania e treguar është 75 deputetë, kurse me kartela të vendosura janë 95 deputetë.

Lus regjinë që edhe një herë ta tregojnë prezencën. Votojmë tash!

Tani janë 79 deputetë me votim, kurse me kartela 98. Është mirë të hiqen kartelat. 86 deputetë janë të pranishëm fizik.

I kemi dy pika të rendit të ditës:

8. Votimi i raportit të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2012

Diskutimet për raportin vjetor të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2012 ka përfunduar në seancën plenare, të mbajtur më 5 dhjet. Mirëpo, në mungesë të kuorumit, votimi i këtij raporti është shtyrë për seancën e sotme.

Vazhdojmë me votimin e raportit dhe të rekomandimeve të Komisionit.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Konstatohet se me 55 vota për, 24 kundër dhe 6 abstenime, Kuvendi e miratoi raportin vjetor të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2012, me rekomandimet e Komisionit Funksional.

9. Emërimi i kryetarit dhe i anëtarëve të Organit Shqyrtues të Prokurimit

Qeveria e Republikës së Kosovës e ka dërguar në Kuvend propozim-vendimin për emërimin e kryetarit dhe të anëtarëve të Organit Shqyrtues të Prokurimit.

Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 2 dhjetor 2013, e ka shqyrtuar shkresën e dytë të Organit Përzgjedhës të Pavarur dhe me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare ka vendosur që propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e kryetarit dhe anëtarëve të Organit Shqyrtues të Prokurimit ta radhisë për shqyrtim në seancën plenare.

Ju njoftoj se nëse nga Kuvendi, gjithnjë sipas ligjit, nuk ndërmerret veprimi lidhur me emërimin brenda kornizës kohore të caktuar me këtë nen, personat e emëruar konsiderohen si të emëruar nga Kuvendi.

I kemi dy të lajmëruar për diskutim. Fjalën e ka deputeti Muhamet Mustafa.

MUHAMET MUSTAFA: I nderuar kryetar i Kuvendit,

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës nuk e përkrah propozimin e Qeverisë për emërimin e anëtarëve të Organit Shqyrtues të Prokurimit, si dhe propozimin për kryesues të këtij organi. Ka edhe probleme procedurale, por më të rëndësishme janë arsyet esenciale.

Një ndër problemet më të mëdha të kësaj shoqërie është zbatimi i ligjit dhe ngritja e standardeve të përdorimit të parasë publike në interesin më të mirë publik dhe për këtë, roli i Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik është i pazëvendësueshëm.

Raportet e Auditorit të Përgjithshëm në vazhdimësi gjatë tre vejtëve të kaluara kanë konstatuar lëshime në udhëheqjen e procedurave të prokurimit publik dhe në evidentimin dhe menaxhimin e pasurisë publike.

Gjithashtu, edhe vlerësimet e organizatave ndërkombëtare dhe vendore, kredibile të pavarura, konstatojnë një trend shqetësues të status quo-s në luftimin e korrupsionit dhe një perceptim, apo një trend të rritjes së përmasave dhe pasojave të këtij fenomeni të dëmshëm dhe kanceroz të shoqërisë dhe të shtetit tonë.

Kjo do të thotë se institucionet përgjegjëse, trupat, organet që janë krijuar për ta luftuar korrupsionin nuk po e bëjnë punën e vet, as në nivelin e domosdoshëm.

Edhe Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik nuk është angazhuar që t'i pengojë këta trendë shqetësues dhe nuk e ka lozur rolin e tij në përgjegjësinë dhe në nivelin e duhur.

Nëse është situata kështu në prokurimin publik, ne nuk mund ta amnistojmë punën jo të mirë të Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik.

Andaj, është shqetësuese dhe e habitshme që Qeveria të na propozojë anëtarët dhe kryesuesin pothuajse në përbërje të njëjtë, me përjashtim të një organi dhe atë me një vonesë të madhe. Na e sjellin një propozim, i cili nuk duhej të ishte në tavolinat tona.

Dhe, këtë propozim na e sjellin pa asnjë arsytim dhe pa një listë tjetër të kandidatëve eventuale që do të mund të vinin në konsiderim.

Ky është një propozim për vazhdimin e status quo-s për ineficiencën dhe mungesën e vullnetit politik për ta zbatuar ligjin, për ta luftuar korrupsionin dhe për ta përdorur parandë publike në interesin më të mirë publik.

Andaj, Grupi Parlamentar i LDK-së fton që mos të aprovohet ky propozim.

KRYETARI: Faleminderit, deputet!

Unë po e lexoj, desha ta shkurttoj pak, sqarimin procedural në bazë të ligjit që është në fuqi.

Neni 100, paragrafi 4 i Ligjit për prokurimin publik parasheh: “Kryetari dhe anëtarët e Organit Shqyrtues të Prokurimit propozohen nga Qeveria dhe emërohen nga Kuvendi në bazë të rekomandimit që është marrë nga një organ përzgjedhës i pavarur, i themeluar nga Kuvendi. Organi Përzgjedhës i Pavarur do të përbëhet prej tre gjykatësve të emëruar sipas rregullit të caktuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës”.

Ndërsa, sipas paragrafit 6 të këtij neni: “Kuvendi brenda afatit prej 30 ditëve shqyrton dhe emëron personat e përzgjedhur në bazë të paragrafit 4 të këtij neni. Kuvendi mund të kërkojë sqarim shtesë nga Organi Përzgjedhës i Pavarur përkitazi me personat e përzgjedhur. Në rast të tillë, afati kohor i paraparë për emërimet nga Kuvendit mund të shqyrtohen për 10 ditë nga dita e pranimi të sqarimit shtesë. Nëse nga Kuvendit nuk ndërmerren veprime lidhur me emërimet brenda kornizës kohore, të caktuar në këtë nen, personat e emëruar konsiderohen të emëruar nga Kuvendit”.

Kështu thotë ligji. Unë me besnikëri e lexova ligjin, i cili e përcakton përzgjedhjen e kryetarit dhe e anëtarëve të Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik.

Replikë, Muhamet Mustafa. Urdhëro!

MUHAMET MUSTAFA: Ne e kemi këtu propozimin e Panelit Zgjedhor që e zgjodhëm dy-tri mbledhje përpara. Dhe me propozimin e tyre këta janë emëruar më 2 dhjetor. Valdete Daka, Asllan Krasniqi e Nebojsa Boriq janë emëruar më 2 dhjetor, ndërsa sot jemi më 12 dhjetor.

KRYETARI: Po, deputet, po kërkesat i kanë bërë në kundërshtim me ligjin dhe ne nuk jemi të obliguar që t'i pranojmë kërkesat që bëhen në kundërshtim me ligjin.

Kështu që ne të shkojmë në procedurën e votimit. Urdhëro! Lajmërohuni, ngase nuk e pata asnjë të lajmëruar. Urdhëro! Deputeti Sabri Hamiti e ka fjalën.

SABRI HAMITI: Zoti kryetar,

Kemi qenë shumë i saktë në evidentimin e ndodhive dhe procedurave. Por, ky është organ që vendos. Ju dhe ne e kemi vënë në rend të ditës. Kuvendi voton për, ose kundër. Pavarësisht ndodhive rreth atij komisioni, që s'ka marrë qëndrim, Kuvendi merr vendim. Kaq! Ato janë punë të tjera.

Prandaj jemi mbledhur ne. Nuk jemi mbledhur t'i tregojmë procedurat, sepse kemi juristë që i dinë ato punë. Janë provuar të gjitha, ka mbaruar, ka kaluar në seancë - seanca vendos. Faleminderit!

KRYETARI: Edhe unë po kërkoj që seanca të vendosë. Asgjë më shumë. Nuk kemi të lajmëruar për deklaram. Të pranishëm i kemi 92 deputetë. Lus regjinë dhe deputetë të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Konstatohet se me 42 vota për, 42 kundër dhe 3 abstenime nuk kalon.

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*